




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER

Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarja za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



PROGRAM PËR



ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Ky publikim është realizuar përmes bashkëpunimit të KOMF me Zyrën për Qeverisje të Mirë, në kuadër të projektit “Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cenushme në Kosovë”, i cili mbështetet nga UNICEF në Kosovë në partneritet me USAID.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në kuadër të këtij programi nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF në Kosovë apo të USAID në Kosovë.

Gusht 2023

HYRJE

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 17 Korrik 2019 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14). Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka hyrë në fuqi (1) vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare (shih nenin 66).

Hartimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), i ka paraprirë një numër i madh i analizave, studimeve, takimeve konsultuese, punëtorive intensive dhe konsultimeve publike. Ai është hartuar brenda një periudhe prej më tepër se 5 vite. Në këtë proces kanë marrë pjesë me dhjetra ekspertë dhe profesionistë të fushës së të drejtave të fëmijëve. Fëmijët, interesi më i mirë i tyre gjithmonë kanë qenë fokusi i punës të atyre që drejtpërdrejtë apo nëpërmes formave tjera kanë marrë pjesë në hartimin e dispozitave të LMF. Gjithsesi, institucionet përgjegjëse për hartimin e ligjit, janë kujdesur dhe kanë siguruar pjesëmarrjen dhe pranimin e pikëpamjeve të fëmijëve apo përfaqësuesve të tyre nëpër të gjitha fazat e draftimit të ligjit.

Finalizimi i draftit i cili tanimë është ligj në fuqi, ka kaluar nëpër debate dhe diskutime shumë përmbajtësore, në të cilat kuptohet ka pasur tema dhe fusha ku ka pasur konsensus të plotë, mirëpo edhe në pjesë dhe fusha të caktuara ku ka pasur kundërshtime dhe mospajtime.

Hyrja në fuqi e LMF ka krijuar një momentum të ri juridik në kuptim të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës. Ky momentum dhe obligim ligjor kërkon nga institucionet dhe mekanizmat që të ndër marrin veprime konkrete për të bërë funksional dhe zbatuar dispozitat e këtij ligji që në përmbajtje dhe kornizën ligjore është i pari i këtij lloji në Republikën e Kosovës.

Andaj, të gjithë ne kemi një rol për të luajtur, e gjithë shoqëria, individi, familja, shkollat, institucionet, sektori jo qeveritar, sektori privat, mediat, komuniteti, është e nevojshme të krijojmë një mjedis mbështetës, mbrojtës për fëmijët, një mjedis që nuk e pranon dhunën, që e refuzon atë dhe njëkohësisht ndjen si detyrë reagimin dhe mobilizimin kundër këtij fenomeni.

Për të realizuar dhe zbatuar me efikasitet dispozitat e LMF, respektivisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duhet një vetëdijësim dhe ngritje e kapaciteteve rreth rolit dhe përgjegjësive, duke filluar nga individët, familjet, komuniteti, zbatuesit e ligjit dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës.

Qëllimi i përgjithshëm i programit (i përbërë nga katër module) është fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës në nivel komunal dhe qendror për të zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijës.

Modulet dhe përmbajtja me gjithë referenca, janë një aset edukativ i munguar në fushën e mbrojtjes së fëmijës, veçanërisht në lidhje me Ligjin e Mbrojtjen e Fëmijës, që është i pari i këtij lloji në Kosovë, dhe i cili sjell shumë risi, dhe aspekte që kërkojnë vëmendjen e shtuar dhe koordinimin institucional për zbatimin e tij në praktikë.

SHKURTESA

LMF	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
LF	Ligji për Familjen i Kosovës
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDFKB	Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i Kombeve të Bashkuara
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
Komiteti	Komiteti Ndërmisor për të Drejtat e Fëmijës
Këshilli	Këshilli për të Drejtat e Fëmijës
QPS	Qendra për Punë Sociale
Ekipi	Ekipi për të Drejtat e Fëmijës
Sistemi	Sistemi për Mbrojtjen e Fëmijës
Shtëpitë	Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
Agjencia	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

MODULI I:

QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PARIMET E LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
SHKURTESA	5
I. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE REZULTATET E PRITURA.....	8
KAPITULLI 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	9
1.1. Kush është fëmijë?	9
1.2. Të drejtat e fëmijës dhe mbrojtja e fëmijës.....	10
1.3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës	11
1.4. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës	12
1.5. Qëllimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.....	14
1.6. Fushëveprimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.....	15
KAPITULLI 2. PARIMET E MBROJTJES SË FËMIJËS	16
2.1. Interesi më i mirë i fëmijës	16
2.2. Zhvillimi gradual i aftësive	19
2.3. Respektimi i pikëpamjes së fëmijës.....	20
2.4. Mos diskriminimi.....	23
II. ANEKS.....	25
A) Rast studimi	25
B) Agjenda	28

I. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivë kryesore e Modulit të Parë është lehtësimi i kuptimit të pjesës së përgjithshme të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, përmes ofrimit të njohurive rreth koncepteve bazë, përkufizimeve, qëllimit, fushëveprimit, parimeve të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare, etj.

Përmes këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- T'i përvetësojnë termet dhe përkufizimet;
- Të kuptojnë konceptet dhe dallimet ndërmjet të drejtave dhe mbrojtjes;
- Të identifikojnë instrumentet ligjore për mbrojtjen e fëmijëve;
- Të kuptojnë qëllimin e ligjit;
- Të kuptojnë përfituesit dhe zbatuesit;
- Të kuptojnë dhe të udhëhiqen nga parimet kryesore;
- Të rrisin aftësitë analitike përmes studimit të rasteve praktike, etj.

KAPITULLI 1.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1. Kush është fëmijë?

Në Republikën e Kosovës, termin dhe përkufizimin fëmijë, e hasim në shumë ligje. Në kuadër të përkufizimit e gjejmë edhe përcaktimin e moshës si dhe kategorizimin e moshave (mosha e përgjegjësisë penale, kategoritë e moshave të të miturve, mosha e pëlqimit, mendimit etj). Përkufizimin dhe këto ndarje i përmbajnë këto ligje por jo vetëm:

- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF);
- Ligji i Familjes (LF);
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (LSHSF);
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM);
- Kodi Penal (KP);
- Kodi i Procedurës Penale (KPP), etj.

LMF, përcakton që fëmijë konsiderohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.

Përkufizimi të cilin e ofron LMF, përcakton edhe përjashtimin e rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Kjo pjesë e përkufizimit i referohet mundësive të cilat parashihen në legjislacionin përkatës siç është Ligji i Familjes, ku parashihet arritja e moshës madhore nëpërmjet emancipimit.

Ligji si përjashtim të radhës parasheh edhe rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga LMF derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht.

Këto dy përjashtime përveç që i japin mbrojtje interesit dhe të drejtave të fëmijës, ato edhe ndihmojnë dhe lehtësojnë punën e profesionistëve në praktikë. Sepse në praktikë ka raste që mosha e fëmijës nuk mund të kuptohet dhe konkludohet saktë, dhe si rezultat i kësaj disa të drejta të caktuara mund të cenohen dhe shkelen nga zbatuesit e ligjit.

Fëmijë – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën **tetëmbëdhjetë (18) vjeç**, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht.

Neni 3 par.1. pika 1.1. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/l-064)

LMF, pa asnjë përjashtim dhe rezervë ka inkorporuar dhe adoptuar përkufizimin të cilin e parasheh edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet (**neni 1, KDF**)

Neni 1 i KDF e përkufizon **“fëmijën”**, për qëllimet e Konventës, si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç. Teksti e lë të hapur pikën fillestare të fëmijërisë. A përkon kjo me lindjen, ngjizjen ose diçka mes tyre? Në rast se Konventa do të kishte marrë ndonjë pozicion rreth abortit dhe çështjeve të ngjashme, ratifikimi universal i saj do të ishte vënë në rrezik. Për qëllimet e Konventës, fëmijëria mbaron në moshën 18 vjeçare, me përjashtim kur mosha madhore, në një shtet të caktuar, arrihet më përpara.

1.2. Të drejtat e fëmijës dhe mbrojtja e fëmijës

Përgjatë zbatimit të ligjit dhe referimit nga ana e profesionistëve të ndryshëm, shpesh herë ndodh të përdoren termet “e drejta” dhe “mbrojtja” si sinonime, apo edhe në disa raste edhe ngatërrimi i këtyre dy koncepteve. Me qëllim të sqarimit dhe dallimit të këtyre koncepteve në vijim po ju ofrojmë përkufizimin e tyre dhe ilustrimin përmes një shembulli:

Të drejtat e fëmijës përfshijnë një mori të parimeve dhe idealeve të cilat fëmijët duhet t’i realizojnë në jetën e tyre. Ato përfshijnë të drejtën për jetë, zhvillim, shëndetësi, arsim, lojë dhe jo vetëm këto, por edhe shumë të drejta të cilat janë të përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetutën, ligjet e deri tek aktet nënligjore apo edhe marrëveshjet/kontratat e ndryshme.

Mbrojtja e të drejtave përfshin një mori të veprimeve dhe përgjegjësi individuale dhe institucionale nëpërmjet të cilave bëhet mbrojtja e të drejtave të fëmijës, i cili për shkak të rrethanave dhe kushteve në të cilat gjendet mund të jetë i cenueshëm apo që i është ekspozuar rrezikut i cili do të dëmtonte realizimin e këtyre të drejtave. Për më tepër, ajo përfshin procedurat dhe masat nëpërmjet të cilave realizohet parandalimi, reagimi, rehabilitimi dhe reintegrimi i fëmijës, respektivisht realizimi i të drejtave të mohuara.

SHEMBULL:

Sipas legjislacionit përkatës dhe LMF’...fëmija ka të drejtën dhe duhet të jetojë dhe zhvillohet pranë familjes. Mirëpo në rrethana të caktuara dhe konform interesit më të mirë të fëmijës, dhe me vendim të Gjykatës apo Organit të Kujdestarisë ai duhet të ndahet nga familja...’ (neni 27 i LMF).

Përderisa e drejtë e fëmijës është jeta dhe zhvillimi i tij pranë familjes, ndarja nga familja dhe veprimet që ndërmerren nga sistemi i mbrojtjes së fëmijës për largimin e fëmijës nga familja e tij paraqesin mbrojtjen dhe realizimin në praktikë të kësaj të drejte. Pra që nga momenti kur bëhet identifikimi i fëmijës së cenueshëm, pastaj veprimet dhe hapat që ndërmerren në menaxhimin e rastit dhe largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen nën kujdestari apo në ndonjërin prej formave alternative të mbrojtjes, dhe krejt në fund kur është e mundur rikthimin dhe reintegrimin e fëmijës në familje dhe komunitet përbëjnë atë që ne e njohim si mbrojtje të Fëmijës.

Përkundër përkufizimeve të ndryshme dhe dallimeve substanciale, këto dy koncepte duhen kuptuar dhe zbatuar:

- Si koncepte të pandashme;
- Veprime që janë të ndërlidhura;
- Reagimi dhe zbatimi i tyre duhet të jetë i njëkohshëm;
- Që të drejtat nuk zëvendësohen dhe pakësohen.

1.3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta si akti më i lartë juridik dhe politik në kuadër të Kapitullit II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore ka paraparë edhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Në nenin 21 tek parimet e përgjithshme ka përcaktuar që:

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Koment:

Parimet e përcaktuara në nenin 21 janë përshtatshmërisht të aplikueshme dhe vlejné edhe për fëmijët në mënyrë të barabartë sikur edhe për madhorët.

Duke pas parasysh përfshirjen në Kushtetutë të KDF si dhe faktin që fëmijët, për shkak të papjekurisë së tyre fizike dhe intelektuale kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 50 ka rregulluar disa nga të drejtat dhe parimet kryesore ku përcaktohet që:

[Të Drejtat e Fëmijës]

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre;
2. Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë;
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi;
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve;
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Është me rëndësi të kuptojmë që në nenin 50 janë përcaktuar në mënyrë të përmblendhur të drejtat dhe parimet bazë për mbrojtjen e fëmijës siç janë:

- Kujdesi dhe mirëqenia e fëmijës;
- Barazia e të gjithë fëmijëve;
- Mbrojtja nga dhuna;
- Interesi më i mirë i fëmijës;
- Rritja dhe zhvillimi i fëmijës pranë familjes dhe me prindërit.

Të gjitha këto të drejta dhe parime janë reflektuar dhe inkorporuar edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

1.4. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e konventave ndërkombëtare, në nenin 22 të Kushtetutës ka përcaktuar zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, ku së bashku me konventat tjera ka përfshirë si pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm edhe KDF. Përveç përfshirjes së konventës në rendin juridik të Republikës së Kosovës ajo i ka dhënë përparësinë Konventës ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera ku përcaktohet që:

“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.

Në kuadër të standardeve dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare që janë të zbatueshme në Kosovë dhe që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë aspektet e të drejtave të fëmijës është edhe **Konventa për të Drejtat e Fëmijës**.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është dokument i ratifikuar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi të drejtat e njeriut, dhe më konkretisht ajo është ratifikuar nga 196 shtete¹ palë që prej aprovimit unanimit të saj nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në vitin 1989. Me ratifikimin e KDF, një shtet angazhohet në zbatimin e një sërë masash të përcaktuara, që përfshijnë të drejtat dhe liritë e njeriut, ambientin familjar, shëndetin dhe mirëqenien bazë, edukimin, kohën e lirë dhe aktivitetet kulturore dhe masat e veçanta.

Në vitin 2002, dy Protokollet Opsionale të Konventës hynë në fuqi, “Protokolli Opsional i KDF, lidhur me shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve” dhe “Protokolli Opsional i KDF, lidhur me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura.

Në Dhjetor 2011, Asambleja e Përgjithshme hartoi Protokolllin e tretë Opsional të KDF mbi procedurën e komunikimeve. Ky protokoll hyri në fuqi në Prill 2014 dhe është një instrument procedural që nuk sjell të drejta dhe detyrime të reja, por krijon një mekanizëm për fëmijët ose përfaqësuesit e tyre, për të paraqitur pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, ankesa individuale ose në grup për shkelje të konventës apo protokolleve opsionale, në rastet kur masat kombëtare janë ezauruar. Kjo bën të mundur për Komitetin që, për ankesat ndërshtetërore në rast shkeljesh të rënda dhe sistematike, të kryhen hetime.

¹ https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtdsg_no=IV-11&chapter=4&clang=_en#24 (klikuar me 15 Gusht 2022).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, që përbëhet nga një numër standardesh dhe detyrimesh të panegociueshme, për të cilat është rënë dakord botërisht, ofron mbrojtje dhe përkrahje për të drejtat e fëmijës.

Neni 4 i KDF, parashikon detyrimin e Shteteve Palë për të marrë të gjitha masat e mundshme për implementimin e të drejtave të Konventës. Gjuha e përdorur në këtë nen është e qartë dhe tregon që masat që duhen marrë **nuk janë vetëm masa legislative apo administrative**. Shtetet **marrin të gjitha masat e nevojshme** për të vënë në zbatim të drejtat e fëmijës. Respektimi dhe zbatimi i tyre kërkon ndërhyrje komplekse të cilat shpeshherë paraqiten në strategjitë që Shtetet Palë hartojnë, bazuar në situatën e tyre kombëtare. Megjithatë, edhe Ud-hëzuesi i Komitetit të të Drejtave të Fëmijës për raportimin fillestar për konventën thekson dy hapa thelbësorë që duhen ndërmarrë nga shtetet:

- 1) Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me Konventën duke bërë një rishikim gjithëpërfshirës të tij**
- 2) Kombinimi i duhur i politikave që kanë lidhje me fëmijët në të gjitha nivelet e qeverisjes**

Komiteti ka vënë në dukje se një referim që mund t'i bëhet konventës nga Shtetet Palë në Kushtetutë nuk është i mjaftueshëm. Veç kësaj, legjislacioni i brendshëm duhet të përfshijë standardet e konventës. Një mënyrë për ta arritur këtë është hartimi i një ligji ku të parashikohen të gjitha aspektet në lidhje me fëmijën.

Pjesa e dytë e nenit 4, lidhet veçanërisht me përpjekjet për zbatimin e të drejtave, sociale dhe kulturore të fëmijës. Për këtë, kërkohet që Shtetet Palë, të "marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar". Aktet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut shpesh parashikojnë të drejta të tilla si: të drejtat ekonomike, sociale, kulturore, civile dhe politike. Të drejtat civile dhe politike zakonisht konsiderohen ato të cilave duhet t'u jepet efekt i menjëhershëm dhe për këto të drejta, shtetet nuk mund të paraqesin arsye të pranueshme që të arsyetojnë vonesat në kohë në lidhje me zbatimin e kësaj kategorie të drejtash. Zbatimi i këtyre të drejtave ka kosto, por këto të drejta janë aq të rëndësishme sa që mungesa e burimeve të mjaftueshme nuk mund të jetë kurrë një arsye bindës për vonesat në zbatim.

Kurse, sa i përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, ato mund të zbatohen në mënyrë progresive në varësi të burimeve të brendshme të shteteve, qoftë burimeve ekonomike ashtu edhe njerëzore. Megjithatë, fakti që realizimi i këtyre të drejtave është i parashikuar në Konventë, nuk duhet keqinterpretuar. Ai nuk i shkarkon shtetet nga detyrimi për marrjen e masave.

Obligimi i shteteve për të vënë në jetë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore duke marrë të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë, sjell si pasojë marrjen e masave në lidhje me buxhetin. Edhe pse shtetet ndryshojnë sa u përket burimeve që kanë në dispozicion dhe masave që duhen marrë për të vënë në jetë të drejtat e fëmijëve, ato janë të detyruara që t'i japin prioritet buxhetimit për të drejtat e njeriut.

1.5. Qëllimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Ligdhënësi gjatë hartimit të LMF është bazuar dhe ka marrë si referencë obligimet që dalin nga KDF, nga ku i bëhet thirrje shteteve që të ndërmarrin të gjithë masat legislative për jetësimin e të drejtave të fëmijës.

Andaj, edhe si qëllim të parë ka paraparë: ***‘mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimin të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi’.***

Për më tepër LMF ka paraparë edhe qëllime tjera, nëpërmjet të cilave jetësohen dhe mundësohen realizimi i të drejtave të parapara në KDF, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Këto qëllime reflektojnë përmbajtjen dhe synimin e ligjit karshi të drejtave dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave. LMF, përveç qëllimit të lartpërmendur ka edhe këto qëllime:

- Të mbrojnë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës;
- Të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës;
- Përcaktimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, mekanizmat efikase dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e lokal, si dhe kompetencat e tyre për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;
- Garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- Marrjen e masave për t’i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës, bazuar në interesin më të mirë të tij;
- Marrjen e masave për të siguruar jetesën, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës;
- Sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave për mbrojtjen e fëmijës;
- Përcaktimin e mekanizmave efektivë, funksionimin e institucioneve mandatore dhe marrjen e masave konkrete për parandalim, reagim dhe mbrojtje të fëmijës;
- Ngritjen e sistemit të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Ligdhënësi përveç inkorporimit dhe adoptimit të parimeve dhe të drejtave nga KDF, në kuadër të procesit të përafrimit me legjislacionin e BE ‘acqui communautaire’ është kujdesur që dispozitat e LMF të jenë në përputhshmëri edhe me Direktivat e Bashkimit Europian. Dhe në këtë aspekt LMF është në përputhshmëri me Direktivën 2011/92/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të 13 Dhjetorit 2011, për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë, dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2004/68/ JHA.

1.6. Fushëveprimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

LMF, ka një fushëveprim mjaft të gjerë dhe nga i cili përfitojnë një numër i madh i kategorive të fëmijëve siç janë:

- Fëmija me shtetësi kosovare
- Fëmija pa shtetësi
- Fëmija i pa regjistruar
- Fëmija azilkërkues
- Fëmija refugjat ose me shtetësi të huaj
- Fëmija që ndodhet brenda territorit të Republikës së Kosovës, dhe
- Fëmija me shtetësi kosovare, që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 2 paragrafi 1 dhe pika 1-2 i LMF

Dispozitat e LMF nuk mund të merren si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 2 paragrafi 2 i LMF

Është me rëndësi të theksohet fakti që në kuadër të fushëveprimit, është përfshirë një dispozitë e karakterit të garancionit, ku fëmijës nuk mund t'i kufizohet ose pakësohet asnjë e drejtë që paraprakisht është përcaktuar në KDF, Kushtetutë apo ndonjë ligj i cili është në fuqi. Kjo dispozitë mundëson interpretimin dhe zbatimin e dispozitave në favor të të drejtave të fëmijës, dhe në asnjë rrethanë të drejtat dhe mbrojtja që janë paraparë në LMF nuk mund të interpretohen kundër interesit më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI 2.

PARIMET E MBROJTJES SË FËMIJËS

LMF, në kuadër të pjesës së përgjithshme përcakton parimet e mbrojtjes së fëmijës, të cilat derivojnë nga KDF dhe janë pjesë përbërëse e ligjit. Parimet edhe pse në përmbajtje më tepër janë deklarative, ato janë obligative në kuptimin ligjor dhe paraqesin udhëzime për të zbatuar dhe interpretuar tërësinë e dispozitave të cilat janë në LMF dhe kur e kërkon nevoja edhe interpretimin karshi dispozitave të ligjeve të tjera të aplikueshme.

Parimet duhen lexuar dhe kuptuar gjithnjë si parime që janë të ndërlidhura dhe nuk mund të zbatohen si të ndara, për faktin që ato janë edhe normë juridike (e drejtë) mirëpo edhe si mjet (udhëzues).

LMF, ka inkorporuar nga KDF katër parimet kryesore:

- ✓ **Interesi më i mirë i fëmijës (Neni 5 i LMF)**
- ✓ **Zhvillimi gradual i aftësive (Neni 6 i LMF)**
- ✓ **Respektimi i pikëpamjes së fëmijës (Neni 7 i LMF)**
 - ✓ **Mosdiskriminimi (Neni 8 i LMF)**

2.1. Interesi më i mirë i fëmijës

LMF garanton shumë të drejta për fëmijët, të garantuara edhe nga ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Mirëpo, ajo që nuk gjendet në të drejtat e garantuara në këto ligje, të cilat në mënyrë automatike aplikohen edhe për fëmijët, për shkak se fëmijët përfshihen nën termin “person” apo “individ”, është pikërisht parimi i interesit më të mirë të fëmijës. Pra për të rriturit ne nuk gjejmë një parim të ngjashëm siç do të ishte parimi i interesit më të mirë të individit. Për individin e rritur interesin më të mirë e ka vendosur shteti duke garantuar të drejtat e përcaktuara. Atëherë, në këto kushte natyrshëm lind pyetja **përse për fëmijën përveç të drejtave të përcaktuara kemi dhe një parim që i mbivendoset të drejtave?** Përgjigja do të ishte, sepse fëmija është subjekt të cilit shteti duhet t'i garantojë mbrojtjen e posaçme për shkak të moshës së tij. Interesi më i mirë i fëmijës është mekanizmi me të cilin komuniteti jonë i të rriturve do të balancojë veprimtarinë vendimmarrëse institucionale, qoftë publike apo edhe private në favor të fëmijëve. Koncepti se në të gjitha veprimet dhe vendimet për fëmijët, interesi më i mirë i tij duhet të jetë konsideratë mbizotëruese do të ndihmojë vendimmarrjen në rastet kur kemi interesa konkurruese si p.sh. midis vetë fëmijëve, midis fëmijëve dhe familjeve të tyre, midis fëmijëve dhe shtetit.

LMF këtë parim e ka përcaktuar në nenin 5 të cilin e ka detajuar në disa paragrafe duke i dhënë sqarim dhe udhëzime shtesë se çka nënkupton dhe si të zbatohet:

*Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, **interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsideratë mbizotëruese dhe më e larta** (neni 5 paragrafi 1 i LMF).*

'Ky ligj, si dhe aktet e tjera juridike që rregullojnë çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazën e tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të mirë të fëmijës (neni 5 paragrafi 2 i LMF).

'Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës' (neni 5 paragrafi 3 i LMF).

KOMENT:

Parimi i interesit më të mirë të përcaktuar në paragrafet 1-3 nuk përbën në vetvetë një të drejtë substanciale apo procedurale. Ai përbën më shumë një parim për t'u konisderuar gjatë zbatimit të të drejtave të tjera. Është për t'u theksuar se këto paragrafe krijojnë detyrime për prindërit, kujdestarin, institucionet, shërbimet, profesionistët, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative që të konsiderojnë interesin më të mirë të fëmijës në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët. Është pikërisht detyrimi i tyre për të marrë masa për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës si konsideratë parësore, ai që përbën prerogativën kryesore në lidhje me shtrirjen e këtij koncepti si në fushën e veprimtarisë publike, shtetërore ashtu edhe në atë private.

Nga mënyra se si janë formuluar paragrafet kuptohet se interesi më i mirë i fëmijës nuk është i vetmi faktor në situata kur do të duhet të vendoset për veprime lidhur me fëmijët. Është pikërisht fraza *"konsiderata mbizotëruese dhe më e larta"* e cila e nënkupton këtë dhe njëkohësisht jep zgjidhjen e përparësive në interesat e ndërthurura në një situatë të caktuar. Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i Kombeve të Bashkuara (KDFKB)² kur ka interpretuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës, ka theksuar që është një detyrim i shtetit për të inkorporuar apo pasqyruar parimin e interesit më të mirë të fëmijës në legjislacionin e brendshëm dhe për ta zbatuar atë në çdo procedurë për fëmijët.

Ligjdhënësi në vazhdimësi të nenit 5 në paragrafin 4 nëpërmjet 7 pikave në vijim ka përcaktuar disa 'parime' shtesë për tu siguruar që interesi më i mirë i fëmijës duhet të respektohet:

'Familja është përgjegjëse kryesore për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur fëmijët; institucionet ndihmojnë familjet me këtë detyrim dhe ndërhyjnë vetëm kur familja nuk është në gjendje, apo nuk është e aftë ose ka nevojë për ndihmë për të mbrojtur fëmijën'(neni 5 par.4. pika 4.1.);

'Qëndrueshmëria duhet të jetë qëllim kyç, duke zgjedhur intervenimin sa më të pakët në jetën e fëmijës për të siguruar stabilitetin e marrëdhënieve personale të fëmijës dhe të shoqërisë, mjedisit dhe për të garantuar vazhdimësinë e arsimimit, trajnimit të fëmijës, ose punësimit' (neni 5 par.4. pika 4.2.);

'Vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme' (neni 5 par.4. pika 4.3.);

'Prindërit, kujdestarët dhe fëmija marrin pjesë në të gjitha fazat e procedurës përveç nëse është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës' (neni 5 par.4. pika 4.4.);

² Komiteti është një mekanizëm i krijuar nga KB për të monitoruar zbatimin e KDF dhe protokolleve opsionale.

'Mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar' (neni 5 par.4. pika 4.5.);

'Historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen' (neni 5 par.4. pika 4.6.);

'Vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore/farefisnore, shoqërore dhe/ose shpirtërore, dhe të gjitha vendimet dhe iniciativat që janë objekt i këtij ligji, duhet të marrin parasysh individualitetin, moshën dhe pjekurinë, gjuhën amtare, seksin, gjininë, identitetin, gjendjen shëndetësore dhe aftësitë e veçanta të fëmijës me qëllim të ruajtjes së identitetit etnik, racor, fetar dhe kulturor të fëmijës, sipas rrethanave' (neni 5 par.4. pika 4.7.).

KOMENT:

'Parimet' shtesë të cilat i ka paraparë LMF, janë përcaktuar me qëllim të ndërlidhjes dhe zbatimit të dispozitave të cilat i ka përcaktuar ligji në brendësinë e tij. Në këtë aspekt vetë ligji ka përcaktuar nevojën për mbrojtje ku parimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë fokusi kryesor i procesit të mbrojtjes dhe vendimmarrjes si p.sh. në nenin 22 par. 2 dhe 4 (sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë), neni 25 par.2 (masat e mbrojtjes ligjore), neni 27 par. 4 dhe 6 (ndarja e fëmijës nga familja), neni 31 par.2 (monitorimi i masave mbrojtëse), neni 45 par.6 (mbrojtja e fëmijës në masmedia), neni 56 par.2 (ndihma juridike dhe qasja në organet e drejtësisë), neni 57 par.8 (ndihma mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe masat për riintegrim). Këto janë situata tipike kur vetë të drejtat e parashikuara në ligj ndërlidhen me njëra tjetrën dhe roli që merr parimi i interesit më të mirë të fëmijës është ai i filtrit kryesor ndërmjet të drejtës së fëmijës përballë asaj të prindërve, apo të drejtës së fëmijës përballë asaj të publikut për t' u mbrojtur nga veprimtaria jo ligjore apo kriminale. Interesi më i mirë i fëmijës vjen si përcaktues i vetëm, si garantues i së drejtës për t' u rritur në një ambient familjar, në të cilin i rrituri si kujdestar, adoptues apo familje strehuese do të shfaqet si plotësues dhe në funksion të së drejtës së fëmijës dhe aspak si individ që ka të drejtë të marrë dhe të rrisë një fëmijë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i parimit të interesit më të mirë të fëmijës është marrja parasysh dhe analizimi i aspekteve afatshkurtër dhe afat-gjatë të efekteve të vendimmarrjes që lidhen me fëmijën. Kështu një vendim nuk do të ishte në interesin më të lartë të fëmijës nëse ky interes ekziston në kontekstin afatshkurtër, por rezulton jo i mirëqenë në kontekstin afatgjatë.

Gjithashtu, interesi më i mirë i fëmijës, duhet të garantohet dhe të jetë konsideratë mbizotëruese jo vetëm në vendimmarrjen për fëmijën si individ, por edhe si grup individësh, p.sh. gjatë veprimtarisë legislative apo administrative lidhur me fëmijët si subjekte të drejtpërdrejtë apo të interesuar.

Dhe në fund të nenit 5, konkretisht paragrafi 5 ka përcaktuar edhe një rregull në bazë të të cilit duhet interpretuar interesi më i mirë i fëmijës:

'Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa (neni 5 par.4)'.

ME RËNDËSI:

Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara thekson rëndësinë e të kuptuarit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës sipas këtyre tre koncepteve³:

■ Kjo është e drejtë substanciale dhe e patjetërsueshme:

E drejta e fëmijës për t'ia vlerësuar dhe konsideruar si primar interesin e tij më të mirë, kur interesa të ndryshëm janë duke u konsideruar në të njëjtën kohë, dhe për të garantuar që kjo e drejtë do të zbatohet kurdo që një vendim merret në lidhje me fëmijën.

■ Parim themelor ligjor me karakter mbizotërues me rastin e interpretimeve ligjore:

Nëse ndonjë dispozitë është e hapur për një apo më tepër interpretime, interpretimi i cili në mënyrë efektive i shërben interesit të fëmijës duhet të përzgjidhet. Të drejtat e përcaktuara në KDF dhe protokollet opsionale ofrojnë kornizën për interpretim.

■ Rregull procedural që udhëheq zbatuesit e legjislacionit në përgjithësi:

Kurdo që një vendim duhet të merret dhe i cili ndikon tek ndonjë fëmijë i caktuar, grupin e identifikuar apo fëmijët në përgjithësi, procesi i këtillë i vendimmarrjes duhet të përmbajë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv apo negativ) të vendimit në lidhje me fëmijën apo fëmijët. Vlerësimi dhe përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës kërkon garancione procedurale. Për më tepër, arsyetimi duhet të tregojë që e drejta e caktuar është marrë parasysh. Në këtë aspekt, duhet sqaruar:

- se si është respektuar e drejta në atë vendim;
- çka është konsideruar si interesi më i mirë i fëmijës;
- në cilat kritere është bazuar;
- dhe se si interesi më i mirë i fëmijës është peshuar kundrejt konsideratave të tjera.

2.2. Zhvillimi gradual i aftësive

'Parimi i zhvillimit gradual të aftësive, duhet të merret parasysh në përputhje me zhvillimin e aftësive të fëmijës, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që njihen nga legjislacioni në fuqi dhe Konventa dhe t'iu jepet rëndësia e duhur në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, personat e tjerë të besueshëm, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative' (neni 6 i LMF).

Edhe pse KDF këtë parim e njeh si 'E drejta e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim', LMF ka inkorporuar parimin e zhvillimit gradual të aftësive si një parim të kombinuar ndërmjet të drejtave dhe parimeve të tjera.

Edhe pse emërtimi ndoshta duket ndryshe, me rëndësi është të kuptohet përmbajtja e tij dhe se çka na udhëzon ky parim në praktikë. Përkundër faktit që e drejta për jetë dhe mbijetesë janë të panegociueshme dhe njëtrajtshëm të rëndësishme, ligdhënësi tek ky parim ka vënë theksin e zhvillimit të fëmijës në mënyrë graduale duke respektuar të gjitha fazat e zhvillimit që nga momenti i lindjes e deri në arritjen e moshës madhore.

³Komenti i përgjithshëm nr. 14 (2013) mbi të drejtën e fëmijës që interesat e tij/saj më të mira të merren si konsideratë parësore CRC/C/GC/14. Pika 6 (a,b,c).

KOMENT:

Parimi i i zhvillimit gradual të aftësive është i njohur me Nenin 5 të KDF, i cili parashikon:

*‘Shtetet Palë do të respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, kur është e zbatueshme, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të komunitetit, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ligjor ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, që të sigurojnë, në përputhje **me zhvillimin e aftësive të tij**, udhëheqjen e duhur për ushtrimin, nga ana e fëmijës, të të drejtave të njohura në këtë konventë’⁴.*

Ky nen njuh disa çështje të ndërlidhura:

- Prindërit dhe kujdestarët e tjerë kanë të drejtë dhe detyrë që t’ju ofrojnë fëmijëve udhëzime në raport me ushtrimin e të drejtave të tyre;
- Udhëzimet e ofruara duhet të jenë ‘të përshtatshme’;
- Kapaciteti i fëmijëve për të ushtruar të drejtat e tyre rritet me kalimin e kohës dhe, siç rritet ky kapacitet, nevoja për udhëheqje dhe udhëzime zvogëlohet në mënyrë proporcionale;⁵
- Shteti duhet të respektoj këtë dinamikë ndërmjet fëmijëve dhe prindërve.

2.3. Respektimi i pikëpamjes së fëmijës

Parashikimi i këtij parimi, tregon se i rrituri, familja, komuniteti dhe institucionet publike apo private nuk mund ta konsiderojnë më fëmijën si një qenie pasive, por si një qenie që merr pjesë në mënyrë aktive, në përputhje me intelektin e tij, në organizimin e jetës së tij dhe të ambientit që e rrethon.

SQARIM:

Termi i përdorur ‘pikëpamje’ në LMF është përshtatur nga termi ‘view’ që përdoret në gjuhën angleze nga KDF. Ky term në gjuhën shqipe mund të përdoret si sinonim edhe për termat ‘mendim’ ose ‘opinion’. Andaj në përkthimet e ndryshme të KDF në gjuhën shqipe, si dhe ligjet e ndryshme që janë në fuqi mund të hasin terma të ndryshme, por që kanë të njëjtin qëllim.

‘Në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, kanë për obligim t’i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t’i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi’ (neni 7 par.1 i LMF).

⁴Në mënyrë të ngjashme, neni 14.2 i KDF parashikon «Shtetet Palë do të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, kur është zbatueshme, kujdestarëve ligjor, për të ofruar drejtim fëmijës në ushtrimin e të drejtës së tij ose të saj në përputhje me zhvillimin e aftësive të fëmijës.”

⁵Komenti i përgjithshëm nr.7 mbi Zbatimin e të drejtave të fëmijëve në fëmijërinë e hershme, nga viti 2005, paragrafi 17, Komenti i përgjithshëm nr.12, paragrafi 84 dhe Komenti i përgjithshëm nr.14, paragrafi 44.

KOMENT:

Me qëllim që të përcaktohet se cili është interesi më i mirë i fëmijës është njëkohësisht e nevojshme dhe e logjikshme që fëmija të dëgjohet dhe pikëpamjet e tij të konsiderohen. Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës është një nga parimet themelore të LMF, interpretimi dhe zbatimi i të cilit është i lidhur me zbatimin e të gjitha parimeve dhe të drejtave të tjera në LMF dhe KDF. Ai ritheksohet si parim edhe në nene të tjera të LMF siç janë nenet 27 par.4, neni 34 par.2 dhe neni 48 par.4. Poashtu edhe në KDF përsëritet si parim, siç është neni 21 par.1, *“Shtetet Palë duhet t’i garantojnë fëmijës që është i/e aftë për të krijuar pikëpamjet e tij/saj të drejtën për t’i shprehur lirisht këto pikëpamje në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të”*.

LMF përveç që kërkon që pikëpamjet e fëmijës të dëgjojnë ato duhet edhe të merren në konsideratë. Marrja në konsideratë është pikërisht garancioni që kërkohet sipas nenit 7, sepse në praktikë në raste të caktuara fëmija mund të ofrojë pikëpamjet e tij, por ato mund të mos merren në konsideratë. Pikëpamjet mund të mbesin vetëm fjalë nëse nuk i jepet rëndësia e duhur në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, dhe në bazë të vlerësimit profesional ato edhe duhet të merren në konsideratë.

LMF ka paraparë përgjegjësitë e përfaqësuesit të fëmijës. Përgjegjësi e përfaqësuesit është që të paraqesë opinionet dhe pikëpamjet e fëmijës në çdo vendim që ka të bëjë me të. Përfaqësues mund të jetë njëri nga prindërit, një kujdestar ose një palë e tretë e caktuar nga shteti, për të përfaqësuar interesat e fëmijës.

‘Në të gjitha veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, posaçërisht në çështjet administrative dhe procedura gjyqësore, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës, duhet të merren në konsideratë në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës’ (neni 7 par.2 i LMF).

Kjo kërkon që’ (neni 7 par.3 i LMF):

- Fëmija të merr informacion adekuat rreth procedurave dhe vendimeve, të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tij, rëndësinë dhe efektin e mundshëm të pjesëmarrjes së tij në mënyrë dhe gjuhë që fëmija mund të kuptojë (neni 7 par.3. pika 1).
- Fëmijës i jepet mundësia për të shprehur pikëpamjet dhe dëshirat, si dhe merr *ndihmën e nevojshme për ta bërë këtë në një mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues* (neni 7 par.3. pika 2).
- *Pikëpamjes dhe dëshirave të fëmijës i jepet peshë e duhur kur bëhet një analizë rast pas rasti dhe tregon se fëmija është i aftë të formojë pikëpamjet e veta në një mënyrë të arsyeshme dhe të pavarur* (neni 7 par.3. pika 3).
- Fëmija informohet për rezultatet e procedurës dhe i jepet mundësi për t’iu përgjigjur *procedurave dhe vendimeve’*, dhe (neni 7 par. 3. pika 4).
- Fëmija merr ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin në fuqi’ (neni 7 par. 3. pika 5).

Paragrafi 2 dhe 3 të nenit 7, përveç që konfirmojnë të drejtën e fëmijës për t’iu marrë në konsideratë pikëpamjet e tij, ato më tej japin detaje udhëzuese për zbatim të këtij parimi, si më poshtë:

- Pikëpamja e tij duhet të jetë në lidhje me moshën dhe nivelin e pjekurisë;
- Fëmija duhet të marrë informacione të duhura;

- Pjesëmarrja e fëmijës duhet të jetë kuptimplote, dhe në gjuhën dhe mënyrën që fëmija mund ta kuptojë, dhe jo në gjuhën zyrtare burokratike;
- Fëmijës duhet t'i ofrohet gjithnjë ndihmë të shprehet në një mjedis dhe ambient që është konform moshës dhe zhvillimit të fëmijës dhe që inkurajon dhe motivon fëmijën të shpreh pikëpamjet e tij;
- Fëmija duhet të ketë hapësirë dhe mundësi që të shprehet lirshëm, në mënyrë të arsyeshme dhe të pavarur;
- Fëmija duhet të informohet me kohë dhe ti jepet mundësia për të shfrytëzuar mjetet juridike dhe për të kundërshtuar vendimet;
- Gjatë gjithë kohës duhet ofruar ndihmë juridike dhe profesionale pa pagesë.

KUJDES:

Për arsye se parimi i interesit më të mirë të fëmijës, është gjithmonë prioritar, fëmijës duhet t'i garantohet edhe e drejta për të mos shprehë pikëpamjet/mendimet e tij në rast se kjo është në interes të tij dhe kjo është dëshira e tij. Pra jo gjithëherë fëmija patjetër duhet të shprehet. Mos shprehja dhe heshtja, mund të jenë pjesë e pikëpamjeve të fëmijës, sepse ai ashtu mund ta kuptojë dhe vlerësojë një rrethanë apo situatë të caktuar.

Mosha e fëmijës është një kriter i rëndësishëm që bën ndryshimin në lidhje me konsiderimin e mendimit të tij, megjithatë LMF nuk ka vendosur një minimum moshe për sa i përket të drejtës për të shprehur lirisht pikëpamjet. Kjo është një e drejtë që do të jetë e lidhur me aftësinë e fëmijës për të marrë vendime për veten. Si pasojë, sa më i madh të jetë fëmija në moshë, aq më shumë përgjegjësi dhe të drejtë për të vetëvendosur duhet t'i jepet, dhe aq më shumë rëndësi duhet t'i jepet pikëpamjeve të tij.

Referenca nga disa prej ligjeve të aplikueshme:

Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare

'Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër kujdestarie gjykata do t'u kushtojë rëndësi të veçantë: a. dëshirave dhe ndjenjave të verifikuara të fëmijës në fjalë, b. nevojave fizike, emocionale dhe arsimore të tij' (neni 10 par. 10.15 pikat a. dhe b.).

Ligji për Familjen

'Mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të japë pikëpamjet e tij/saj, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij. Mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar' (neni 140 par.5).

Kodi i Drejtësisë për të Mitur

*'Avokatët mbrojtës duhet t'i konsiderojnë të miturit si klientë me të drejta të plota, që nënkupton se ata janë të obliguar që të marrin parasysh dhe paraqesin mendimet e tyre, si dhe t'iu sigurojnë atyre të gjitha informatat dhe sqarimet e nevojshme në lidhje me pasojat e mundshme të **pikëpamjeve dhe mendimeve** të tyre' (neni 41 par.5).*

*'Fëmija viktimë apo dëshmitar ka të drejtë t'i shprehë **pikëpamjet, opinionet dhe bindjet** e tij lirisht, me fjalët e tij, dhe ka të drejtë të japë kontribut për vendimet që ndikojnë në jetën e tij, përfshirë vendimet që merren gjatë procesit gjyqësor' (neni 111 par.6).*

'Fëmija, që nuk është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo or-

ganet legislative, kanë për obligim t'i garantojnë fëmijës mbrojtjen e njëjtë, sikur në rastet kur fëmija është në gjendje të shpreh pikëpamjet e tij në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi' (neni 7 par.4 i LMF).

LMF në parim ka përcaktuar që e drejta për të shprehur pikëpamjet i takon fëmijës, mirëpo duke u nisur nga parimi i interesit më të mirë të fëmijës dhe në rastet kur fëmija nuk është i aftë të formojë dhe nuk mundet t'i shpreh ato, institucionet duhet të sigurojnë që çdo vendim që merret për fëmijën, të konsiderohet sikur është marrë në rastet kur fëmija ka shprehë pikëpamjen.

2.4. Mos diskriminimi

Parimi i mosdiskriminimit është një nga parimet bazë dhe mjaft të rëndësishëm të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. LMF pavarësisht që për këtë parim më tepër i është referuar Ligjit përkatës për Mbrojtje nga Diskriminimi, përsëri ka dhënë një udhëzim të detajuar në kuptim të mbrojtjes së fëmijës nga diskriminimi:

'Çdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t'i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë' (neni 8 par.1 i LMF).

KOMENT:

Siç shihet LMF në këtë paragraf ka përcaktuar që fëmijës përveç të drejtave të njohura në këtë ligj, në mënyrë të barabartë t'i garantohet dhe njihen edhe të drejtat që janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe KDF në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim.

Parimi i mosdiskriminimit është i inkorporuar edhe në ligje tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijë:

- Ligji i Familjes, neni 4;
- Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 2.1;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nenet 1 dhe 111;
- Ligji i Punës, nenet 1.17 dhe 5;
- Ligji për Arsimin Parashkollor, neni 4;
- Ligjit për Shëndetësi, neni 5, etj.

Edhe KDF në kuadër të parimeve ka përcaktuar rrethanat dhe situatat që ndërliken me parimin e mosdiskriminimit:

'Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmijë, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose e përfaqësuesve të tij ligjorë' (par.1).

'Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij' (par.2).

Sidoqoftë, neni 2 i KDF është një pohim i gjerë mosdiskriminues dhe fraza **"çdo status tjetër"** duke pasur karakter jo shterues ka si qëllim të përfshijë elemente të tjerë për diskriminimin të cilat nuk janë përmendur në mënyrë specifike në nenin 2.

'Të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit' (neni 8, par.2 i LMF).

'Prindërit apo kujdestari, anëtarët e familjes, personi i besueshëm, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj fëmijës, mund të iniciojnë procedurë dhe paraqesin fakte para organit kompetent, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi' (neni 8, par.3 i LMF).

KOMENT:

Paragrafet e fundit përcaktojnë obligimet dhe veprimet që duhet ndërmarrë për mbrojtjen e fëmijës nga diskriminimi. Paragrafi 2 parasheh dhe krijon obligime për institucionet, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët, pra këtu barra e veprimeve dhe masave që duhet ndërmarrë bie mbi institucionet publike dhe private. Ndërsa paragrafi 3 parasheh dhe krijon obligime për prindërit, kujdestarët, anëtarët e familjes dhe personat e besueshëm të cilët mund të iniciojnë procedurë dhe të paraqesin fakte para organeve kompetente.

Është me rëndësi të kuptojmë që mbrojtja nga diskriminimi nuk duhet realizuar vetëm fëmijës që ka shtetësi në Republikën e Kosovës, mirëpo duhet zbatuar pa asnjë përjashtim edhe për fëmijët e tjerë ndaj të cilëve vepron dhe u ofron mbrojtje ligji (shih më lart fushëveprimi i ligjit).

Në këtë aspekt dhe për të ndërlidhur zbatimin e këtij parimi, një vëmendje e shtuar duhet dhënë fëmijëve të cilët janë më të cenueshëm si p.sh.:

- Fëmijës më aftësi të kufizuar;
- Prejardhjes etnike (grupeve minoritare);
- Gjendjes ekonomike dhe sociale;
- Fëmijëve të shpërngulur, azilkërkues, refugjatë, etj.

Parandalimi i diskriminimit është një detyrim i Shteteve Palë, i cili kërkon veprime si ato të parashikuara në nenin 2 (2) të KDF. Koncepti i veprimit pohues/diskriminimi pozitiv - ose trajtimi i disa njerëzve ndryshe me qëllimin për t'i siguruar atyre mbështetje të veçantë për të korrigjuar diskriminime të mëparshme apo aktuale - është e pranuar nga KDF. Në fakt, detyrimi i Shteteve Palë për t'i dhënë mbështetje grupeve të cenueshme të fëmijëve përfshin më shumë se thjesht sigurimin që këta fëmijë të mos diskriminohen. Kërkohet gjithashtu ndërmarrja e masave, me qëllim përmirësimin e situatës së tyre. KDF pret që Shtetet Palë të marrin masa proaktive me qëllim dhënies fund diskriminimit. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët të gëzojnë pa dallim të drejtat e konventës.

II. ANEKS

A) RAST STUDIMI

RASTI A

Vendimet e gjykatave vendase për rikthimin e tre fëmijëve tek babai i tyre kundër vullnetit të tyre dhe pa bërë vlerësimin e duhur mbi interesin e tyre më të lartë përbënte shkelje të nenit 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN N.TS. DHE TË TJERËT K. GJEORGJISË

(Kërkesa nr. 71776/12)

2 Shkurt 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, znj. N.TS., ishte shtetase gjeorgjiane e lindur në 1976, e cila jetonte në Tbilisi. Tre fëmijët e saj – djali N.B., dhe dy djem binjakë, S.B. dhe L.B. - kishin lindur në 2002 dhe 2006 dhe ishin të mitur në kohën e procesit.

Pas vdekjes së nënës së tre djemve, në Nëntor 2009, tre djemtë e saj shkuan të jetonin me tezen e tyre dhe gjyshërit nga ana e nënës. Në fund të Dhjetorit të 2009, babai i fëmijëve z. G.B. kërkoi kthimin e tre djemve të tij, por gjyshërit nga ana e nënës refuzuan. Ky refuzim vinte kryesisht si pasojë e abuzimit të tij me drogën (megjithëse në 2008 ai kishte filluar të trajtohej me programin e metadonit) disa dënime të mëparshme lidhur me abuzimin me drogën dhe faktit që në vitin 2008 ai u diagnostikua me çrregullime në sjellje dhe çrregullime psikiatrike. Megjithatë, referuar dosjes mjekësore, në Shkurt 2010 diagnoza e tij tregonte se varësia e tij ndaj drogës ishte ulur, dhe ai nuk paraqiste ndonjë kërcënim as ndaj vetes së tij dhe as ndaj personave që e rrethonin. Më tej, referuar një certifikate tjetër mjekësore, ai nuk vuante nga asnjë patologji psikiatrike.

Më 5 Janar 2010, z. G.B. i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tbilisit kthimin e djemve të tij. Pavarësisht vendimit të gjykatës për të përfshirë në këtë rast Agjencinë e Shërbimit Social (AShS) duke i kërkuar asaj të emëronte një përfaqësues për të mbrojtur interesat e djemve dhe për të kryer një vlerësim të kushteve të jetesës së babait dhe gjyshërve nga ana e nënës, përfaqësuesit e AShS nuk u përfshinë në këtë fazë të procesit. Ata morën pjesë vetëm në procesin e mëvonshëm në apel të inicuar nga familja e nënës, në statusin e “palës së interesuar”.

Në Maj 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tbilisit vendosi që të tre djemtë të ktheheshin tek babai i tyre, duke e konsideruar këtë kthim të dobishëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e tyre fizik dhe intelektual. Gjykata i njohu z. G.B aftësinë për përgjegjësitë e tij prindërore, pavarësisht se një raport i ekspertëve rekomandonte se djemtë nuk duhej të ndryshonin mjedisin jetësor pasi ata kishin vuajtur nga çrregullime të ankthit nga ndarja dhe kishin shfaqur një qëndrim negativ ndaj babait të tyre.

Familja nga ana e nënës apeloj në Gjykatën e Apelit të Tbilisit duke u ankuar lidhur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila i kishte dhënë përparësi të drejtave të babait në vend që të udhëhiqej nga interesi më i lartë i fëmijëve. Në Shkurt 2011, Gjykata e Apelit e prishi vendimin e ankimuar dhe vendosi që tre djemtë duhet të qëndrojnë me familjen e prindërve nga nëna. Megjithatë, në Tetor 2011, Gjykata Supreme e Gjeorgjisë e ktheu çështjen për rishqyrtim. Më 2 Shkurt 2012, Gjykata e Apelit e Tbilisit, e hodhi poshtë vendimin e mëparshëm, duke konkluduar se fëmijët duhet të jetojnë me z. G.B. Ankimi i bërë nga tezet dhe gjyshërit nga nëna në Gjykatën Supreme të Gjeorgjisë u hodhën poshtë në Maj të vitit 2012.

Me qëllim ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tbilisit u bënë dy përpjekje lidhur me kthimin e djemve tek babai pasi fëmijët refuzonin të shkonin me z. G.B. Në kohën e procesit para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, djemtë po jetonin me gjyshërit nga ana e nënës dhe tezet.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkesja pretendoi e drejta e nipërve të saj për respektimin e jetës private dhe familjare të sanksionuar në nenin 8 të Konventës ishte shkelur për shkak të vendimit të gjykatave të brendshme për t'i kthyer fëmijët tek babai i tyre. Ajo parashtroi në veçanti se autoritetet kombëtare nuk kishin arritur të vlerësonin tërësisht interesat më të larta të djemve dhe se proceset kishin pasur të meta procedurale.

Qëllimi i kërkesës dhe pranueshmëria

Kërkesja e bëri të qartë se ajo paraqiti një kërkesë në Gjykatë vetëm në emër të nipërve të saj, dhe nuk ishte duke ndjekur ndonjë kërkesë të mundshme në emër të saj. Qeveria deklaroi se tezja nuk kishte *locus standi* për të bërë kërkesë në emër të saj.

Gjykata u shpreh se do të kufizonte shqyrtimin e çështjes në dy pyetjet e mëposhtme: nëse znj. N.Ts. kishte *locus standi* për t'u ankuar në emër të nipave të saj dhe, nëse po, a ishte shkelur e drejta e të miturve për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare për shkak të vendimit të gjykatave vendase për kthimin e tyre tek babai.

Qeveria argumentoi se kërkesja nuk kishte tagrin e nevojshëm për të vepruar në emër të nipërve të saj, pasi babait të djemve nuk i ishte privuar e drejta e tij prindërore, ai ishte kujdestari i tyre i vetëm ligjor pas vdekjes së nënës së tyre dhe djemtë asnjëherë nuk ishin vënë nën kujdestarinë e tezeve të tyre. Këtu Gjykata theksoi se të tre djemtë haptazi ishin në pozita vulnerable. Ata ishin të mitur që kishin humbur nënën e tyre dhe kishin një marrëdhënie të komplikuar, madje armiqësore me babanë e tyre. Në rrethanat e aktuale, nuk kishte dyshim se tezja kishte një lidhje mjaft të ngushtë me nipat e saj për t'u ankuar në emër të tyre, duke pasur parasysh faktin se që nga vdekja e nënës së tyre, ajo ishte kujdesur dhe kishte siguruar një banesë të qëndrueshme për ta.

Më tej, Gjykata shqyrtoi çështjen për të përcaktuar nëse plotësonte dy kritere shtesë: së pari, rreziku që pa kërkesën e tezes, djemtë do të ishin privuar nga një mbrojtje efektive e të drejtave të tyre; dhe se nuk kishte konflikt interesi mes tyre dhe tezes. Për sa i takon kriterit të parë, duke pasur parasysh situatën e familjes së djemve, haptazi nuk kishte asnjë të afërm tjetër që mund të ishte ankuar në emër të tyre. Rrjedhimisht, nuk kishte burim alternativ të përfaqësimit që do të ngrinte dyshimin se roli i tezeve të tyre ishte i papërshtatshëm ose i panevojshëm. Sa i përket kriterit të dytë, thelbi i kërkesës ishte dyshimi nëse autoritetet vendase kishin respektuar aspektin procedural sipas parashikimeve të konventës dhe nëse kishin vepruar në interesin më të lartë të fëmijëve. Për rrjedhojë, Gjykata, nuk vërejti ndonjë konflikt interesi midis tezeve dhe nipërve të saj në

këtë pikë, duke marrë parasysh faktin se ajo nuk u ankua në emër të saj. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata konsideroi se teza kishte tagër për të paraqitur një kërkesë në emër të nipërve të saj.

Neni 8

Gjykata konstatoi se thelbi i çështjes të paraqitur në parashtrimet e tezes lidhur me të drejtat e nipërve të saj sipas nenit 8 ishte shkelur, sepse gjykatat vendase nuk kishin arritur të vlerësonin tërësisht gjendjen e tyre dhe të merrnin në konsideratë interesin e tyre më të lartë. Këtu ekzistojnë dy aspekte themelore për tu shqyrtuar: nëse djemtë ishin përfshirë në mënyrë të rregullt në proces dhe nëse vendimet e marra nga gjykatat vendase u diktuan nga interesat e tyre më të larta.

Edhe pse gjykata e shkallës së parë kishte kërkuar emërimin e një përfaqësuesi të ASHS për djemtë, Gjykata kishte rezerva lidhur me rolin specifik që kishte luajtur përfaqësuesi gjatë proceseve të brendshme. ASHS ishte përfshirë formalisht në proces që nga apeli dhe vetëm në statusin e “palës së interesuar”, për të cilën Kodi i Procedurës Civile nuk kishte parashikuar asnjë dispozitë. Prandaj, ishte e paqartë se si ASHS mund të kishte përfaqësuar në mënyrë efektive interesat e fëmijëve, për shkak se ajo nuk kishte tagër përfaqësimi. Përveç kësaj, mbetet e paqartë se çfarë nënkuptonte saktësisht një përfaqësim i tillë nga ana e ASHS, pasi legjislacioni përkatës nuk përcaktonte funksionet dhe kompetencat e përfaqësuesit të caktuar sipas skemës së sipërpërmendur. Gjatë procesit i cili zgjati më shumë se dy vite përfaqësuesit e ASHS-së takuan djemtë vetëm disa herë me qëllimin e vetëm të hartimit të disa raporteve mbi kushtet e tyre të jetesës dhe gjendjen e tyre emocionale. Megjithatë, nuk ishte mbajtur ndonjë kontakt i rregullt për monitorimin e djemve dhe krijimin e një marrëdhënieje të besueshme me ta.

Në këtë kontekst, Gjykata ju referua instrumenteve të disa organeve ndërkombëtare ku në rastet kur ekzistojnë interesa konfliktuale ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, kërkohet sigurimi i një kujdestari *ad litem* ose emërimi i një përfaqësuesi tjetër të pavarur me qëllim përfaqësimin e pikëpamjeve të fëmijës dhe për ta mbajtur atë të informuar në lidhje me procesin.

Vendimi i gjykatave vendase për kthimin e djemve tek babai i tyre ishte kryesisht i bazuar në dy arsye: interesi më i lartë i djemve që të ribashkohen me babanë e tyre dhe ndikimi negativ i familjes së nënës tek djemtë. Ndërsa Gjykata e pranoi këtë arsyetim, ajo nënvizoi se gjykatat vendase nuk arritën të merrnin në konsideratë faktin se djemtë nuk donin të ribashkoheshin me babanë e tyre. Çfarëdo manipulimi që mund të këtë bërë familja e nënës në armiqësimin e djemve ndaj babait të tyre, provat në lidhje me qëndrimin armiqësor të djemve ndaj tij ishin të paqarta. Për më tepër, disa raporte të psikologëve kishin paralajmëruar për rreziqet e mundshme mbi shëndetin psikologjik të djemve në rast të kthimit të detyruar tek babai i tyre. Në këto rrethana, një masë e tillë rrënjësore pa marrë parasysh masat përgatitore që synonin të ndihmonin djemtë dhe babain e tyre në rindërtimin e marrëdhënieve, binte në kundërshtim me interesat e djemve.

Gjykata arriti në përfundimin, se përfaqësimi jo i duhur dhe dështimi pasues për të paraqitur dhe dëgjuar në mënyrë të rregullt pikëpamjet e djemve, si dhe për të marrë në konsideratë interesat e tyre më të larta dhe gjendjen emocionale, kishin minuar procesin e rregullt të vendimmarrjes, duke shkelur për rrjedhojë të drejtat e garantuara në nenin 8.

Neni 41

Gjykata konkludoi se Gjeorgjia duhej t'u paguante të tre djemve së bashku 10,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 900 euro për shpenzimet gjyqësore.

RASTI B***Segregimi i fëmijëve romë në një shkollë fillore kroate përbënte diskriminim dhe shkelte nenin 14 dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1*****VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN ORSUS DHE TË TJERËT K. KROACISË**

(Kërkesa nr. 15766/03)

16 Mars 2010**1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin 15 shtetas kroat me origjinë romë. Ata kishin lindur ndërmjet viteve 1988 dhe 1994 dhe jetonin të gjithë në Kroacinë e veriut. Në Prill 2002 kërkuesit nisën një proces gjyqësor kundër shkollave të tyre fillore. Ata pretenduan se kurrikula e tyre mësimore kishte 30% më pak përmbajtje se kurrikulat zyrtare kombëtare. Ata pretenduan se kjo ishte një situatë e pastër e diskriminimit racor dhe cenonte të drejtën e tyre për arsim, si dhe të drejtën e tyre për tu mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Gjithashtu, kërkuesit paraqitën një studim psikologjik të fëmijëve romë që kishin ndjekur klasat që përbëheshin vetëm nga fëmijë romë në rajonin e tyre. Ky raport shfaq se fëmijët që kishin ndjekur këtë edukim të segreguar kishin pësuar dëm emocional dhe psikologjik, si në aspektin e vetëvlerësimit ashtu edhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Në Shtator të vitit 2002, Gjykata Komunale rrëzoi padinë e kërkuesve. Pasi që vërejti se arsyeja pse pjesa më e madhe e nxënësve romë ishin vendosur në klasa të veçanta ishte për shkak se ata kishin nevojë për tutorim shtesë në gjuhën kroate. Për më tepër, kurrikula në shkollat fillore Podturen dhe Macinec ishte e njëjtë me atë të përdorur në klasat e tjera paralele të këtyre shkollave. Rrjedhimisht, kërkuesit nuk kishin arritur të vërtetonin pretendimet e tyre lidhur me diskriminimin racor. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Gjykata e Apelit. Ankimi kushtetues i kërkuesve paraqitur në Nëntor 2003 u rrëzua mbi bazë të të njëjtave argumente në Shkurt të vitit 2007.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkuesit pretenduan se segregimi i tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës romë i kishte cenuar atyre të drejtën e edukimit në mjedis multikulturor duke i diskriminuar. Ky trajtim i kishte sjellë dëme të rënda edukuese, psikologjike dhe emocionale, veçanërisht në lidhje me faktin që ndiheshin të huaj. Ata gjithashtu u ankuan për kohëzgjatjen e tepërt të proceseve gjyqësore vendase. Ata u mbështetën në veçanti në nenin 3, nenin 6 & 1, nenin 2 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në vendimin e 17 Korrikut 2008, Dhoma e Gjykatës vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1 dhe nenit 14 të Konventës, në lidhje me vendosjen e kërkuesve në klasa të përbëra vetëm nga nxënës romë, ndërsa gjeti shkelje të nenit 6 & 1 të konventës në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore jashtë një afati të arsyeshëm veçanërisht përpara Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 43 të Konventës çështja iu referua për shqyrtim Dhomës së Madhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 6&1

Gjykata vërejti se kohëzgjatja e procesit gjyqësor për më shumë se katër vjet për një çështje të kësaj rëndësie kishte qenë e tepërt. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së kërkuesve për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur kështu nenin 6 dhe 1 të konventës.

Neni 14 dhe neni 2 i Protokollit Nr. 1

Gjykata vërejt se ky rast përbënte kryesisht një çështje diskriminimi. Ajo risolli në vëmendje gjetjet e evidentuara të mëparshme, ku është vërejtur që si rezultat i historisë së tyre, romët janë bërë një lloj i veçantë minoriteti i pa favorizuar dhe i pambrojtur. Për rrjedhojë, atyre u duhet siguruar një mbrojtje e veçantë, duke përfshirë edhe sferën e arsimit.

Gjykata mori në shqyrtim argumentin e paraqitur nga qeveria kroate, për vendosjen e kërkuesve në klasa që përbëheshin vetëm nga romë, për shkak të problemeve në zotërimin e gjuhës kroate dhe vërejt se ky veprim nuk binte domosdoshmërisht në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Megjithatë, kur kjo masë ndikon vetëm mbi anëtarë të një grupi të caktuar autoritetet duhet të marrin masa mbrojtëse specifike.

Ligji kroat i kohës nuk ofronte klasa të veçanta për fëmijët që nuk kishin njohuri të mira të gjuhës kroate. Përveç kësaj, testet që përcaktin nëse fëmijët do të regjistroheshin në klasa të përbëra vetëm nga romë nuk ishte hartuar në mënyrë specifike për të vlerësuar zotërimin e gjuhës kroate, por kishin një karakter për përcaktimin e gjendjes së përgjithshme psiko fizike.

Për sa i përket kurrikulës, pasi u regjistruan në klasa të përbëra vetëm nga nxënës romë kërkuesve nuk iu ishte ofruar një program i hartuar posaçërisht për të adresuar mungesat e pretenduara gjuhësore. Ndërkohë, që kërkuesve iu ofruan klasa shtesë të gjuhës kroate, ato nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe kjo mundësi ekzistoi vetëm në disa faza të arsimit.

Të gjithë kërkuesit kishin kaluar një periudhë të konsiderueshme të arsimit të tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës romë. Megjithatë, nuk kishte ekzistuar asnjë procedurë e veçantë monitorimi dhe ndonëse disa nga kërkuesit ndonjëherë kishin ndjekur klasa të përziera, qeveria nuk kishte arritur të tregonte se çdo raport individual ishte hartuar në lidhje me secilin kërkues dhe përparimin e bërë në lidhje me zotërimin e gjuhës kroate. Mungesa e një procedure monitoruese transparente kishte lënë shumë hapësirë për arbitraritet.

Për më tepër, statistikak e paraqitura nga kërkuesit për rajonin në të cilin ata kishin jetuar, statistika këto që nuk u kundërshtuan nga qeveria, treguan një trend të braktisjes së shkollës nga nxënësit romë në masën 84%.

Për sa i përket pasivitetit të prindërve dhe mungesës së kundërshtimeve në lidhje me vendosjen e fëmijëve të tyre në klasa të veçanta, Gjykata u shpreh se prindërit, vetë anëtarë të një komuniteti të pa favorizuar dhe shpesh të dobët, nuk kishin qenë në gjendje të peshonin të gjitha aspektet e situatës dhe pasojat e dhënies së pëlqimit nga ana e tyre.

Për rrjedhojë, duke njohur përpjekjet e autoriteteve kroate për të siguruar që fëmijët romë të përfitojnë shkollim, Gjykata u shpreh se në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet nuk ishin marrë masat e duhura për të siguruar kujdes të mjaftueshëm për nevojat e veçanta të kërkuesve si anëtarë të një grupi të pa favorizuar. Kështu, vendosja e tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës romë nuk ishte e justifikuar dhe binte në kundërshtim me nenin 14 dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i caktoi secilit kërkues 4,500 euro në lidhje me dëmin jo material dhe të gjithëve së bashku 10,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

B) Agjenda

AGJENDA

Dita e parë Moduli I	
09:00 – 09:30	Objektivat e trajnimit dhe rezultatet e pritura
09:30 – 10:30	Kush është fëmijë, të drejtat e fëmijës dhe mbrojtja e fëmijës
10:30 – 11:00	Termet dhe përkufizimet
11:00 – 11:30	Instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacioni i aplikueshëm
11:30 – 12:00	Qëllimi dhe fushëveprimi i LMF
12:00 - 13:00	Dreka
13:00 – 13:30	Parimet e mbrojtjes së fëmijës
13:30 – 14:00	Përfituesit dhe zbatuesit e LMF
14:30 - 15:00	Instrumentet ligjore për mbrojtjen e fëmijëve
15:00 – 15:30	Raste studimi, punë në grupe
15:30 - 16:00	Reflektime dhe përmbyllje e ditës së parë

MODULI II:

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË - ROLI DHE PËRGJEGJËSITË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

PËRMBAJTJA

I. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTATET E PRITURA.....	33
KAPITULLI 1. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË NË NIVEL QENDROR	34
1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit.....	35
1.2. Ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës	36
1.2.1. Fusha e mirëqenies sociale.....	36
1.2.2. Fusha e drejtësisë dhe sigurisë	37
1.2.3. Fusha e edukimit dhe arsimit	39
1.2.4. Fusha e shëndetësisë	40
1.2.5. Bashkërendimi i përgjegjësive dhe veprimeve nga ministritë përkatëse	41
1.3. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit	42
1.4. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës	43
1.5. Këshilli për të Drejtat e Fëmijës.....	44
KAPITULLI 2. STRUKTURA DHE MEKANIZMAT INSTITUCIONALË NË NIVEL LOKAL.....	45
2.1. Komuna.....	45
2.2. Drejtoritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës.....	46
2.3. Qendra për Punë Sociale	47
2.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.....	48
2.5. Tryezat Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit.....	49
KAPITULLI 3. MEKANIZMAT E NDIHMËS DHE KOMUNIKIMIT ME FËMIJËN	51
3.1. Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë.....	51
3.2. Platforma ‘know your rights - njih të drejtat e tua’	52
3.3. Roli i personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.....	52
3.4. Mekanizmat ndërsektorialë dhe institucionet kushtetuese	53
IV. ANEKS	54
A) Rast studimi	54
B) Agjenda.....	57

I. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivë kryesore e Modulit të Dytë është njohja dhe familjarizimi me mekanizmat institucionalë që janë të themeluar apo që pritet të themelohen në Republikën e Kosovës, e që në parim apo ndër të tjera kanë për qëllim mbrojtjen e fëmijës. Institucionet dhe trupat që do të themelohen do të jenë garantues dhe mburojë e zbatimit të parimeve dhe të drejtave që janë paraparë në LMF.

Në fund të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- T'i kuptojnë cilat janë autoritetet dhe institucionet kryesore në Kosovë;
- Të njoftohen me rolet dhe përgjegjësitë e mekanizmave dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal;
- Cili është dallimi ndërmjet mekanizmave dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal;
- Cilat janë mekanizmat e ndihmës dhe komunikimit me fëmijën;
- Ku mund të adresojnë fëmijët, prindërit dhe profesionistët e mbrojtjes së fëmijës, ndonjë ankesë apo të referojnë ndonjë rast?;
- Rritja e aftësive analitike përmes studimit të rasteve praktike, etj.

KAPITULLI 1

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË NË NIVEL QENDROR

1. *Institucionet qendrore janë të obliguara të zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe programe për mbështetjen e fëmijës dhe atyre që kujdesen për fëmijën, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së fëmijës, parandalimit të rrezikut për jetën, dhunën, neglizhimin, abuzimin, keqpërdorimin, braktisjen dhe shfrytëzimin, të sigurojnë zbatimin sipas standardeve të duhura të këtyre politikave dhe programeve nga ana e institucioneve dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.*
2. *Institucionet marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore, sociale, arsimore, shëndetësore dhe edukuese për parandalimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni dhe ofrimin e përkrahjes së nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.*
3. *Të gjitha institucionet dhe shërbimet që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij ligji, si dhe janë përgjegjëse për sigurimin e numrit dhe personelit të aftë për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.*
4. *Qeveria, përmes ministrive dhe njësive përkatëse, është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe standardeve, që të sigurohet qasje për familjet ndaj formave të ndryshme të mbështetjes për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me të gjitha masat dhe programet e mbështetjes në nivel lokal.*
5. *Kur familja e vendos fëmijën në situatë rreziku për t'u braktisur, abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar ose shfrytëzuar, ose e ekspozon ndaj akteve të shfrytëzimit dhe abuzimit, institucionet përkatëse kanë përgjegjësinë për të mbrojtur fëmijën dhe të sigurojnë kujdesin e përshtatshëm alternativ në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
6. *Ministritë përkatëse, në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe sigurojnë zbatimin e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave të tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi.*
7. *Ministritë përkatëse bashkëpunojnë me komunat, me njësitë përkatëse komunale, rrethet akademike, ministritë e tjera dhe me palët e interesuara për hartimin e politikave dhe legjislacionit për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e mbrojtjes së fëmijës.*

Neni 11 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF si pjesë e rregullimit të përgjegjësive të autoriteteve dhe mekanizmave në nivel qendror nën nenin 11 ka përcaktuar dhe ritheksuar cilat janë rolet kryesore. Pra, nga këtu derivojnë rolet e institucioneve qendrore për të:

- Zhvilluar politika dhe programe për mbrojtjen e fëmijës;
- Nxjerrjen e ligjeve, vendimeve administrative si dhe ndërmarrjen e masave të tjera në aspektin social, edukativ, shëndetësor arsimor, etj.;
- Sigurimin e përputhshmërisë dhe zbatimin e parimeve dhe dispozitave të LMF;
- Koordinimin e nivelit qendror dhe atij lokal;
- Bashkëpunimin me nivelin lokal, OJQ-të, rrethet akademike si dhe palët e interesuara në zbatimin e rolit dhe përgjegjësive nga institucionet qendrore.

Struktura dhe mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës në nivel qendror janë:

- Institucioni i Avokatit të Popullit;
- Ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës;
- Njësia përkatëse për qeverisje të mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;
- Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës;
- Këshilli për të Drejtat e Fëmijës.

Neni 9 par.1 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) apo siç njihet Ombudspersoni është njëri prej institucioneve kryesore të nivelit qendror nëpërmjet të cilit fëmija apo grupi i fëmijëve mund të realizojnë mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tyre.

1. Avokati i Popullit është institucion i pavarur i cili ndër të tjera i mbron të drejtat e fëmijës, të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.
2. Një zëvendës i Avokatit të Popullit, në kuadër të kompetencave të deleguara nga Avokati i Popullit, duhet të jetë përgjegjës edhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
3. Çdo fëmijë, person apo grup i personave mund t'i parashtrijë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi. Avokati i Popullit nxjerr Rregulloren për mënyrën e ankesës së fëmijës, siç përcaktohet në këtë ligj.
4. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin ankesat në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të prindit apo kujdestarit të tij, si dhe mendimin e fëmijës kur ai është në gjendje që të jap atë, për zhvillimin e procedurave tek Avokati i Popullit.
5. Kur Avokati i Popullit fillon procedurën me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të fëmijëve, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 4. i këtij neni.

Neni 10 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.⁶

Mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, IAP e realizon duke:

- Zbatuar Kushtetutën, LMF dhe ligjet tjera relevante, e me theks të veçantë KDF;
- Caktuar një zëvendës të Avokatit të Popullit si përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës;
- Pranuar ankesat drejtpërdrejtë nga fëmija, grup fëmijësh apo edhe nga shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike.

IAP, për të zbatuar kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, harton dhe nxjerr një rregullore të brendshme, nëpërmjet të cilës përcakton rregullat dhe procedurat për të drejtën e ankesës së fëmijës apo grupit të fëmijëve.

1.2. Ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës

Ministritë përkatëse, sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës si dhe në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe sigurojnë zbatimin e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave të tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Secila Ministri në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të fushëveprimit të saj ka obligime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, por me qëllim të përshtatjes me tematikat e rregulluara në LMF janë përzgjedhur këto fusha kryesore:

1.2.1. Fusha e mirëqenies sociale

Siç është përcaktuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale⁷ ka këto përgjegjësi por jo vetëm:

'Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, dialogut social, punësimit, aftësimin, politikave sociale, pensioneve⁸'

Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive⁹

⁶ Neni 3, Ligji nr. 05/I -019 për Avokatin e Popullit.

⁷ Emërtimi i përdorur këtu është për t'ju përshtatur tematikave të cilat i rregullon LMF, si dhe për t'iu shmangur ndërrimeve të shpeshta që ndodhin me emërtimin e Ministrive nga Qeveritë të cilat vijnë në pushtet. Në kohën kur është duke u shkruar Moduli, p.sh. kjo Ministri quhet: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Emërtimet e ministrive në bazë të tematikave do të përdoren në të gjithë Modulet, dhe kjo nuk paragjykon tendencat e ndërrimit apo përcaktimit politik të dikastereve qeveritar.

⁸ Sipas rregullores kjo Ministri dhe Ministritë kanë edhe përgjegjësi tjera, mirëpo për qëllime të këtij moduli janë shprehur vetëm ato që kanë ndërlidhje me mbrojtjen e fëmijës.

⁹ Miratuar në mbledhjen e Qeverisë me Vendimin Nr. 01/02, datë 26.03.2021.

Ministria përkatëse për Mirëqenies Sociale në kuadër të fushëveprimtarisë së saj dhe kompetencave të parapara me ligj dhe akte të tjera nënligjore, koordinon, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet agjensioneve, departamenteve, divizioneve, zyrave përkatëse që janë nën mandatin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë përkatëse për mirëqenie sociale.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit/organogramit dhe mekanizmave që janë nën mandatin dhe përgjegjësinë e kësaj Ministrie kliko në këto faqe interneti¹⁰:

<https://mf.rks-gov.net/>
dhe
<https://mpms.rks-gov.net/>

Përveç mandatit dhe përgjegjësisë, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Mbrojtjen e fëmijëve të cenueshmëm, sikurse:
 - Fëmijët me aftësi të kufizuara;
 - Fëmijët pa kujdes prindëror;
 - Fëmijët në situatë rruge dhe të trafikuar;
 - Fëmijët kryes të veprave penale;
 - Fëmijët që abuzojnë me substanca narkotike dhe psikotrope;
 - Fëmijët që jetojnë në varfëri të skajshme dhe pa strehë;
 - Fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës në familje, etj.
- Licensimin e profesionistëve që punojnë dhe ofrojnë shërbime fëmijëve, veçanërisht zyrtarëve social.

1.2.2. Fusha e drejtësisë dhe sigurisë

a) Ministria përkatëse e Drejtësisë

Siç është përcaktuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria përkatëse për Drejtësi ka këto përgjegjësi por jo vetëm:

'Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi'

**Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të
zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive**

Ministria përkatëse e Drejtësisë në kuadër të fushëveprimtarisë së saj dhe kompetencave të parapara me ligj dhe akte të tjera nënligjore, koordinon, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet agjensioneve, departamenteve, divizioneve, zyrave përkatëse që janë nën mandatin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë përkatëse të Drejtësisë.

¹⁰ Faqet e internetit janë klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit/organogramit dhe mekanizmeve që janë nën mandatin dhe përgjegjësinë e kësaj Ministrie kliko në këtë faqe interneti¹¹:
<https://md.rks-gov.net/>

Përveç mandatit dhe përgjegjësisë, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Ministria përkatëse e Drejtësisë koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Mbrojtjen e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje;
- Parandalimin e delikucencës së të miturve;
- Luftimin e dukurive negative ku pjesëmarrës janë fëmijët;
- Programet e risocializimit për kryesit e mitur;
- Programet e rehabilitimit për të miturit dhe prindërit e tyre;
- Reintegrimit në familje dhe komunitet pas vuajtjes së dënimeve apo masave;
- Mbrojtjen e fëmijës dhe koordinimin e proceseve në lidhje me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve;
- Specializimin e profesionistëve që punojnë dhe ofrojnë shërbime fëmijëve, veçanërisht zyrtarëve sprovues, zyrtarëve korrektues dhe ndërmjetësve.

b) Ministria përkatëse e Punëve të Brendshme

Siç është përcaktuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria përkatëse për Punë të Brendshme ka këto përgjegjësi por jo vetëm:

'Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e rendit dhe sigurisë publike, sigurisë kibernetike, kufijve shtetëror, emergjencave, gjendjes civile, migracionit, azilit, riintegrit të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve, ri-pranimit dhe shtetësisë, forenzikës, organizatave jo qeveritare, shërbimeve publike administrative, organizimit funksional të institucioneve të administratës shtetërore dhe qeverisjes...'

Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Ministria përkatëse e Punëve të Brendshme në kuadër të fushëveprimtarisë së saj dhe kompetencave të parapara me ligj dhe akte tjera nënligjore, koordinon, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet agjensioneve, departamenteve, divizioneve, zyrave përkatëse që janë nën mandatin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit/organogramit dhe mekanizmeve që janë nën mandatin dhe përgjegjësinë e kësaj Ministrie kliko në këtë faqe interneti¹²:

<https://mpb.rks-gov.net/>

¹¹ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

¹² Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

Përveç mandatit dhe përgjegjësi, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Ministria përkatëse e Punëve të Brendshme koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje dhe të gjitha format e dhunës që cenojnë integritetin dhe jetën e tyre;
- Parandalimin dhe luftimin e delikuencës së të miturve;
- Luftimin e dukurive negative dhe krimit ndaj fëmijëve;
- Udhëheqin dhe ndihmojnë në luftimin e krimit të organizuar me theks të veçantë trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve;
- Rrisin kapacitetet e edukimit dhe trajnimit të profesionistëve për të identifikuar, hetuar, referuar dhe raportuar rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje nga çdo formë e dhunës;
- Kujdesen për regjistrimin e çdo fëmijë të porsalindur;
- Mbrojnë dhe sigurojnë që fëmijët e riatdhesuar, reintegrohen në familje dhe komunitet;
- Marrin masa për të mbrojtur fëmijët azil kërkues dhe ata pa shtetësi, sidomos ata që nuk kanë kujdesin prindëror;
- Sigurojnë që fëmijët të jenë të mbrojtur gjatë përdorimit të internetit dhe formave tjera të komunikimit;
- Specializimin e profesionistëve që punojnë dhe ofrojnë shërbime fëmijëve, veçanërisht zyrtarëve policorë dhe zyrtarëve të regjistrimit civil.

1.2.3. Fusha e edukimit dhe arsimit

Siç është përcaktuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria përkatëse e Arsimit dhe Shkencës ka këto përgjegjësi, por jo vetëm:

'Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e zhvillimit të edukimit në fëmijërinë e hershme, arsimin para universitar, në shkencë, teknologji dhe inovacion në Republikën e Kosovës...'

Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Ministria përkatëse e Arsimit dhe Shkencës në kuadër të fushëveprimtarisë së saj dhe kompetencave të parapara me ligj dhe akte tjera nënligjore, koordinon, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet që ndërliken me mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet agjensioneve, departamenteve, divizioneve, zyrave përkatëse që janë nën mandatin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë përkatëse për Arsim dhe Shkencë.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit/organogramit dhe mekanizmave që janë nën mandatin dhe përgjegjësinë e kësaj Ministrie kliko në këtë website¹³:

<https://masht.rks-gov.net/>

¹³ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

Përveç mandatit dhe përgjegjësive, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Ministria përkatëse për Arsim dhe Shkencë do të koordinojnë dhe bashkërendojnë veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Sigurojë qasje gjithëpërfshirëse, arsimim falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar në gjitha nivelet e arsimit para universitar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.
- Mbroj fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, neglizhenca, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.
- Rrisë kapacitetet e edukimit dhe trajnimit të studentëve dhe profesionistëve për të identifikuar, hetuar, referuar dhe raportuar rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje nga çdo formë e dhunës;
- Sigurojë që fëmijët janë të mbrojtur përmes programeve të edukimit, gjatë tërë kohës sa janë duke përdorur internetin apo format e tjera të komunikimit;
- Specializimin e profesionistëve që punojnë dhe ofrojnë shërbime fëmijëve, veçanërisht mësuesve, edukatorëve, asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta.

1.2.4. Fusha e shëndetësisë

Siç është përcaktuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria përkatëse e Shëndetësisë ka këto përgjegjësi, por jo vetëm:

Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e shëndetësisë duke i respektuar standardet e rëndësishme....'

Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të fushëveprimtarisë së saj dhe kompetencave të parapara me ligj dhe akte tjera nënligjore, koordinon, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet agjensioneve, departamenteve, divizioneve, zyrave përkatëse që janë nën mandatin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë përkatëse të Shëndetësisë.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit/organogramit dhe mekanizmave që janë nën mandatin dhe përgjegjësinë e kësaj Ministrie kliko në këtë faqe interneti¹⁴:

<https://msh.rks-gov.net/sq/>

Përveç mandatit dhe përgjegjësive, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Ministria përkatëse e Shëndetësisë koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës në institucionet shëndetësore dhe të gjitha format e dhunës që cenojnë integritetin dhe jetën e tyre.

¹⁴Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

- Garantojë të drejtën për kujdes shëndetësor falas, përfitimin nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit me standard të lartë.
- Merr masa për të ulur vdekshmërinë e foshnjeve dhe fëmijëve.
- Merr masa për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, duke ndërmarrë veprime për sigurinë e produkteve ushqimore, ujit të pastër dhe duke marrë parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror.
- Garantojë ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuar, me qëllim riaftësimin, integrimin e barabartë në shoqëri.
- Krijojë politikat për identifikimin e hershëm të problemeve shëndetësore të fëmijëve përmes vizitave në shtëpi dhe referimin e tyre në sektorët e tjerë përkatës për trajtim ndër sektorial.
- Hartojë politikat dhe programet për masat e duhura mbrojtëse dhe parandaluese, përfshirë edhe avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope.
- Rrisë kapacitetet e edukimit dhe trajnimit të studentëve dhe profesionistëve për të identifikuar, referuar dhe raportuar rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje nga çdo formë e dhunës.

1.2.5. Bashkërendimi i përgjegjësive dhe veprimeve nga ministritë përkatëse

Përveç mandatit dhe përgjegjësive të lartpërmendura, ministritë përkatëse janë të obliguara edhe që të bashkërendojnë këto veprime dhe përgjegjësi po jo vetëm:

- Draftojnë aktet nënligjore të cilat derivojnë nga LMF;
- Organizojnë trajnime bazike dhe të avancuara në lidhje me specializimin e profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës;
- Informojnë dhe raportojnë për zhvillimin dhe aplikimin e politikave, legjislacionit, standardeve, vështirësive financiare dhe vështirësive të tjera, si dhe për rezultatet e monitorimit dhe inspektimit që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës;
- Koordinimin e veprimeve nga mekanizmat e koordinatorëve nacional kundër dhunës në familje, koordinatorit nacional kundër trafikimit me qenie njerëzore, dhe koordinatorëve të tjerë që mbulojnë fushën e mbrojtjes së fëmijës;
- Hartojnë protokolle të përbashkëta për profesionistët e për mbrojtjen e fëmijës, për aspektet e menaxhimit të rastit;
- Koordinimin dhe ndihmën ndaj akademive dhe Instituteve përkatëse trajnuese në plotësimin e kurrikulave trajnuese për specializimin e mëtejshëm të profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës;
- Koordinimin e veprimeve me universitetet përkatëse publike dhe private për përfshirjen në kuadër të kurrikulave mësimore si dhe klinikave të mësimit praktik për studentët e të gjitha niveleve të studimeve;
- Caktimin e një zyrtari përkatës për të koordinuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
- Pjesëmarrjen në kuadër të Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës, gjithashtu informimin dhe raportimin për realizimin e të drejtave për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe avokimin që nëpërmjet Komitetit;
- Zyrtari apo njësia e caktuar, nga ministritë përkatëse duhet të bashkëpunojnë me Zyrën përkatëse për Qeverisje të Mirë, për të siguruar koordinimin, referimin dhe raportimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

1.3. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit

Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e LMF, është përgjegjëse që të:

1. Mbështet Komitetin për koordinimin e institucioneve dhe mekanizmeve që merren me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe monitoron dhe raporton mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit.
2. Ofron rekomandime për Komitetin dhe Qeverinë, në çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
3. Rekomandon dhe këshillon Kryeministrin dhe ministritë përkatëse në përputhje me parimet e këtij ligji dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës, sipas rrethanës mbi çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
4. Harton dhe sigurohet që politikat strategjike, programet dhe legjislacioni të jenë në pajtim me standardet e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të praktikave të qeverisjes së mirë.
5. Harton procedura standarde të veprimit për parandalim, identifikim, raportim, referim, hetim, trajtim dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, për të mbrojtur fëmijën.
6. Realizon projekte promovuese për të nxitur vetëdijesimin e popullatës mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijës, legjislacionin në fuqi, edukimin e fëmijës në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, si dhe promovon çdo formë të re të mbrojtjes së fëmijës.
7. Ngritja e sistemit të monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijës sipas kornizës së treguesve për të drejtat e fëmijës.
8. Bashkëpunon me trupa përkatëse qeveritare të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare, në çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
9. Përgatit raportin për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës pranë Komitetit për të drejtat e fëmijës në Gjenevë, i cili miratohet nga Komiteti. Raporti, pas miratimit nga Komiteti, bëhet publik.
10. Paraqet raport vjetor, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për zbatimin e këtij ligji, dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij.

Neni 12 par.1 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Përveç mandatit dhe përgjegjësi, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Funkcionon edhe si trupë qendrore në koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve qendrore dhe lokale;
- Shërben si Sekretariat i Komitetit Ndërministror, bën koordinimin, monitorimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të nevojshme për punën e Komitetit;
- Koordinon procesin e mbledhjes së të dhënave në emër të Komitetit Ndërministror. Të gjitha institucionet janë të obliguara për t'i ofruar këto të dhëna dhe informacionet e kërkuara;
- Themelon linjën telefonike falas për mbrojtjen e fëmijës;
- Realizon vlerësime, studime dhe programe ndërgjegjësimi për të ndikuar në reduktimin dhe zhdukjen e traditave dhe praktikave dëmtoese për fëmijët, si dhe promovimin e modeleve të shëndetshme dhe alternativave pozitive;

- Promovon eliminimin e diskriminimit dhe paragjyqimeve ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara;
- Përgatit programe të posaçme për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së fëmijës, me qëllim të zbatimit të LMF;
- Në bashkëpunim me institucionet e mandatuara nga ligji si dhe organizatat jo qeveritare, përgatitë programin për vetëdijesimin e publikut përmes fushatës vetëdijësuese, në lidhje me obligimet që dalin nga LMF;
- Ndihmon dhe këshillon Institutin Kosovar për Administratë Publike, Akademinë e Drejtësisë, Akademinë për Siguri Publike për të përgatitur programe të posaçme për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së fëmijës;
- Koordinon procesin e mbledhjes së të dhënave dhe përgatitjes së raportit konform të dhënave dhe informatave të pranuar nga autoritetet qendrore dhe lokale;
- Cakton zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Zyrtari i caktuar, do të bashkëpunojë dhe bashkërendojë më të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare, në nivel qendror dhe nivel lokal.

1.4. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës

Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës (Komiteti), është mekanizmi më i lartë në nivel politik për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës themelohet për të komunikuar, koordinuar dhe siguruar politikat, programet dhe proceset në lidhje me çështjen e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, ndërmjet Institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe për t'u ofruar atyre mundësi të barabartë për pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Komiteti poashtu, siguron këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të arsimit, drejtësisë, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe kulturës.

Komiteti ka këto përgjegjësi:

- 1.** Koordinon të gjitha institucionet dhe mekanizmat që merren me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- 2.** Debaton për politikat dhe legjislacionin në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
- 3.** Mbështet zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe të projekteve të tjera provuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
- 4.** Lehtëson dhe monitoron implementimin e politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- 5.** Definon prioritetet dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- 6.** Miraton raportin shtetëror për zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijës për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës në Gjenevë.
- 7.** Merr vendime dhe jep rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.
- 8.** Miraton raportin vjetor për të drejtat e fëmijës në Republikën e Kosovës.
- 9.** Mban lidhje dhe bashkëpunon ngushtë me organizatat që përfaqësojnë fëmijët dhe me faktorë të tjerë relevantë në fushën e të drejtave të fëmijës.
- 10.** Temelon grupe punuese të nevojshme për trajtimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Neni 16 par.4 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Komiteti udhëhiqet nga kryeministri dhe përfaqësohet nga ministritë në nivel ministrash. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues janë: Përfaqësuesi i Komisionit përkatës Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Avokati i Popullit, dy (2) përfaqësues nga këshillat e nxënësve, Kryesuesi i Zyrës së UNICEF në Kosovë dhe një (1) përfaqësues nga shoqëria civile. Komiteti takohet 2 herë në vit¹⁵.

1.5. Këshilli për të Drejtat e Fëmijës

Këshilli për të Drejtat e Fëmijës (Këshilli), është mekanizmi më i lartë në nivel teknik (profesional) për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Kosovës. Këshilli themelohet për të komunikuar, koordinuar dhe siguruar zbatimin e politikave, programeve dhe ligjeve në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, ndërmjet institucioneve të qeverisë së Kosovës, si dhe për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe për t'u ofruar atyre mundësi të barabartë për pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Këshilli për të Drejtat e Fëmijës ka këto përgjegjësi:

1. Definimin e prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe koordinimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Këshillon Komitetin për të gjitha aspektet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
3. Koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimit e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë dhe planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijës.
4. Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave zhvillimore dhe legjislacionit që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
5. Rekomandon institucionet kompetente për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Rekomandime përkatëse për masat parandaluese ndërsektorale të mbrojtjes së fëmijës.
7. Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve që synojnë ngritjen e pjesëmarrjes së fëmijës në procesin e vendimmarrjes për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
8. Realizimi i fushatave informuese dhe projekteve të tjera promovuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës.
9. Avancimi i bashkëpunimit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivelin qendror dhe lokal, me shoqërinë civile, agresionet relevante me qëllim të zbatimit të dokumenteve përkatëse (strategjiive nacionale dhe sektorale, programeve, planeve të veprimit etj.).

Neni 18 par.1 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Këshilli përbëhet prej 21 anëtarëve të rregullt, 2 anëtarë janë këshilltarë të jashtëm, ndërsa 5 anëtarë të tjerë janë në cilësinë e vëzhguesve¹⁶. Përbërja e Këshillit reflekton mandatin dhe rolin të cilin ja ka dhënë LMF, duke siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në nivel profesionistësh nga të gjitha institucionet kryesore që kanë mandat mbrojtjen e fëmijës.

ME RËNDËSI:

Përderisa Komiteti dhe Këshilli janë mekanizma të themeluar në nivel qendror, është më rëndësi të kuptohet që:

- Komiteti është mekanizëm **POLITIK dhe VENDIMMARRËS, ndërsa**
- Këshilli është mekanizëm **TEKNIK/PROFESIONAL dhe KËSHILLDHËNËS.**

¹⁵ Neni 17, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084).

¹⁶ Neni 19, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084).

KAPITULLI 2

STRUKTURA DHE MEKANIZMAT INSTITUCIONALË NË NIVEL LOKAL

Struktura dhe mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës në nivel lokal janë:

- Komuna;
- Departamenti përkatës sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës;
- Qendra për Punë Sociale;
- Ekipi për të Drejtat e Fëmijës;
- Tryezat Multidisplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit.

2.1. Komuna

Komuna si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, në kuadër të obligimeve që ka për zbatimin e LMF ka këto role dhe përgjegjësi:

1. *Secila komunë është përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe rintegruese për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara nga Qeveria apo ministritë përkatëse.*
2. *Komunat duhet të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të tyre.*
3. *Komunat përgatisin plane vjetore dhe financim përkatës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.*
4. *Komunat janë të obliguara përmes drejtorive përkatëse, të caktojnë të paktën një zyrtar për mbrojtjen e fëmijës, i cili është i obliguar të bashkëpunojë, të shkëmbejë informata dhe të dhëna me Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë.*
5. *Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore, komunat mund të konsultohen me njësinë përkatëse për qeverisje të mirë dhe ministritë përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera relevante, dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.*
6. *Çdo komunë duhet të ketë së paku tri (3) familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale.*
7. *Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të mbrojtjes së fëmijës, dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.*

8. Zhvillon programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës.
9. Për vetëdijesimin e komunitetit dhe arritjen e rezultateve konkrete dhe të sigurta për fëmijët të cilët nuk kanë qasje në shërbimet ekzistuese, komunat të organizojnë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës, duke koordinuar dhe harmonizon veprimet përmes shërbimeve të integruara të sektorëve të edukimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe organizatave të tjera qeveritare, joqeveritare dhe komunitetit.

Neni 14 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Përveç mandatit dhe përgjegjësi, siç janë përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet nënligjore, komuna koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Themelon një Qendër për Punë Sociale si institucion publik që do të ketë një ose më shumë degë dhe kuadër profesional të licencuar me kualifikime përkatëse;
- Përmes Qendrës për Punë Sociale mirëmban bazën e të dhënave të shërbimeve sociale dhe familjare për evidentimin e përfituesve të shërbimeve sociale si dhe siguron të dhëna statistikore sipas rekomandimeve të Ministrisë përkatëse për Mirëqenie Sociale;
- Përmes Qendrës për Punë Sociale kryen shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre si dhe duke siguruar mbështetje financiare apo ndihmë tjetër për OJQ të cilat plotësojnë shërbimet dhe aktivitetet e QPS-së për kategori dhe shërbime të caktuara;
- Kontraktin ofrimin e shërbimeve sociale, në ato fusha ku nuk mund të mbulojë shërbimet, apo aty ku kërkojnë shërbime të specializuara;
- Siguron që QPS në territorin e vet të ketë resurse sipas standardeve të specifikuar nga ministria, përfshirë numrin dhe (llojin) lëminë e kuadrit profesional që duhet punësuar;
- Përmes drejtoratit përkatës paraqet raport vjetor për aktivitetet që lidhen me shërbime sociale dhe familjare si dhe raporte të veçanta në raste specifike me rrezikshmëri apo interes të lartë me kërkesë të ministrive përkatëse;
- Në kuadër të drejtorateve përkatëse, cakton zyrtarin përgjegjës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Zyrtari apo njësia e caktuar, do të bashkëpunojnë me Zyrën përkatëse për Qeverisje të Mirë, për të siguruar koordinimin, referimin dhe raportimin e zbatimit të LMF;
- Funkcionalizon dhe ndihmon mekanizmat tjerë në Komunë siç janë: Tryeza Multidisplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit dhe Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.

2.2. Drejtoritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës

Në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, në kuadër të drejtorive të themeluara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale apo rregulloreve Komunale, drejtoritë si më poshtë, por jo vetëm, kanë përgjegjësi për zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e LMF:

- Drejtoria përkatëse për Shëndetësi;
- Drejtoria përkatëse për Arsim;
- Drejtoria përkatëse për Mirëqenie Sociale;
- Drejtoria përkatëse për Rini, Kulturë dhe Sport¹⁷.

Drejtoritë në kuadër të kompetencave vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara, ndërmarrin veprime për lehtësimin e zbatimit të LMF.

Drejtoritë përkatëse, kanë përgjegjësi për hartimin e politikave, udhëzuesve, rregulloreve të ndryshme, avokimin për planifikim dhe ndarje buxhetore adekuate, rekrutimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit profesional. Drejtoritë përkatëse koordinojnë të gjitha veprimet në nivel lokal me Kryetarin e Komunës, Qendrën për Punë Sociale, Tryezat për Menaxhimin e Rastit, Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Në çdo moment, varësisht nga nevoja dhe kërkesa, drejtoritë përkatëse duhet të koordinojnë veprimet edhe me strukturat e nivelit qendror, me qëllim realizimin e mandatit të mbrojtjes së fëmijës, që derivon nga LMF.

Drejtoritë përkatëse për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të komunës, obligohen që të sigurojnë buxhet për një fond të veçantë për të trajtuar emergjencat e rasteve të fëmijës në nevojë.

Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Inspektorati i Arsimit marrin masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raportojnë organeve të hetuesisë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi.

Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk vijojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mos regjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës në kuadër të Drejtorisë përkatëse për Arsim në komunë ndërmerr masa të menjëhershme për regjistrimin e fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

2.3. Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale në kuadër të komunës, për zbatimin e këtij ligji, është përgjegjëse që të:

- 1.** *Koordinojë dhe organizojë sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës.*
- 2.** *Zbatojë politikat nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.*
- 3.** *Shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen te shërbimet apo institucionet e tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.*
- 4.** *Çdo Qendër për Punë Sociale duhet të përcaktojë së paku një (1) zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës. Ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.*

Neni 15 par.1, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

¹⁷ Emërtimi i tillë drejtorateve është marrë duke u bazuar në emërtimin e tillë të drejtorateve nëpër shumicën e komunave të Kosovës. Gjithsesi në Komuna të caktuara mund të ketë emërtime tjera apo renditje të ndryshme në bazë të rolit dhe përgjegjësi që mbulojnë.

Përveç mandatit dhe përgjegjësi, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, QPS koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- QPS, formon Organin e Kujdestarisë¹⁸ dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç është përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe ligjet e tjera specifike për kategori dhe lloje të shërbimeve sociale dhe familjare në Republikën e Kosovës;
- QPS është përgjegjëse të bëjë vlerësime profesionale për secilin fëmijë, familje apo grup që jeton ose gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë ose në ndonjë mënyrë tjetër identifikohet dhe vlerësohet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare;
- Për çdo rast të identifikuar dhe referuar, QPS cakton menaxherin e rastit;
- Menaxheri i Rastit është zyrtar profesional në kuadër të QPS-së, i cili udhëheq procesin e menaxhimit të rastit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- QPS ofron shërbime sociale dhe familjare për fëmijët në nevojë, si dhe bën referime për shërbimet e mëtutjeshme të specializuara;
- QPS, udhëheqë me tryezat për menaxhimin e rastit;
- Përgjatë 24 orësh gjatë tërë javës, QPS duhet të jetë në dispozicion të fëmijëve, familjeve dhe çdo individi për të pranuar dhe trajtuar raste.

2.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës

Ekipi për të Drejtat e Fëmijës (Ekipi) themelohet bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutet e Komunave, në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, në nivel të vendimmarrjes politike dhe ka këto përgjegjësi:

1. *Definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinojë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e tyre.*
2. *Koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji.*
3. *Kujdeset për zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të nxjerra nga strukturat e para para sipas këtij ligji për mbrojtjen e fëmijës.*
4. *Verëson dhe siguron përputhshmërinë e politikave, akteve juridike dhe masave të tjera të ndërmarrë nga komuna me legjislacionin, politikën, strategjinë për të drejtat e fëmijës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.*
5. *Zhvillimi i programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët.*
6. *Rekomandon kryetarin e komunës për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi.*

Neni 20 par.2, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Përbërja e ekipit rregullohet me akt nënligjor. Ajo, reflekton mandatin dhe rolin të cilin ja ka dhënë LMF, duke siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në nivel të vendimmarrjes politike nga të gjitha institucionet kryesore që kanë mandat mbrojtjen e fëmijës në nivel lokal.

¹⁸ Nënkupton organin përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.

Përveç mandatit dhe përgjegjësi, siç janë përcaktuar në ligje dhe akte nënligjore, ekipi koordinon dhe bashkërendon veprimet në kuptim të zbatimit të obligimeve siç janë përcaktuar në LMF dhe kontributit ndaj politikave komunale, por duke mos u kufizuar vetëm në këto fusha:

- Zhvillimin lokal ekonomik, që ndërlidhet me fuqizimin dhe aftësimin e fëmijëve në profesione të caktuara, dhe punësimin konform moshës dhe mundësi;
- Planifikimin urban dhe rural, sipas parimit të qytetit mik për fëmijë;
- Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, duke i kushtuar vëmendje dhe përcaktimin e kriterëve strikte për akses dhe eliminimin e barrierave për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Mbrojtjen e mjedisit lokal, duke u kujdesur për eliminimin e faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ambientit dhe rritjen e hapësirave të gjelbra ku jetojnë dhe frekuentojnë fëmijët;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale, me qëllim që fëmija të rritet me shërbime cilësore që ndikojnë në rritjen e kualiteti të jetës së tyre;
- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e arsimtarëve dhe edukatorëve në arsim, duke siguruar që çdo fëmijë të jetë i përfshirë në edukim dhe arsim, si dhe ngritjen e kualitetit të edukimit dhe arsimit për çdo fëmijë;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks te veçantë të drejtat e fëmijëve si të drejta të pazëvendësueshme, të pandashme dhe gjithëpërfshirëse;
- Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor, duke i dhënë mbështetje të veçantë programit të vizitave në shtëpi, si dhe kualitetit të shëndetit për çdo fëmijë;
- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin ndaj fëmijës, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale, duke i dhënë prioritet gjithnjë interesit më të mirë të fëmijës me qëllim që fëmija të jetë në qendër të vëmendjes për nevojat e tij/saj për mbrojtje dhe shërbime adekuate sociale, ndërsektoriale dhe të integruara me shërbimet e tjera;
- Shëndetësinë publike, me theks të veçantë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të fëmijës nga të gjitha format që cenojnë apo rrezikojnë jetën dhe shëndetin, duke forcuar shërbimet parandaluese dhe edukimin e prindërve dhe shoqërisë;
- Regjistrimin civil, duke siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet i paregjistruar;
- Distribucionin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve), duke i dhënë përparësi pagesave ndaj fëmijëve që janë pa kujdes prindëror, apo në ndonjë prej formave të kujdesit alternativ, si dhe gjetjes së mundësi shtesë për planifikimin e pagesave shtese stimuluese që ndikojnë në edukimin dhe shëndetin e fëmijës.

2.5. Tryezat Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit

Tryezat Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rasteve themelohen në komunitat e Republikës së Kosovës, në nivel profesionistësh.

Tryeza Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rasteve ka këto përgjegjësi:

- 1.** Trajton të gjitha rastet e fëmijës që ka nevojë për mbrojtje, ku shkalla e rrezikut është e nivelit të mesëm apo të lartë.
- 2.** Trajton rastet të cilët janë në rrezik të mesëm apo të lartë nga të gjitha format e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i ndonjë një veprimtarie kriminale, si dhe fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer veprë penale, si dhe fëmijën në konflikt me ligjin.
- 3.** Përcjellë dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast. Vlerësimi përfshin gjithashtu cilësitë pozitive dhe potencialet e fëmijës dhe familjes dhe burimet në dispozicion.
- 4.** Përcakton dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës përfshirë edhe përcaktimin e roleve dhe përgjegjësitë në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
- 5.** Koordinon dhe zbaton shërbime për mbrojtje, rehabilitim dhe integrim/re-integrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrahë familjet e tyre ose kujdestarin.
- 6.** Rishikon planin e individualizuar për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, përveç nëse specifikohet dhe arrihet pajtimi ndryshe në TMR e parë.
- 7.** Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Ekipi për të Drejtat e Fëmijës dhe në rastet që kërkojnë vëmendjen e nivelit qendror edhe tek Këshilli për të Drejtat e Fëmijës si dhe Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Themelimi, përbërja, funksionalizimi dhe aspektet e tjera operacionale që ndërlidhen me takimet, menaxhimin rregullohet sipas Udhëzimit Administrativ për TMR.

TMR, në kuadër të mandatit dhe fushëveprimit të saj, i trajton rastet e fëmijëve:

- të abuzuar;
- keqtrajtuar; dhe
- të lënë pas dore.

Kriter kryesor për trajtim janë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga kategoritë e lartë cekura të cilat kanë nivel të rrezikshmërisë së mesme dhe të lartë.

ME RËNDËSI:

Përderisa Ekipi dhe TMR janë mekanizma të themeluar në nivel lokal, është më rëndësi të kuptohet që:

- Ekipi është mekanizëm **POLITIK dhe VENDIMARRËS**, ndërsa
 - TMR është mekanizëm **TEKNIK/PROFESIONAL dhe KËSHILLDHËNËS**.
-

KAPITULLI 3

MEKANIZMAT E NDIHMËS DHE KOMUNIKIMIT ME FËMIJËN

3.1. Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë

LMF në kuadër të mekanizmave për ndihmë dhe komunikim me fëmijën ka paraparë edhe themelimin e linjës së telefonit për fëmijë.

Qëllimet e ndërtimit të sistemit formal dhe linjës së telefonit janë:

- Identifikimi dhe koordinimi i mbrojtjes dhe kujdesit për çdo rast fëmijë të dyshuar ose të identifikuar si të abuzuar, neglizhuar, të lënë pas dore, keqtrajtuar apo trafikuar;
- Ofrimi i ndihmës së fëmijëve që kanë nevojë të pyesin dhe këshillohen për të drejtat e tyre, si dhe për të raportuar rastet e dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe trafikimit.

Neni 22, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Linja e telefonit është një mekanizëm nëpërmjet të cilës fëmijës i ofrohet ndihmë:

- Linjë telefonike në 7 ditë të javës (24 orë);
- Të gjitha shërbimet janë falas;
- Në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Pa asnjë dallim të moshës apo prejardhjes;
- Trajtim dhe ndërhyrje e menjëhershme për fëmijët dhe të rinjtë në rrezik;
- Mbështetje emocionale për fëmijët dhe adoleshentët në gjendje krize;
- Ofrimi i këshillimit profesional nëpërmjet telefonit për tematikat që shqetësojnë fëmijët dhe të rinjtë;
- Në referimin e rastit tek autoritetet;
- Dhënien e këshillave dhe udhëzimeve të nevojshme për trajtim të mëtejshëm;
- Raportimin e rasteve tek autoritetet e sigurisë dhe drejtësisë, e në raste të caktuara edhe për shërbime të specializuara;
- Informimi i fëmijëve, të rinjve, prindërve apo personave të tjerë që punojnë për fëmijët rreth shërbimeve që ofron linja.

Sistemi formal i mbrojtjes së fëmijës dhe linja e telefonit për përgjigje ndaj rasteve të fëmijëve në rrezik, drejtohet dhe zbatohet nga punonjës të specializuar të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe ofrohet falas. Fëmijës ky sistem dhe mekanizëm i ofron mbështetje, këshillim dhe shërbim sipas nevojave të shprehura në përputhje me interesin më të mirë të tyre¹⁹.

¹⁹Në kohën e përpilimit të këtij moduli, ky mekanizëm akoma nuk është themeluar dhe nuk ka qenë funksional.

3.2. Platforma 'know your rights - njih të drejtat e tua'

Platforma 'know your rights' është një platformë online që operon nën mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit ku fëmijës apo grupit të fëmijëve:

- i ofrohen udhëzime për të drejtat e tyre në fushën e arsimit, shëndetësisë, familjes, sistemit të drejtësisë dhe punës në komunitet;
- përcaktohet në mënyrë të detajuar harta e institucioneve të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e të drejtave, si dhe adresat e institucioneve ku fëmijët mund të dërgojnë ankesat për shkak të shkeljes së atyre të drejtave;
- të gjitha raportimet e dërguara nëpërmjet ankesave janë shumë konfidenciale dhe fëmijët janë të mbrojtur nga ndonjë hakmarrje apo shantazh;
- Të gjithë fëmijëve si dërgues të kërkesave dhe ankesave të ndryshme, i kthehet një përgjigje në afat sa ma të shkurtër të mundshëm, pa marrë parasysh a është dërguar ajo nëpërmjet postës, paltformës online apo drejtpërdrejtë në ndonjërin prej zyrave të IAP.

Për të kuptuar më tepër kliko në këtë faqe interneti²⁰:

<https://oik-rks.org/>

Në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit ekziston edhe linja e telefonit falas ku mund të raportoni ndonjë shkelje apo të paraqitni ndonjë rast.

0800 15555

3.3. Roli i personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

LMF, tek pjesa ku janë rregulluar dhe përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e mekanizmave institucionalë, ka paraparë dhe përcaktuar edhe rolin dhe përgjegjësinë e personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

1. *Personat fizikë dhe juridikë, mund të ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.*
2. *Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe zyrtarët e punësuar në institucionet që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës, duhet të licencohen sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.*
3. *Komuna mund të lidhë kontrata vetëm me personat fizikë dhe juridikë të licencuar apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara, për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës, të cilat shërbime nuk mund të ofrohen nga komuna brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime të mbrojtjes së fëmijës në territorin e saj, përmes procedurave të komisionit dhe kontraktimit sipas legjislacionit në fuqi.*
4. *Ministritë përkatëse mund të lidhin kontratë me personat fizikë dhe juridikë, mund të japin fonde dhe të ofrojnë çfarëdo ndihme tjetër materiale, duke përfshirë lokalet, personat fizikë dhe juridikë të licencuar, apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës në nivel të Kosovës përmes procedurave të komisionit dhe kontraktimit të cilat shërbime nuk mund të ofrohen nga ministria përkatëse.*

Neni 23 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

²⁰ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

Mundësia që i ka dhënë ligji personave fizikë dhe juridikë për të ofruar shërbime për mbrojtjen e fëmijës, është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse ofrimi i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës nuk duhet të jetë obligim dhe përgjegjësi vetëm e institucioneve publike, ajo duhet të ofrohet edhe nga personat fizikë dhe juridikë. Andaj kjo normë së bashku me dispozitat e ligjeve të tjera është një mundësi e mirë që shërbimet, të jenë shumë burimore, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevojën e fëmijës për mbrojtje.

Kjo mundëson edhe formimin e një zinxhiri të ofruesve (institucionalë dhe jo-institucionalë) për të marrë përsipër kujdesin bazuar në nevoja individuale dhe për të ofruar zgjidhje në një mënyrë të integruar dhe të koordinuar. Rrjetëzimi, bashkërendimi dhe integrimi ndërmjet tyre shihet si çelësi i ngritjes së cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së shërbimeve mbrojtëse për fëmijën, ofruesit e shërbimeve të tilla duhet të licencohen për lloje specifike të shërbimeve. Këto licenca lëshohen prej autoriteteve bazuar në një vlerësim të aftësive të ofruesit për t'i plotësuar të gjitha kushtet e rekomanduara nga standardet e shërbimeve për mbrojtjen fëmijës.

Pjesa e fundit e këtij neni, ofron mundësinë e krijimit të partneriteteve përmes lidhjes së marrëveshjeve dhe kontraktimi të shërbimeve (siç njihet out-source) të cilat mund ti ofrojnë personat fizikë dhe juridikë. Kontraktimi parasheh përveç mundësisë të transferimit të fondeve, po ashtu edhe shfrytëzimin e lokaleve, hapësirave të ndryshme dhe ndihmën materiale.

3.4. Mekanizmat ndërsektorialë dhe institucionet kushtetuese

Mekanizmat ndërsektorialë dhe institucionet kushtetuese, edhe pse nuk janë listuar në kapitullin i cili rregullon institucionet në nivel qendror dhe lokal, ato luajnë një rol kyç dhe janë shumë të rëndësishme në ofrimin e mbrojtjes së fëmijës, respektivisht zbatimin e dispozitave të LMF.

Mekanizmat ndërsektorialë dhe institucionet kushtetuese rolin dhe përgjegjësinë kryesore në mbrojtjen e fëmijës e realizojnë përmes këtyre formave por jo vetëm:

- Identifikimin dhe hetimin e rasteve;
- Ndjekjen e kryesve të veprave penale;
- Vendimin gjyqësor për mbrojtjen e fëmijës;
- Ofrimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit ligjor, procedural dhe gjyqësor;
- Mbrojtjen e interesave dhe përfaqësimin e fëmijës falas;
- Mbrojtjen e fëmijëve viktimë të dhunës;
- Koordinimin e politikave dhe veprimeve në zbatimin e programeve për mbrojtjen e fëmijës;
- Avokimin dhe lobimin për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës;
- Ofrimin e shërbimeve mbrojtëse për fëmijë.

Institucioni - Organizata

Gjykata

Prokuroria

Policia

Oda e Avokatëve

Zyra për Ndihmë Juridike Falas

Zyra për Mbrojtje të Viktimave

Koordinatori nacional kundër dhunës në familje

Koordinatori nacional kundër trafikimit me qenie njerëzore

Organizatave vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë

II. ANEKS

A) RAST STUDIMI

RASTI A

Kohëzgjatja e tepërt e e proceseve të kujdestarisë dhe dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve përbën shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE M. K. KROACISË

(Kërkesa nr. 10161/13)

3 Shtator 2015

1. Faktet kryesore

Kërkueset, znj. M. dhe M., respektivisht nëna dhe vajza e saj e mitur, ishin shtetase kroate, të cilat kanë lindur në vitin 1976 dhe 2001, dhe kanë jetuar në Zadar, Kroaci.

Znj. M. u martua me z. I.M. më 23 Qershor 2001, dhe vajza e tyre lindi më 4 Shtator të vitit 2001. Marrëdhëniet e çiftit filluan të përkeqësohen dhe ata nisën procesin për divorc. Më 24 gusht 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Zadarit dha vendimin e divorcit. Sipas vendimit të gjykatës vendase, vajza u la në kujdestari të babait dhe nënës ju dha e drejta për të mbajtur kontakte me vajzën si dhe ju caktua pagesa për mjetet e jetesës që duhej të jepte për të.

Sipas deklaratës së dhënë në polici nga M., më 1 Shkurt të vitit 2011, kishte ndodhur një ngjarje e rëndë e abuzimit në familje: babai i saj e goditi në fytyrë, e kapi për fyti dhe abuzoi psikologjikisht me të. Okulisti e diagnostikoi vajzën me mavijosje dhe dëmtim të indit të syrit të majtë duke treguar se lëndimi ishte shkaktuar nga një goditje me grusht. M. kishte raportuar edhe raste të tjera të dhunës fizike dhe psikologjike nga babai i saj të cilat kishin ndodhur tre vitet e fundit duke pranuar se ajo kishte frikë nga ai, duke qenë se ishte një njeri i dhunshëm.

Si rrjedhojë e situatës problematike në familje, një sërë seancash të ndërlidhura me njëra tjetrën nisën përpara gjykatave penale të Kroacisë (për të vendosur mbi pretendimin lidhur me abuzimin e fëmijës), gjykatat civile (për të vendosur mbi kujdestarinë dhe divorcin) dhe autoritetet e mirëqenies sociale.

Pas incidentit të 1 Shkurtit, më 30 Mars 2011, z. I.M., u akuzua nga Prokurori i Shtetit për kryerjen e veprës penale të lëndimeve trupore. Në Tetor 2014, procesi nuk kishte nisur ende pasi gjykata në Zadar priste të merrte një pajisje video-link përmes së cilës M.do të regjistrohej gjatë seancës dëgjimore.

Më 27 Prill 2011, znj. M.,depozitoi një kallëzim penal ndaj z. I.M., për abuzim të vajzës së tij, duke cituar inciden-

tin e 1 Shkurtit 2001, si dhe pretendimet nga vajza e tyre se ky nuk kishte qenë rasti i vetëm. Kallëzimi penal u hodh poshtë në Janar 2012, pasi nuk ishin gjetur elemente të mjaftueshme për të vërtetuar abuzimin.

Paralelisht, më 30 Mars 2011, znj. M. paraqiti një kërkesë për padi civile për të anuluar urdhërin e kujdestarisë të 24 Gushtit 2007, duke kërkuar që të marrë kujdestarinë e përkohshme të vajzës së saj. Megjithatë, kërkesa për kujdestarinë e përkohshme u refuzua dy muaj më vonë për shkak të mungesës së dëshmisë se abuzimi i pretenduar kishte ndodhur vërtetë. Proceset lidhur me kujdestarinë ishin ende në pritje në shkallën e parë të gjyqimit në kohën që çështja kishte shkuar për gjykim në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në procesin para autoriteteve të mirëqenies sociale të përfshira në rastin e M., me vendim të datës 7 Nëntor 2006, u urdhërua një masë mbrojtëse e fëmijëve për mbikëqyrjen e ushtrimit të autoritetit prindëror me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes. Masa zgjati deri në Gusht të 2008. E njëjta masë u vendos më pas nga Shtatori 2011 deri në Mars 2014 pasi situata familjare nuk kishte pasur ndonjë përmirësim të dukshëm të rastit në fjalë.

Gjatë të gjitha proceseve të mësipërme, M. ishte ekzaminuar nga disa psikiatër dhe psikologë, të cilët kishin konstatuar se fëmija ishte traumatizuar emocionalisht nga ndarja e prindërve dhe nga lidhja e tyre konfliktuale dhe se ajo vazhdimisht kishte shprehur dëshirën për të jetuar me nënën e saj. Megjithatë, nuk ishte vërejtur asnjë rrezik nëse fëmija do të vazhdonte të jetonte me babain e saj, pasi deklaratat e M. se ishte abuzuar nga babai i saj nuk ishin mjaftueshëm bindëse për të justifikuar heqjen e kujdestarisë nga i ati dhe largimin e saj të menjëhershëm.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkueset pretendonin se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës pasi autoritetet nuk ndoqën penalisht z. I.M., për veprën penale të abuzimit të fëmijëve të kryer kundër vajzës së tij, e as për mbrojtjen e saj ndaj veprimeve të tjera të dhunshme, duke vijuar me qëndrimin e saj në shtëpinë e tij dhe duke mos i hequr kujdestarinë, përbënin shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Neni 3 dhe 8

Duke pasur parasysh se M. kishte paraqitur një dëshmi për abuzim, ishte e mitur dhe viktimë e dhunës në familje, Gjykata vlerësoi se rasti në fjalë përbënte detyrim pozitiv për shtetin sipas nenit 3 të Konventës për të hetuar rastet e pretenduara të abuzimit dhe për mbrojtjen e saj nga abuzimi që mund të ndodhte në të ardhmen. Gjatë shqyrtimit të shkeljes së pretenduar sipas nenit 8, Gjykata i shqyrtoi kërkesat e M. duke i marrë në shqyrtim së bashku me nenin 3.

Autoritetet kroate kishin nisur hetime penale vetëm në lidhje me incidentin e 1 Shkurtit të 2011, duke mos marrë parasysh të gjitha rastet e mëparshme të abuzimeve të pretenduara që M. ishte dashur të duronte, duke mos e akuzuar z. I.M. lidhur me veprën penale të abuzimit me të mitur dhe në këtë mënyrë duke mbuluar të gjitha rastet e keqtrajtimit të vazhdueshme që ishin bërë më parë. Si rrjedhojë, autoritetet kishin dështuar ta marrin në shqyrtim çështjen në tërësi. Për më tepër, kohëzgjatja e proceseve penale ishte tepër e gjatë për të pasur një hetim efektiv, e cila përbën shkelje të kërkesës për marrjen e masave të menjëhershme dhe brenda një afati të arsyeshëm, parë në kontekstin e nenit 3. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të këtij neni.

Për sa i përket pretendimeve mbi shkeljen e detyrimeve të autoriteteve për të parandaluar keqtrajtimin e mundshëm në të ardhmen duke marrë të gjitha masat e nevojshme të arsyeshme, Gjykata vërjeti se autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm dhe të nevojshëm për të vlerësuar dhe matur rrezikun e keqtrajtimit të mundshëm, si dhe parandalimin e tyre, duke marrë parasysh një sërë opinionesh kontradiktore të lëshuara nga autoritete të ndryshme sociale dhe duke shqyrtuar me kujdes të gjitha materialet relevante. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se në këtë pikë nuk kishte pasur shkelje të nenit 3.

Neni 8

Kërkueset u ankuan se autoritetet vendase nuk kishin marrë parasysh dëshirën e M. për të jetuar me nënën e saj dhe se ajo nuk ishte dëgjuar gjatë proceseve për kujdestarinë, të cilat kishin qenë në pritje për më shumë se katër vjet. Pas tre vjet e gjysmë, M., kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese, të cilën ajo e kishte përshkruar si një reagim ndaj frustrimit që kishte ardhur si rezultat i faktit që nuk i ishte lejuar të zgjidhte se me kë dëshironte të jetonte, i ishte mohuar liria e veprimit dhe në këtë mënyrë i ishte kufizuar liria e saj personale. Në bazë të këtyre rrethanave kërkueseve ju lindte e drejta të ngrinin pretendime për respektimin e jetës private dhe familjare në kontekstin e nenit 3 dhe, për rrjedhojë Gjykata konstatoi se për këtë kërkohej një shqyrtim.

Sipas Gjykatës, rasti i në fjalë bënte thirrje për kujdes më të madh nga gjykatat dhe autoritetet kombëtare për sa i përket një të miture të traumatizuar, e cila kishte pësuar një ankth të madh psikologjik që kishte kulmuar në sjellje që çojnë në lëndim të vetes. Megjithatë, gjykatat vendase nuk kishin kuptuar seriozitetin dhe urgjencën e situatës së M. Ajo që ishte më flagrante për Gjykatën ishte se nuk u mor asnjë hap për të përshpejtuar procedurat edhe pasi M. kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese.

Ekspertët mjeko-ligjorë të psikologjisë dhe psikiatrisë të përfshirë në rastin në fjalë kishin konstatuar se të dy prindërit ishin po aq të papërshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën e tyre, qëndrim ky i mbajtur dhe nga qendra lokale e mirëqenies sociale. Ata gjithashtu kishin konstatuar se M. për disa herë më radhë kishte shprehur dëshirën e madhe për të jetuar me nënën e saj. Siç parashihet në nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët kanë të drejtë të kenë pikëpamjet e tyre dhe të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje për çdo çështje që ka të bëjë me ta, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tyre, në çdo proces që ka të bëjë me ta. M., ishte nëntë vjeç e gjysmë në kohën e fillimit të proceseve dhe trembëdhjetë e gjysmë në kohën e vendimit të Gjykatës. Prandaj, do të kishte qenë e vështirë të argumentohej se, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e saj, ajo nuk kishte qenë e aftë të kishte pikëpamjet e veta dhe t'i shprehte ato lirisht.

Gjykata konstatoi se mos respektimi i dëshirave të M., lidhur me çështjen se me cilin prind do të jetonte përbënte shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës private dhe familjare në kundërshtim me nenin 8 të Konventës. Konkluzionet në lidhje me procedurat e tejzgjatura mbi kujdestarinë gjenin të njëjtin zbatim edhe në rastin e znj. M., në lidhje me të drejtën e saj për respektimin e jetës private dhe familjare.

Neni 41

Gjykata konkludoi se Kroacia duhej t'i paguante fëmijës 19,500 euro dhe mamasë së saj 2,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial, dhe 3,600 euro të dyjave bashkë për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

RASTI B

Dështimi i autoriteteve shtetërore për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga neglizhenca duke shkelur kështu nenin 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Z. DHE TË TJERËT K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 29392/95)

10 Maj 2001

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin të gjithë vëllezër dhe motra të lindur ndërmjet viteve 1982 - 1988. Në Tetor 1987 familja e kërkuesve iu referua shërbimeve sociale nga *kujdestari shëndetësor* për shkak të shqetësimeve rreth fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe raportet që paraqisnin se njëri prej tyre Z. kishte vjedhur ushqim. Pas këtij referimi shërbimet sociale monitoruan familjen dhe ofruan forma të ndryshme të mbështetjes për prindërit për katër vite e gjysmë. Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe problemet vazhduan. Në Tetor të vitit 1989, kur ishin duke hetuar një vjedhje, policia evidentoi se dhomat e fëmijëve ishin në një gjendje shumë të keqe sanitare, duke përfshirë dyshekët e ndotur me urinë. Në Mars 1990, u raportua se Z. dhe A. po vidhnin ushqim nga kazanët e mbeturinave në shkollë. Më pas në Shtator 1990, u raportua se dy fëmijët e tjerë A. dhe B. kishin plagë në fytyrat e tyre. Në disa raste, u raportua se fëmijët ishin mbyllur në dhomat e tyre dhe gjatë kësaj kohe copëtonin jashtëqitje në dritare. Më 10 Qershor 1992, fëmijët u vendosën në një familje kujdestare emergjente pas kërkesës së nënës së tyre, e cila kishte deklaruar se nëse ata nuk do të largoheshin nga kujdesi i saj, ajo do t'i qëllonte. Psikologjia që ekzaminoi fëmijët zbuloi se tre të rriturit tregonin shenja të shqetësimeve të rënda psikologjike dhe theksoi se ky ishte rasti më i keq i neglizhimit dhe abuzimit emocional që kishte parë.

Avokati i caktuar kryesisht për të vepruar për llogari të kërkuesve, nisi procedimin kundër autoriteteve lokale duke pretenduar shpërbllimin e dëmit të ardhur si pasojë e neglizhencës së këtyre autoriteteve ndaj marrjes së masave për të garantuar mirëqenien dhe mbrojtjen efektive të fëmijëve. Ky proces përfundoi në Dhomën e Lordëve dhe pretendimet e kërkuesve u rrëzuan. Në vendimin e dhënë më 29 qershor 1995, u vërejt se konsideratat e politikave publike ishin të tilla që autoritetet lokale nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për rastet e neglizhencës në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre statutores, që mbrojnë mirëqenien e fëmijëve.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkuesit pretenduan se autoritetet lokale nuk kishin marrë masat e përshtatshme për t'i mbrojtur ata nga neglizhimi dhe abuzimi i rëndë, ndaj të cilit kishin qenë subjekt për shkak të keqtrajtimit nga prindërit e tyre, si edhe u ankuan për faktin se u ishte shkelur e drejta për qasje në gjykatë, ose qasje në një mjet ligjor efektiv për ta rivendosur për të rivendosur drejtësinë.

Neni 3

Neni 3 i Konventës garanton një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, duke ndaluar torturën ose trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës. Shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që çdo individ brenda juridiksionit të tyre nuk i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë edhe keqtrajtimin nga individë privatë. Këto masa duhet të sigurojnë mbrojtje efektive veçanërisht të fëmijëve dhe personave të tjerë të cenueshëm, duke përfshirë këtu hapa të arsyeshëm për të parandaluar një keqtrajtim për të cilin autoritetet kishin, ose duhet të kishin dijeni.

Gjykata vërejtë se nuk kishte asnjë kundërshtim se neglizhimi dhe abuzimi, që kishin pësuar të katër fëmijët kishte arritur pragun e trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Qeveria britanike nuk e kundërshtoi faktin, që shteti kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit të tij pozitiv sipas nenit 3 për t'u dhënë kërkuesve mbrojtje të përshtatshme nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Trajtimi i pësuar nga kërkuesit u soll në vëmendjen e autoritetit lokal, në Tetor 1987, që kishin obligim ligjor për të mbrojtur fëmijët dhe kishte një sërë kompetencash në dispozicion, duke përfshirë këtu largimin e tyre nga shtëpia. Megjithatë, fëmijët u morën në kujdestari emergjente vetëm pas insistimit të nënës së tyre më 30 Prill 1992.

Sipas raportit të psikiatrit gjatë periudhës së ndërhyrjes prej katër vitesh e gjysmë, kërkuesit iu ishin nënshtruar përvojave të tmerrshme. Gjithashtu, Bordi i Kompensimit të Dëmtimeve Penale kishte vërejtur se fëmijët kishin qenë subjekt i një neglizhimi të tmerrshëm gjatë një periudhe të gjatë dhe kishin pësuar lëndime fizike e psikologjike, që klasifikoheshin si vepra penale të dhunës. Gjykata vërejtë se ishte e ndërjegjeshme për vështirësinë e vendimeve me të cilat ballafaqohen shërbimet sociale, si dhe parimin e rëndësishëm të respektimit dhe ruajtjes së jetës familjare. Megjithatë, pa dyshim u konstatua dështimi i sistemit për të mbrojtur kërkuesit nga neglizhimi, abuzimi serioz dhe afatgjatë. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 3.

Neni 8

Pasi evidentoi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme, që ankimi në lidhje me nenin 8 të shqyrtohej më vete.

Neni 6

Gjykata vërejtë se prej fillimit të procesit në gjykatat vendase, kishte pasur një mosmarrëveshje serioze rreth ekzistencës të së drejtës së parashtruar nga kërkuesit sipas legjislacionit të brendshëm. Prandaj, neni 6 ishte i zbatueshëm për procesin e nisur nga kërkuesit, që pretendonin neglizhimin nga ana e autoriteteve lokale. Në lidhje me pajtueshmërinë me nenin 6, Gjykata vërejtë se rezultati i proceseve të brendshme ishte se kërkuesit dhe çdo fëmijë tjetër, që ankohej për shkelje të njëjta nuk mund të padisnin një autoritet lokal për neglizhencë dhe dëm shpërblim, megjithëse kjo situatë kishte qenë e parashikueshme, e rëndë dhe kishte shkaktuar vuajtje. Megjithatë, kjo e drejtë nuk derivonte nga asnjë klauzolë procedurale ose imunitet, që kufizonte të drejtën e kërkuesve për t'iu drejtuar gjykatës. Rrëzimi i pretendimit të kërkuesve rezultoi nga zbatimi i parimeve të së drejtës materiale nga gjykatat e brendshme. Për rrjedhojë, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë mbi përmbajtjen e duhur të së drejtës kombëtare. Megjithatë, kërkuesit ishin të saktë në pretendimet tyre se vakumi ligjor, që ata kishin identifikuar ishte ai që ngriti një çështje në bazë të Konventës. Gjykata vlerësoi se ky pretendim i takonte nenit 13 dhe jo nenit 6 (1), duke mos gjetur kështu asnjë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Neni 13

Gjatë shqyrtimit nëse kishte pasur shkelje të nenit 13, Gjykata vërejtë se kërkuesit pretenduan se autoritetet dështuan për të mbrojtur qytetarët nga veprimet e individëve të tjerë privatë. Duhet të ekzistonin mekanizma ligjorë në dispozicion të viktimave ose familjarëve të tyre për të vendosur përpara përgjegjësisë zyrtarët ose organet shtetërore, për mosveprim dhe shkeljen e të drejtave të individëve sipas Konventës. Për më tepër, në rastin e një shkeljeje të neneve 2 dhe 3, të cilat renditen si dispozitat më themelore të Konventës, kompensimi për dëmin jomaterial që rrjedh nga këto shkelje duhet në parim të ekzistojë si pjesë e gamës së rivendosjes të së drejtës.

Gjykata vlerësoi se kërkuesit nuk kishin pasur në dispozicion të tyre një mjet të përshtatshëm për të marrë një përcaktim të pretendimeve të tyre se autoritetet lokale nuk i kishte mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor dhe degra-

dues, ose nga mundësia e marrjes së një kompensimi të detyrueshëm për dëmin e pësuar. Rrjedhimisht, atyre nuk u është dhënë një mjet efektiv në lidhje me shkeljen e nenit 3 duke shkelur kështu nenin 13 të Konventës.

Neni 41

Në lidhje me dëmin material, Gjykata i caktoi kërkuesit Z. 8,000 GBP, kërkuesit A. 100,000 GBP, kërkuesit B. 80,000 GBP dhe kërkuesit C. 4,000 GBP. Gjithashtu, Gjykata i caktoi secilit kërkues 32,000 GBP në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe shpenzimet gjyqësore.

B) Agjenda

AGJENDA

Dita e dytë Modul II	
09:00 – 09:15	Objektivat kryesore dhe rezultatet e pritura
09:15 – 10:15	Mekanizmat institucionalë – Roli dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve
10:15 – 11:10	Mekanizmat dhe institucionet në nivel qendror Mandati, funksionet dhe përgjegjësitë
11:10 – 12:00	Mekanizmat dhe institucionet në nivel lokal Mandati, funksionet dhe përgjegjësitë
12:00 – 13:00	Dreka
13:00 – 14:00	Dallimi ndërmjet mekanizmave dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal
14:00 – 15:00	Mekanizmat e ndihmës dhe komunikimit me fëmijën
15:00 – 15:45	Raste studimi, punë në grupe
15:45 – 16:00	Reflektime dhe përmbyllje e ditës së dytë

MODULI III:

SISTEMI DHE MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

PËRMBAJTJA

I. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTAT E PRITURA	63
KAPITULLI 1. SISTEMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS DHE INTEGRIMI TIJ	64
1.1. Çka është sistemi për mbrojtjen e fëmijës	64
1.2. Parakushtet për ndërtimin e sistemit për mbrojtjen e fëmijës.....	65
1.3. Integrimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijës dhe parimet udhëheqëse	66
KAPITULLI 2. MASAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS	70
2.1. Parandalimi.....	70
2.2. Mbrojtja ligjore	71
2.3. Detyrimi ligjor për raportim.....	72
2.4. Ndarja e fëmijës nga familja	74
2.5. Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore.....	77
2.6. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës	79
2.7. Monitorimi i masave të mbrojtjes.....	80
2.8. Masat për aftësim prindëror	81
IV. ANEKS.....	83
A) Rast studimi	83
B) Agjenda	86

III. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivë kryesore e Modullit të Tretë (III) është ofrimi i informatave dhe njohurive mbi sistemin për mbrojtjen e fëmijës, në bazë të cilave parakushte ndërtohet sistemi, dhe mbi cilat parime udhëhiqet ky sistem, për të vazhduar me ofrimin e njohurive rreth masave dhe përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijës.

Në fund të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë çka është sistemi i mbrojtjes së fëmijës;
- Të njohin dhe familjarizohen me parakushtet për ndërtimin e sistemit;
- Të kuptojnë në bazë të cilave parime udhëhiqet sistemi;
- Të familjarizohen me masat dhe përgjegjësitë individuale, familjare, komunitetit dhe institucioneve;
- Të kuptojnë rrisitë që ka sjellë ligji siç janë shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës;
- Të rrisin aftësitë analitike përmes studimit të rasteve praktike, etj.

KAPITULLI 1

SISTEMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS DHE INTEGRIMI TIJ

1.1. Çka është sistemi për mbrojtjen e fëmijës

Të drejtat dhe garantimi i tyre nga kushtetuta, KDF dhe legjislacioni i aplikuar, nuk janë të mjaftueshme dhe nuk kanë kuptim pa mbrojtjen e tyre. Mbrojtja e këtyre të drejtave përfshin dhe krijon obligime për një numër të madh të autoriteteve, institucioneve, mekanizmave, familjen dhe komunitetin. Të gjithë këta në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, janë pjesë e sistemit për mbrojtjen e fëmijës.

Sipas kuptimit të përgjithshëm, sistemi për mbrojtjen e fëmijës (Sistemi) përbëhet nga këto komponente:

- ligjet dhe politikat;
- burimet njerëzore dhe financiare;
- qeverisja;
- monitorimi dhe mbledhja e të dhënave;
- shërbimet mbrojtëse dhe reaguese;
- menaxhimi i rastit.

Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë:

- fëmijët;
- familja;
- komuniteti;
- shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përjashtuar edhe ata në nivel ndërkombëtar.

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës:

nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar kundër dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijës.

Neni 3 par.1 pika 1.37 i LMF

Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komponentëve dhe akterëve brenda këtij sistemi.


Pavarësisht kuptimit dhe përmbajtjes, sistemi i mbrojtjes së fëmijës duhet t'i ketë këto elemente:

- **Elementet formale:** të cilat burojnë prej ligjeve, rregulloreve dhe politikave të cilat i udhëheqin institucionet dhe bartësit e përgjegjësive;
- **Elementet jo formale:** të cilat nuk kanë ndonjë funksion apo mandat mbrojtjeje që buron nga shteti apo qeveria. Përkundrazi, këto janë elemente të mishëruara nga vlerat, sjelljet, shprehjet, normat shoqërore dhe praktikat tradicionale në shoqëri. Këto elemente luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.

1.2. Parakushtet për ndërtimin e sistemit për mbrojtjen e fëmijës

Me qëllim ndërtimin dhe integrimin e një sistemi të mbrojtjes së fëmijës, autoritet publike dhe private, duke përfshirë shoqërinë civile, mediat dhe në përgjithësi bartësit e përgjegjësive, duhet të koordinojnë dhe bashkërendisin veprimet në mënyrë që të sigurojnë që një grup i parakushteve duhen plotësuar para së të synohet ndërtimi dhe integrimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijës.

Të gjitha këto parakushte janë të rëndësishme dhe duhen plotësuar në tërësi dhe në asnjë mënyrë apo rrethanë si të vetme. Çdo segment i kushteve të cilat duhet plotësuar është dhe duhet të jetë i ndërlidhur me njëri tjetrin. Sepse zbatimi i njërit nënkupton që duhet ekzistuar edhe tjetri, në mënyrë që të krijohet komplet sistemi. Mungesa e njërit, ka pasoja dhe ndikim në sistemin në tërësi dhe kjo pashmangshëm ndikon në ofrimin e mbrojtjes tek fëmijët. Andaj për të ndërtuar dhe integruar një sistem të mbrojtjes së fëmijës duhet të kemi këto parakushte por jo vetëm:



- **Korniza ligjore dhe politike** duhet të parashikojë mbrojtjen e fëmijëve, të jetë në harmoni dhe në përputhje të plotë me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës;
- **Strategjia për të drejtat e fëmijës dhe plani i veprimit** duhet të zbatohet konform kornizës ligjore. Strategjitë e tjera sektoriale apo që prekin interesat dhe mbrojtjen e fëmijës duhet në përpikëri të ndërlidhjen me strategjinë për të drejtat e fëmijës, por edhe të jenë në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës;

- Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal **duhet të kenë koordinim kuptimplotë** në të gjitha segmentet dhe nivelet, dhe nga të gjithë profesionistët e përfshirë. Koordinimi realizohet përmes ushtrimit të përgjegjësive nga të gjithë bartësit e përgjegjësive nga fusha e drejtësisë, mirëqenies sociale, shëndetësisë, edukimit, por jo vetëm, duke përfshirë shoqërinë civile, si dhe duke vendosur familjet dhe fëmijët në qendër të këtij procesi;
- **Fuqizimi i burimeve njerëzore** me theks të veçantë fuqizimi i profesionistëve që ofrojnë shërbime dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët. Sistemi i mbrojtjes së fëmijës ka nevojë për profesionistë adekuat dhe profesional. Të gjithë profesionistët duhet të jenë të trajnuar dhe specializuar për të ofruar shërbime sa më cilësore dhe të qëndrueshme;
- **Shërbimet parandaluese dhe reaguese** duhen krijuar dhe aty ku ekzistojnë duhen fuqizuar. Barra kryesore e ofrimit të këtyre shërbimeve bie mbi pushtetin lokal, komunitetin, familjet, dhe individët. Të gjitha këto shërbime duhet të jenë të qasshme, të shpejta dhe të qëndrueshme. Këtu hyjnë edhe menaxhimi i rastit, raportimi, referimi dhe format e tjera përcjellëse të programeve që ndërlidhen me përmirësimin, rehabilitimin dhe reintegrimin;
- **Sjelljet dhe praktikat** që cenojnë të drejtat e fëmijës, duhen ndryshuar nëpërmjet vetëdijesimit dhe aktiviteteve të cilat përfshijnë parandalimin e këtyre sjelljeve dhe praktikave të dëmshme. Ky vetëdijesim duhet të ketë shtrirje të gjerë dhe të përfshijë të gjitha segmentet e individëve, familjes, shoqërisë dhe shtetit;
- **Mobilizimi i burimeve financiare dhe alokimi** adekuat i tyre për mbrojtjen e fëmijës kërkon një ndërveprim të udhëhequr nga Ministria e Financave dhe ministrive të tjera të linjës për të jetësuar zbatimin e ligjit nëpërmjet buxhetimit të shërbimeve të nevojshme. Në këtë aspekt autoritetet qendrore dhe lokale duhet të koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet edhe me donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë me qëllim mbulimin e zbrazëtirave apo mbështetjen e ndonjë shërbimi të pa mbuluar nga ana e buxhetit shtetëror;
- **Sistemi për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave** duhet të zhvillohet nëpërmjet krijimit të një baze të të dhënave qendrore për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha burimet. Përveç mbledhjes së këtyre të dhënave, ky sistem duhet të jetë në gjendje të prodhojë informata të rregullta dhe të rifreskuara të cilat më pas do të mund të përdoren nga zbatuesit e ligjit, me theks të veçantë për identifikimin e çështjeve dominuese që ndërlidhen me faktorët e rrezikut dhe faktorët mbrojtës, çështjet që preokupojnë më së tepërmi sistemin, praktikat më të mira, mësimet e nxjerra, etj.

1.3. Integrimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijës dhe parimet udhëheqëse

Integrimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijës, nënkupton vendosjen e fëmijës në qendër të këtij sistemi, nëpërmjet zbatimit dhe promovimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, kushtetutës dhe tërë legjisllacionit vendor.

Kjo nënkupton dhe garanton që i tërë sistemi dhe akterët brenda tij nga sektori i edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, drejtësisë, mediave, shoqërisë civile, komunitetit dhe familjes, punojnë dhe kontribuojnë në mënyrë të bashkërenduar për të parandaluar abuzimin, shfrytëzimin, neglizhimin dhe shkeljet e tjera si dhe për të mbrojtur fëmijën në këto situata.

1.3.1. Çdo fëmijë është i njohur, i respektuar dhe i mbrojtur si zotërues i të drejtave, duke përjashtuar negocimin rreth të drejtave për mbrojtje

KOMENT:

Çdo fëmijë duke përfshirë, por jo vetëm: grupet e fëmijëve nga kategoritë e cenuara siç janë (fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian, emigrant; fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në kujdes alternativ ose fëmijët në situatë rruge, fëmijët që jetojnë në varfëri, duhet të trajtohen me dinjitet dhe si qenie njerëzore unike, me vlerë, si një personalitet individual, duke dalluar nevojat, interesat dhe privatësinë, me të drejtën e patjetërsueshme për pjesëmarrje.

Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të sigurojnë masa që fuqizojnë fëmijën për të mbrojtur veten dhe bashkëmoshatarët e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar këto të drejta. Mekanizmat e raportimit, duke përfshirë edhe linjën e ndihmës të drejt-përdrejtë duhet të jenë të integruara në sistemin e mbrojtjes së fëmijës. Fëmijët duhet të jenë pjesëmarrës dhe të përfshirë në të gjitha vendimet që ndërlidhen me interesat e tyre, duke përfshirë zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive të mbrojtjes së fëmijës, politikave, programeve dhe shërbimeve.

1.3.2. Asnjë fëmijë nuk duhet të dallohet

KOMENT:

Të gjithë fëmijët kanë qasje dhe përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në baza të barabarta pa marrë parasysh statusin dhe nevojat që ata mund të kenë. Këtu vjen në shprehje zbatimi i parimi të mos diskriminimit (shih detajet tek Moduli i Parë).

1.3.3. Sistemi i mbrojtjes së fëmijës përfshin masa parandaluese

KOMENT:

Sistemi duhet të ketë si fokus primar masat parandaluese të cilat përfshijnë:

- Aproximin e legjislacionit primar dhe sekondar për mbrojtjen e fëmijës;
- Masat politike që promovojnë të drejtat e fëmijës;
- Ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të fëmijëve, prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi;
- Nxjerrjen e politikave proaktive dhe masave për arritjen e grupeve të cenuara, prindërve dhe mbështetjen e familjeve, si dhe;
- Shërbimet sociale universale dhe të targetuara, duke përfshirë edhe strategjitë për parandalimin e varfërisë së fëmijëve dhe mbledhjes së rregullt të të dhënave.

1.3.4. Mbështetja e familjeve në rolin e tyre si ofrues parësor të kujdesit

KOMENT:

Pozita parësore dhe kryesore e familjes në ofrimin e kujdesit dhe mbrojtjen e fëmijës duhet të njihet dhe mbështetet nëpërmjet shërbimeve të përgjithshme dhe të përzgjedhura, përgjatë çdo fazë të intervenimit, veçanërisht nëpërmjet shërbimeve të parandalimit.

1.3.5. Shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të fëmijës, për të genë i lirë nga të gjitha format e dhunës

KOMENT:

Duhet të bëhen përpjekje të bashkërenduara për të informuar publikun, duke përfshirë fëmijët, rreth të drejtave të tyre duke inkurajuar veprimet që parandalojnë dhunën ndaj fëmijës, dhe parandalojnë stigmatizimin e fëmijëve viktime të dhunës.

1.3.6. Sistemi siguron përkujdesje dhe udhëzime për të gjithë

KOMENT:

Profesionistët që punojnë për fëmijët dhe me fëmijët duhet të trajnohen dhe të udhëzohen në lidhje me të drejtat e fëmijëve, legjislacionin dhe procedurat për mbrojtjen e fëmijëve dhe në përgjithësi mbi zhvillimin e fëmijës. Protokollet ndër disiplinare duhet të jenë në dispozicion për mbrojtjen e fëmijës.

Standardet, treguesit, mjetet, dhe sistemi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të jenë në dispozicion. Sistemi duhet në mënyrë efektive të rregullohet, që pastaj në mënyrë të pavarur të monitorohet dhe të jetë përgjegjës, duke siguruar qasjen, kualitetin dhe shërbimet dhe kujdesin për të gjithë fëmijët. Sistemi i monitorimit garanton një qasje të pakufizuar të monitorimit të kualitetit të shërbimeve të ofruara, në mënyrë të veçantë për ndonjërin nga format e kujdesit institucional.

Brenda organizatave që punojnë me fëmijët, politikat dhe mekanizmat raportues për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jenë prezentë. Të gjitha agjencionet dhe ofruesit e shërbimeve, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe kompanitë private, që punojnë me fëmijët duhet të kenë rregulla dhe udhëzime shumë të detajuara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.

1.3.7. Sistemi duhet të ketë mekanizimin e bashkëpunimit ndërshtetëror

KOMENT:

Rritja e numrit të fëmijëve që emigrojnë nëpër pikat ndërkufitare, cenon edhe më tepër të drejtat e tyre dhe mundësinë për t'i mbrojtur ata. Në këtë aspekt institucionet duhet të ndër marrin veprime të koordinuara, që nga sqarimi i rolit dhe përgjegjësive të zyrtarëve të përfshirë në trajtimin e këtyre rasteve, e duke vazhduar me mbledhjen e informatave të sakta mbi vendin e origjinës, emërimin e një pike kontakti për bashkëpunim ndër kufitar për mbrojtjen e këtyre fëmijëve, si dhe zhvillimin dhe aprovimin e procedurave, udhëzuesve dhe protokolleve të ndryshme.

1.3.8. Fëmija duhet të ketë mbështetje dhe mbrojtje

KOMENT:

Asnjë fëmijë në asnjë moment nuk duhet të jetë pa mbështetje dhe mbrojtje nga prindërit, kujdestarët ligjor apo ndonjë autoritet tjetër përgjegjës. Në kuptim të nevojës për veprime të vazhdueshme, institucionet brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijës duhet të caktojnë një person si përgjegjës për fëmijën që nga raportimi dhe referimi e deri në përcjelljen e tij përgjatë reintegrimit, kjo për të siguruar ndërlidhjen ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe për të siguruar një reagim koherent dhe gjithëpërfshirës.

1.3.9. Ngritja e kapaciteteve për identifikimin e rrezeve

KOMENT:

Trajnime të vazhdueshme duhen organizuar për të rritur kapacitetet për identifikimin e fëmijëve në situata potenciale të cënueshme, për të gjithë profesionistët në sektorin e edukimit, drejtësisë, punës sociale, mjekësisë, mediave, bizneseve dhe sektorit privat në përgjithësi, etj. Rregullat mbi raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijës janë qartë të definuara, dhe profesionistët që kanë obligime për raportim duhet të mbahen përgjegjës.

1.3.10. Krijimi i mekanizmave që janë të sigurt, konfidencial, e të qasshëm për raportim

KOMENT:

Mekanizmat janë prezent për fëmijët, përfaqësuesit e tyre dhe të tjerët për raportimin e të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë edhe përdorimin e linjës së ndihmës dhe komunikimit 24 orë përgjatë javës.

KAPITULLI 2

MASAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

2.1. Parandalimi

Parandalimi është një prej masave dhe veprimeve kryesore në mbrojtjen e fëmijës. LMF në kuadër të përkufizimeve se çka nënkuptohet me mbrojtje të fëmijës ka paraparë dy komponente kryesore nëpërmjet të cilave sigurohet mbrojtja e fëmijës: **parandalimi dhe përgjigja apo reagimi** ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës²¹.

1. Për të siguruar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës duhet të parandalohen rreziqet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës. Parandalimi përfshin perceptimin e situatave dhe ngjarjeve që kërcënojnë fëmijën sa më shpejt që të jetë e mundur dhe reagimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e problemeve të zhvillimit dhe sjelljes së fëmijës, problemet që ndodhin në mjedisin familjar, identifikimin e abuzimit dhe rritjen e masave mbrojtëse që promovojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.
2. Institucionet publike, private dhe organizatat jo qeveritare, sipas mandatit të tyre, duhet të zhvillojnë masa për të parandaluar nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese. Masat duhet të bazohen në nevojat e fëmijës, të mbështesin marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe personave që rrisin fëmijën, të mbështesin sjelljen sociale. Masat e tilla duhet të jenë të arritshme, me kohë dhe të kenë një efekt pozitiv afatgjatë.

Neni 24 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF ka paraparë që për tu siguruar të drejtat dhe mirëqenia e fëmijës duhet të identifikohen dhe parandalohen rreziqet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.

Parandalimi duhet të përfshijë masa dhe veprime nëpërmjet të cilave:

- Identifikohen situatat dhe rrethanat që kërcënojnë fëmijën;
- Zbatohen me urgjencë dhe në afat sa më të shpejtë të mundshëm;
- Identifikohen situatat dhe rrethanat familjare;
- Identifikohet dhuna dhe të gjitha shkeljet e të drejtave të ndërlidhura;
- Rriten masat mbrojtëse që promovojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.

Në paragrafin e dytë të këtij neni, LMF ka paraparë obligimet e institucioneve publike dhe jo publike për t'i ndihmuar fëmijës dhe familjes për t'i zvogëluar kërcënimet, gjithnjë duke u bazuar në nevojat e fëmijës, dhe masave tjera që mbështesin raportet dhe marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe familjes.

²¹ Neni 3, par.1 (pika 1.7) Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084).

Masat e tilla duhet të jenë:

- Të arritshme për fëmijën, prindërit apo kujdestarët;
- Në kohë;
- Të jenë me efekt pozitiv dhe
- Afatgjate.

SHEMBULL:

Fëmija apo fëmijët janë duke jetuar me prindërit e tyre biologjikë, mirëpo këta të fundit janë të varur nga alkooli dhe substancat narkotike. Kohëve të fundit policia dhe QPS kanë identifikuar këtë familje me potencial të lartë të rrezikut për dhunë ndaj fëmijëve, duke përfshirë keqtrajtimin dhe lënien pas dore.

Përkundër që akoma nuk është raportuar dhuna ndaj fëmijëve, institucionet në këtë rast duhet të ndër marrin masa dhe veprime për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve duke:

- Shtuar kujdesin në shkollë;
- Ofrimin e programeve ekstra kurrikulare në shkollë dhe jashtë shkollës;
- Angazhimin më të madh të familjes së afërt dhe komunitetit;
- Regjistruar rastin në bazën e të dhënave;
- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Asistimin e prindërve përmes programeve të ndihmës për largim nga varësia prej alkoolit dhe substancat narkotike;
- Ofrimin e programeve afatgjate rehabilituese, etj.

2.2. Mbrojtja ligjore

Siç theksuam më lartë mbrojtja e fëmijës sipas përkufizimit të LMF ka dy komponentë: parandalimin dhe përgjigjen apo reagimin. Mbrojtja ligjore përcakton masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren sipas komponentës së dytë që është përgjigja apo reagimi për të mbrojtur fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi.

1. Qendra për Punë Sociale dhe policia ndihmojnë dhe ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur familja nuk është në gjendje apo kur ekziston dyshimi i bazuar se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi.
2. Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja dhe mbrojtja e prindërve, ose kur për shkak të interesit të tij më të mirë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.
3. Institucionet kompetente mbështesin prindërit apo kujdestarin në rritjen e fëmijës së tyre dhe duhet të sigurojnë ndihmat e nevojshme të familjes në nevojë, madje qysh në fazat e hershme kur një gjë e tillë del të jetë e nevojshme, si dhe t'i referojë fëmijën dhe familjen në shërbimet e mbrojtjes së fëmijës.

Është me rëndësi të theksohet që përkundër faktit që LMF ka paraparë obligimet për mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet reagimit dhe ndërhyrjes në familje, institucionet gjithnjë duhet të kujdesen që largimi i fëmijës nga kujdesi familjar apo gjendja në të cilën ndodhet, gjithnjë kur është e mundur, duhet të vlerësohet dhe vendoset **vetëm si masë e fundit, për një periudhë sa më të shkurtër kohore të mundshme**. Vendimi për largim duhet t'i nënshtrohet një rishikimi strikt dhe të rregullt, gjithnjë në favor të mundësisë që fëmija aty ku është e mundur dhe pas largimit të pengesave, të kthehet tek prindërit apo të vendoset në njërën prej formave të përhershme të mbrojtjes.

2.3. Detyrimi ligjor për raportim

Hapi i parë dhe kryesor para raportimit të rastit është identifikimi. Identifikimi i dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe/ose abuzimit të fëmijës bëhet nga prindërit apo kujdestari, shkollat dhe institucionet edukativo arsimore, shëndetësore, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, policia, prokuroria, gjykatat, organet administrative të nivelit lokal dhe qendror, pra çdo person fizik ose juridik i cili vihet në kontakt me fëmijën, si dhe vetë fëmija.

Identifikimi mund të vijë si pasojë e një incidenti që mund të ndodhë apo për shkak të rritjes së shqetësimit lidhur me mirëqenien e një fëmije nga personat që janë në kontakt me fëmijën.

Është shumë me rëndësi njohja e shenjave dhe simptomave dhe faktorëve të rrezikut tek fëmija ose sjelljet e fëmijës dhe familjes që tregojnë mundësinë e abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijës. Vërtetimi i dyshimit të bazuar mund të jetë drejtpërdrejtë, nga vetë fëmija ose indirekt, nga persona të tjerë që kanë njohuri ose dyshim të bazuar se fëmija është abuzuar.

Ku duhet raportuar?

- *Policia;*
- *Qendër për Punës Sociale*
- *Zyra për Mbrojtjen e Viktimave; apo*
- *Çdo person i besueshëm, bartës i përgjegjësive publike, apo institucion relevant.*

Si duhet raportuar?

- *Me shkrim (postë, email apo formë tjetër); ose*
- *Gojarisht (me prezencë fizike, telefon, etj).*

Pas identifikimit të rastit, çdo person është i detyruar për të raportuar dhe referuar pa vonesë për çdo informatë të pranuar në lidhje me dyshimin e bazuar se një fëmijë është dhunuar, shfrytëzuar, abuzuar dhe/apo neglizhuar. Detyrimi përfshin edhe identifikimin e të gjitha situatave dhe rrethanave dhe nuk i nënshtrohet vjetërsimit për të raportuar rastin.

ME RËNDËSI:

Të gjithë individët, profesionistët apo institucionet që bëjnë identifikimin e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit ose abuzimit të fëmijës duhet të bëjnë regjistrimin e saktë të të dhënave në lidhje me identitetin e fëmijës, familjes, autorit të dyshuar të abuzimit, si dhe, nëse është e mundur, përshkrimin e gjendjes së fëmijës, dëmtimeve të mundshme, fotografimin e personit apo personave, vendeve dhe dëmtimeve, regjistrimin e deklaratave të fëmijës ose shokëve të tij për rrethanat e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit.

Dokumentacioni i mbledhur mund të përdoret si provë e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe/ose abuzimit në procedurat e mëtejshme të mbrojtjes së fëmijës.

LMF krahas detyrimit për raportim të rasteve të dhunës, abuzimit, keqtrajtimit apo neglizhimit, ka paraparë edhe mbrojtjen e raportuesit, duke e përjashtuar atë nga çdo detyrim penal dhe civil, detyrim që mund të lidhet me aktin e raportimit. Pra ligji i ka dhënë të drejtën e mbrojtjes së veçantë dhe nëse është e nevojshme edhe sigurinë e personit.

Kush detyrohet të raportoj:

- Çdo person
- Prindi ose kujdestari
- **Profesionistët për mbrojtjen e fëmijës që përfshin, por nuk kufizohet:** (edukatorë, mësimdhënës, mjekë, stomatologë, infermierë, psikologë, punonjës social, policë, çdo ofrues i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës publik, privat ose jo qeveritar, dhe kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar dhunë...)

1. Çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që mund t'i nënshtrohet, ose që ndaj fëmijës është ushtruar çdo formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtimit, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në polici ose në Qendrën përkatëse për punës sociale.
2. Prindi ose kujdestari si dhe çdo person tjetër, nëse ka arsye për të dyshuar se ndaj fëmijës është ushtruar dhunë, abuzuar, keqtrajtuar, shfrytëzuar, është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën përkatëse për punës sociale.
3. Profesionisti për mbrojtjen e fëmijës, që përfshinë, por nuk kufizohet në: edukator, mësimdhënës, mjek, stomatolog, infermier, psikolog, punonjës social, polic, çdo ofrues i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës publik, privat ose përfaqësues i organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës, dhe kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar dhunë, abuzuar, keqtrajtuar, braktisur, shfrytëzuar apo neglizhuar është i obliguar që rastin ta raportojë me shkrim ose gojarisht në polici, në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave ose në QPS.
4. QPS ka si detyrë të njoftojë organin e policisë në çdo rast të referimit të mbrojtjes së fëmijës dhe anasjelltas, organi i policisë ka si detyrim të njoftojë Qendrën për Punë Sociale, në çdo rast të raportimit të rasteve si të identifikuar, të dyshuar ose të abuzuar.
5. Çdo person që e raporton informacionin me besueshmërinë tek institucionet dhe mekanizmi formal duhet të përjashtohet nga çdo detyrim civil apo penal, detyrim që mund të lidhet me aktin e raportimit. Ata duhet të kenë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nëse është e nevojshme për sigurinë e personit.

Të gjithë ata që nuk raportojnë rastet e dyshuara dhe të identifikuar janë përgjegjës penalisht dhe mund të dënohen me gjobë dhe me burgim.

Është me rëndësi të theksohet që Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë katër rrethana cilësuese dhe personat të cilët mund të kryejnë veprë penale nëse nuk raportojnë rastin.

- Në paragrafin e parë mund të kryej veprë penale **'...kushdo...'**
- Në paragrafin e dytë ka paraparë rrethin familjar **'prindi, prindi adoptues apo kujdestari'**
- Në paragrafin e tretë ka paraparë **'profesionistët'**
- Në paragrafin e katërt ka paraparë si rrethanën më rënduese **'vdekjen apo dëmtimin e rëndë të shëndetit'**.

Sanksionimi penal i mos raportimit:

1. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar një incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit dhe nuk raporton menjëherë abuzimin ose moskujdesin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që gjatë angazhimit profesional lidhur me fëmijën, ka arsye për të dyshuar se fëmija ka pësuar incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit ose ka qenë i nënshtruar ndaj dhunës apo kanosjes për përdorim të dhunës, dhe nuk e raporton menjëherë rastin, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e fëmijës apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 247 Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve, Kodi Penal i Republikës së Kosovës

2.4. Ndarja e fëmijës nga familja

Siç kemi theksuar edhe në modulet e tjera, e drejta e fëmijës për të pasur familje dhe jetuar së bashku me familjen është njëra prej të drejtave kryesore, e cila është e garantuar me të gjitha konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

'Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj'²². Kushtetuta ka garantuar mbrojtjen e familjes duke i dhënë një mbrojtje të veçantë, andaj edhe duke u nisur nga ky obligim kushtetues, janë nxjerrë një mori ligjesh të cilat janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës, e të cilat në qëllimin dhe fushëveprimin e tyre e kanë familjen dhe mbrojtjen e saj.

Familja është përgjegjëse kryesore për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur fëmijën. Institucionet ndihmojnë familjen me këtë detyrim dhe ndërhyjnë vetëm kur familja nuk është në gjendje apo nuk është e aftë, ose ka nevojë për ndihmë për të mbrojtur fëmijën.

²² Neni 37, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Megjithëse fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit apo kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, ekzistojnë disa situata dhe rrethana kur ndarja e fëmijës nga familja është në interesin më të mirë të fëmijës. Ndarja veçanërisht duhet të ndodhë, nëse fëmija është në rrezik dhe kjo ndarje është e pashmangshme, dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë.

LMF në nenin 27 ka paraparë disa rrethana dhe situata në të cilat fëmija duhet të ndahet nga familja. Siç shihet në paragrafët e këtij neni, ndarjes duhet ti paraprijnë disa veprime shumë strikte dhe në afate kohore rigoroze. Poashtu edhe veprimet që ndërmerren pas ndarjes janë mjaft të detajuara dhe kërkojnë vëmendjen e të gjithëve në mënyrë që ndarja të përfundojë në një afat sa më të shkurtër kohor.

- 1.** Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës.
- 2.** Përfundimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon shtatëdhjetë e dy (72) orë.
- 3.** Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë njëzet e një (21) ditëshe, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime deri në kohë kur çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm.
- 4.** Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç se në rastet nëse kjo ndarje është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe nëse kjo ndarje është e pashmangshme dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë. Nëse fëmija ndahet nga prindërit, kujdestari i tij, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të dëgjohen, konsiderohen dhe dokumentohen në dokumentacionin që hartohet për këtë qëllim. Pikëpamjet e fëmijës duhet të dëgjohen dhe dokumentohen nga shërbimet sociale ose gjykata.
- 5.** Në të gjitha procedurat në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësi që të marrin pjesë në procedurë dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.
- 6.** Fëmija që është i ndarë nga njëri ose të dy prindërit ka të drejtë që të mbajë lidhje personale dhe takime të drejtpërdrejta, të rregullta me të dy prindërit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.
- 7.** Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga institucionet kompetente, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga institucionet kompetente) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, sipas kërkesës institucioni u jep prindërve, fëmijës ose kur është rasti një anëtar tjetër të familjes të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhet anëtarit ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Duke siguruar që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.
- 8.** Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ, zbatohet, monitorohet dhe raportohet nga Qendra për Punë Sociale dhe rishikohen rregullisht siç parashihet me legjislacion në fuqi ose me vendim të gjykatës.

Përveç tjerash, ky nen ngërthen në vete dy parime të rëndësishme të të drejtave të fëmijës:

- 1. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, fëmija mund të ndahet nga prindërit vetëm kur këtë e kërkon interesi më i lartë i tij dhe**
- 2. gjitha procedurat për ndarjen e fëmijës nga prindërit duhet të jenë ligjore dhe të drejta.**

Në çdo procedurë të tillë duhet të jenë pjesëmarrës palët e interesuara (fëmija dhe prindërit), të cilët kanë të drejtën për tu shprehur përpara organit që do të marrë vendimin në lidhje me ndarjen e fëmijës prej prindit ose prindërve. Ky nen rikonfirmon të drejtat e fëmijës për të mbajtur marrëdhënie dhe kontakte me të dy prindërit dhe përcakton detyrimin e organeve shtetërore për dhënie informacioni mbi vendndodhjen e secilit (prindit apo fëmijës). Një të drejtë të tillë gati të ngjashme e parasheh edhe KDF.

'Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës, përveç rasteve kur autoritetet kompetente, në bazë të shqyrtimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija'.

Neni 9 par.1 i KDF

Mbrojtjen e fëmijës nga ndarja prej familjes e ka rregulluar edhe Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ, ku ndër të tjera ka paraparë udhëzimet për shtetet, institucionet, familjet dhe individët që:

Largimi i fëmijës nga përkujdesja e familjes duhet të shihet si një masë e fundit dhe kur është e mundur, duhet të jetë i përkohshëm dhe me kohëzgjatje sa më të shkurtër. Vendimet për largime të tilla duhet të rivlerësohen rregullisht dhe rikthimi i fëmijës nën përkujdesjen prindërore, sapo shkaqet fillestare të largimit të jenë zgjidhur ose mënjanuar, duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës, duke iu përmbajtur vlerësimin të parashikuar në paragrafin e mëposhtëm.

Kushtet e vështira financiare dhe materiale, ose kushtet që shkaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të veçantë një varfëri të tillë, nuk duhet të shërbejnë kurrë si një justifikim i vetëm për largimin e një fëmije nga përkujdesja prindërore, për vendosjen e tij nën përkujdesje alternative, ose për parandalimin e riintegrit të tij/saj, por duhen parë si një sinjal për nevojën e ofrimit të mbështetjes së duhur për familjen.

I duhet kushtuar vëmendje promovimit dhe respektimit të të gjitha të drejtave të tjera në rastin e fëmijëve pa kujdes prindëror, përfshi por jo e kufizuar në të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor dhe të tjera shërbimeve bazë, të drejtën për identitet, liri apo besim fetare, të drejtën e gjuhës dhe të mbrojtjes së pronës dhe trashëgimisë.

Vëllezërit dhe motrat që aktualisht kanë lidhje midis tyre, parimisht nuk duhet të ndahen nga njëri-tjetri kur vendosen nën përkujdesje alternative nëse nuk ekziston ndonjë rrezik i qartë abuzimi apo justifikime të tjera në të mirë të interesave të fëmijëve. Në secilin rast, duhet bërë çdo përpjekje për t'i mundësuar vëllezërve dhe motrave që të ruajnë kontaktet me njëri-tjetrin, përveç rasteve kur kjo është në kundërshtim me dëshirën ose interesat e tyre.

Duke pranuar që në pjesën më të madhe të vendeve, ku për shumicën e fëmijëve pa kujdes prindëror kujdesen jo formalisht të afërmit apo të tjerët, shtetet duhet të krijojnë mekanizma të përshtatshëm, në përputhje me këto udhëzime, për të siguruar mirëqenien dhe mbrojtjen e tyre, kur ata janë pjesë e zgjidhjeve të tilla joformale duke respektuar siç duhet dallimet dhe praktikat kulturore, ekonomike, gjinore dhe fetare që nuk bien ndesh me të drejtat dhe interesat më të mira të fëmijës.

Pika 14, 15, 16, 17 dhe 18, Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ për Fëmijët.

2.5. Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore

Mbrojtja e fëmijës pa kujdes prindëror dhe sigurimi i mirëqenies në kuadër të një familjeje tjetër garantohet me LMF, KDF dhe legjislacionin në fuqi. Kur një fëmije i mohohet përkohësisht ose në mënyrë të përhershme mjedisi familjar, ose kur nuk është në interesin e tij/saj më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ai/ajo ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti i cili është i obliguar të ofrojë mbrojtje dhe të sigurojë përkujdesje alternative për fëmijën. Përveç LMF, mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore dhe format alternative të mbrojtjes kryesisht rregullohen përmes Ligjit për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-32 dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar Nr. 2011/04-L-081.

LMF duke u udhëhequr nga parimet dhe të drejtat e garantuara nga KDF, jo vetëm se ka përcaktuar format ekzistuese të mbrojtjes juridike për fëmijët pa kujdes prindëror, ajo ka paraparë edhe ka paraparë edhe një formë të re të mbrojtjes "Jetesa e pavarur e mbikëqyrur".

1. Mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror realizohet përmes formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, siç janë:

- 1.1. kujdestaria;
- 1.2. strehimi familjar;
- 1.3. strehimi rezidencial
- 1.4. adoptimi, dhe;
- 1.5. jetesa e pavarur e mbikëqyrur.

2. Institucionet sigurojnë forma të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 28 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

- 1.** Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komuna obligohen që t'i ofrojnë mbështetje materiale familjes strehuese për përkujdesje për fëmijën gjatë qëndrimit në strehim familjar.
- 2.** Familja strehuese nuk lejohet të ndaj asnjë informatë me personat e paautorizuar, mediat dhe të tjerët lidhur me fëmijën gjatë qëndrimit dhe pas largimit nga qëndrimi në strehim familjar.

Neni 29 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Ligji mbi Familjen mandaton Organin e Kujdestarisë që të ushtrojë mbikëqyrjen e përgjithshme dhe të vazhdueshme ndaj ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore. Dispozitat ligjore në kuadër të këtij ligji fillojnë që nga koha kur fëmija ka lindur dhe prindërit e të cilit janë të panjohur, e deri tek përfundimi i procedurës për aplikimin e ndonjëres prej formave të veçanta të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdes prindëror, përfshirë edhe strehimin familjar dhe adoptimin.

Sipas LMF format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare të fëmijëve pa kujdesin prindëror janë: **kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial, adoptimi dhe jetesa e pavarur e mbikëqyrur.**



Kujdestaria

Është formë e mbrojtjes për fëmijët pa kujdes prindëror të cilët vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike, kur prindërit e tyre e kanë të pamundur të ushtrojnë përkujdesje prindërore, për shkak se: të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur të zhdukur, iu është hequr kujdesi prindëror ose kanë humbur aftësinë për të vepruar, apo për çdo shkak tjetër i cili me vendim të gjykatës jep arsye për vendosje në të mirë të mirëqenies së fëmijës.



Strehimi familjar

Është formë e mbrojtjes alternative që nënkupton strehimin e fëmijës në familjen e cila mund të përmbushë me sukses detyrimet prindërore, posaçërisht në pikëpamje të kujdesit, të edukimit të arsimimit dhe të aftësimin të drejtë të fëmijës për jetë të pavarur.



Strehimi rezidencial

Është formë e mbrojtjes së fëmijës pa kujdes prindëror, e cila sigurohet nëpërmjet strehimit dhe plotësimit të nevojave themelore jetësore, mbrojtjes shëndetësore të fëmijës, kur qëndrimi në familjen biologjike dhe familjen e ngushtë është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës.



Adoptimi

Është formë themelore për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, nëpërmjet të cilit fëmijës pa kujdes prindëror, i sigurohet një familje tjetër me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjik.



Jetesa e pavarur e mbikëqyrur

Është një formë e mbrojtjes dhe e kujdesit alternativ si vazhdim i mbështetjes për fëmijën që ka qenë pjesë e çdo forme të kujdesit alternativ për të forcuar aftësitë e tij për jetesë të pavarur në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

2.6. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës

Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës (Shtëpitë) paraqesin ndoshta risinë më të madhe dhe më unike, në aspektin e mbrojtjes institucionale dhe profesionale për fëmijët që janë viktimë e dhunës. Shtëpitë, funksionojnë dhe zbatojnë këto koncepte dhe parime të punës:

- Ofrimin e të gjitha shërbimeve mbrojtëse ndaj fëmijës nën një "kulm" përgjatë 24 orëve dhe shtatë ditë në javë "24/7".
- Zbatimin e drejtësisë mike, përfshirë respektimin e të drejtës së fëmijës për pjesëmarrje, duke u siguruar që fëmija të dëgjohet dhe të marrë informacionin dhe mbështetjen e duhur për t'i ushtruar këto të drejta.
- Reagimin urgjent nëpërmjet veprimeve dhe vendimeve të cilat duhet të merren dhe zbatohen pa vonesa të paarsyeshme në mënyrë që të shmanget ndonjë dëm i pariparueshëm. Të gjithë profesionistët për mbrojtjen e fëmijës duhet t'i japin prioritet rasteve ku jeta dhe interesi i fëmijës rrezikohet.
- Bashkëpunimin ndërinstytucional gjatë hetimeve, procedurave, diagnostifikimeve, vlerësimit të nevojave dhe ofrimit të shërbimeve, me qëllim që të shmanget traumatizimi i mëtejshëm dhe të arrihen rezultate në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës.
- Ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të arritshme që përmbushin nevojat themelore dhe komplekse të fëmijës dhe të prindit apo kujdestarit.
- Garantimin e standardeve më të larta profesionale, duke përfshirë trajnimin dhe burimet e përshtatshme për profesionistët që punojnë me fëmijën viktimë apo dëshmitar.
- Sigurimin e mbrojtjes dhe shërbimeve të nevojshme të cilat duhet të realizohen në mënyrë profesionale brenda afatit të paraparë ligjor.

Afat i qëndrimit në shtëpi

Shtëpitë ofrojnë shërbime emergjente dhe mbrojtje për fëmijën deri në gjetjen e një zgjidhje në interesin më të mirë të fëmijës, **jo më gjatë se tri (3) ditë**. Brenda këtij afati, duhet të bëhet bashkimi me familjen ose vendosja e fëmijës në njërën prej formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, varësisht nga interesi më i mirë i fëmijës.

1. Me këtë ligj themelohen shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale pran Qendrave për Punë Sociale përkatëse ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore.
2. Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale përcakton standardet dhe miraton themelimin e shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve.
3. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tri (3) ditë.
4. Shtëpitë shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar. Ofrimin e shërbimeve këshilluese, veçanërisht terapive të ndryshme, si dhe shërben si vend strehim i përkohshëm i fëmijëve të cilët nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpi, nuk mund të strehohen në strehim familjar, apo atyre që janë në shtëpi por kërkohet largimi i tyre për shkak të rrezikut të lartë që i kanoset jetës apo shëndetit të tyre.

5. Shtëpitë në thelb të punës kanë zbatimin e konceptit të qasjes miqësore, reagimit urgjent, veprimin ndërdisiplinor dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe akterëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e rastit në afat sa më të shkurtë kohor.
6. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe donatorët.

Neni 30 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Shtëpitë, ofrojnë shërbimet si vijon:

- Shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës;
- Shërbime për zhvillimin e procedurave gjyqësore dhe ligjore për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar;
- Shërbime këshilluese, veçanërisht terapi të ndryshme;
- Shërbime të strehimit të përkohshëm të fëmijës i cili nuk ka mundësi të kthehet në familje, nuk mund të strehohet në strehim familjar, apo është në familje por kërkohet largimi i tij për shkak të rrezikut të lartë që i kanoset jetës apo shëndetit të tij.

Aspektet që ndërlidhen me organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës do të rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të miratuar nga Qeveria.

Për të kuptuar më tepër për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel të shteteve të ndryshme të Bashkimit European kliko në këtë faqe interneti²³:

<https://www.barnahus.eu/en/>

2.7. Monitorimi i masave të mbrojtjes

Caktimi i masës mbrojtëse sipas LMF bëhet me qëllim që të largojë rrezikun që i kanoset fëmijës, mirëpo ai për shkak të ndikimit anësor që mund të ketë ndaj kufizimit të të drejtave të tjera të fëmijës, duhet ti nënshtrohet një monitorimi strikt të zbatimit të masës mbrojtëse. LMF, ka përcaktuar përgjegjësi dhe obligime për menaxherin e rastit dhe kujdestarin për monitorimin e këtyre masave. Poashtu janë përcaktuar afate dhe rregulla me ecurinë e zbatimit të masave dhe kundrejt tyre edhe propozimet për vazhdimin apo ndërprerjen e masave.

²³ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

1. Menaxheri i rastit në QPS dhe kujdestari i fëmijës janë përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes për fëmijën dhe të paktën një (1) herë në muaj duhet të bëhet rishikimi lidhur me mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj, në konsultim me profesionistët e tjerë të organit të kujdestarisë.
2. Menaxheri i rastit për mbrojtjen e fëmijës duhet të merr pëlqimin e Organit të Kujdestarisë për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familje, duke e argumentuar edhe me dokumentacion përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje është në interesin më të mirë të tij.
3. Nëse masa mbrojtëse është caktuar nga gjykata, menaxheri i rastit paraqet kërkesën në gjykatë për heqjen e masës mbrojtëse.
4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshinë informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.

Neni 31 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF ka paraparë dy situata kur hiqet dhe nga kush duhet të hiqet masa:

1. Heqja e masës mbrojtëse me pëlqimin e Organit të Kujdestarisë;
2. Heqja e masës mbrojtëse me vendim nga Gjykata.

Është me rëndësi të kuptohet që në raste të caktuara, nëpërmjet caktimit të masës mbrojtëse për fëmijën, mund të caktohet edhe detyrimi për prindin apo prindërit për të ndjekur programe prindërimi apo kryerjen e ndonjë veprimi tjetër. Prandaj në mënyrë paralele duhet të monitorohen edhe zbatimi i masës mbrojtëse për fëmijën, por edhe zbatimi i programit të prindërimit apo veprimit të caktuar nga ana e prindit apo prindërve.

2.8. Masat për aftësim prindëror

Siç e theksuam më lartë, në kuadër të masave mbrojtëse për fëmijën dhe konform planit individual të mbrojtjes, prindit apo prindërve duhen caktuar masa për aftësim prindëror. Planin për zbatimin e masave për aftësim prindëror e harton zyrtari për mbrojtjen e fëmijës, kjo me qëllim që prindërit të aftësohen që pas përfundimit të masës mbrojtëse për fëmijën, të jenë në gjendje të pranojnë fëmijën e tyre.

Procesit të caktimit të masave për aftësim prindëror, i paraprinë vlerësimi i situatës familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje, i cili realizohet nga zyrtari për mbrojtjen e fëmijës.

1. Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me tryezën multidisiplinare, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.
2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtjeje të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.
3. Plani për aftësim prindëror mund të përmbajë, por nuk kufizohet, masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës sociale, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

Neni 32 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF, ka paraparë në mënyrë taksative llojet e programeve për aftësim prindëror të cilat janë të obligueshme për prindin apo prindërit. Ky programe përfshin por nuk kufizohen në këto masa të aftësimit prindëror:

- Programe të aftësimit prindëror;
- Këshillimi psikologjik;
- Menaxhimi i zemërimit;
- Trajtimi mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope;
- Trajtimi i shëndetit mendor;
- Ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendjen civile, skemën e ndihmës sociale, shërbimin e punësimit, si dhe çdo ndërhyrje tjetër e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

Zyrtari për mbrojtjen e fëmijës është i mandatuar për të monitoruar zbatimin e planit dhe ndonjërit prej programeve të përcaktuara si më lart.

IV. ANEKS

A) RAST STUDIMI

RASTI A

Dështimi i autoriteteve sllovene për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 për të lehtësuar të drejtën për takim të babait me vajzën e tij - megjithëse ai nuk mund të parashtronte përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut kërkesën në emër të vajzës së tij për sa kohë që nëna kishte kujdestarinë e plotë

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN EBERHARD DHE M. K. SLLOVENISË

(Kërkesat nr. 8673/05 dhe 9733/05)

1 Dhjetor 2009

1. Faktet kryesore

Çështja e ka zanafillën në dy kërkesa nga z. Johann Ivan Eberhard dhe znj. M., vajza e tij. Z. Eberhard ishte i martuar me M.E. dhe ata jetonin së bashku me vajzën e tyre, M., derisa M.E. u largua së bashku me fëmijën dhe paraqiti kërkesën për divorc në Prill të vitit 2001. Në Shkurt të vitit 2002, ata u divorcuan dhe kujdestaria e fëmijës ju caktua M.E.

Më 4 Maj 2001, z. Eberhard dhe gruaja e tij firmosën një marrëveshje lidhur me të drejtën për takimet me fëmijën. Pasi kishte kaluar një muaj nga momenti që kërkuesi pretendonte se nuk i ishte lejuar të vizitonte vajzën e tij, ai paraqiti një kërkesë në Qendrën për Mirëqenie Sociale të Šentjurit për të përcaktuar zyrtarisht marrëveshjen për të drejtën e takimeve. M.E. vazhdonte të kundërshtonte lejimin e takimeve me vajzën e tyre. Më 1 Gusht 2001, Qendra për Mirëqenie Sociale e Šentjurit lëshoi një urdhër që i lejonte atij të takonte fëmijën e tij katër orë në javë, por nuk pranoi t'i jepte mundësinë e marrjes së fëmijës nga çerdhja dhe urdhëroi që M.E. të sillte fëmijën në një pikë takimi të përcaktuar. Vendimi për të drejtën e takimit u bë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm më 16 Tetor 2002.

M.E. nuk e zbatoi vendimin, prandaj kërkuesi në Nëntor të vitit 2002 kërkoi ekzekutimin e vendimit. Më pas, Njësia Administrative e Šentjurit urdhëroi M.E., të lejonte kërkuesin për të vizituar fëmijën dhe në rast se ky vendim nuk do respektohej ajo do gjobitej. Si rezultat i refuzimit të vazhdueshëm të M.E. për t'i lejuar kërkuesit për të vizituar fëmijën, Njësia lëshoi disa vendime kundër saj për pagimin e gjobave. M.E. i apeloj këto vendime ku u konstatua se M.E. nuk kishte qenë e informuar lidhur me moskryerjen e takimeve të kërkuesit me vajzën e tyre. Vendimi për të drejtën e takimit në vetvete nuk kishte ndryshuar dhe për rrjedhojë ai vijoi të ishte në fuqi.

Më 6 Qershor 2003, z. Eberhard parashtrroi një kërkesë lidhur me kujdestarinë e fëmijës. Pati një sërë përpjekjesh për të përcaktuar një datë seance, po kjo nuk rezultoi e suksesshme përfshirë këtu edhe refuzimin e M.E. për të bashkëpunuar dhe kërkesën e parë të kërkuesit për të caktuar një psikolog. Në Dhjetor 2005, kërkuesi i kërkoi gjykatës vendase të nxirrte një vendim të ndërmjetëm për kujdestarinë dhe shtoi një kërkesë

alternative për një urdhër të ndërmjetëm lidhur me të drejtën për takim. Gjithashtu, u kërkua caktimi i një eksperti të ri. Më 22 Shkurt 2006, z. Eberhard parashtrori ankesë lidhur me mosveprimet e gjyqtarit.

Në Mars 2006, kërkesa e kërkuesit u shqyrtua nga një ekspert, kështu që më në fund mund të mbahej një seancë. Në maj, në të njëjtin vit gjykatat vendase hodhën poshtë kërkesën e kërkuesit lidhur me vendimin e ndërmjetëm mbi kujdestarinë, por lanë në fuqi kërkesën e tij alternative lidhur me vendimin e ndërmjetëm për të drejtën për takim. Z. Eberhard dhe vajzës së tij ju lejua të kalonin kohë së bashku gjatë javës dhe në fundjavë.

Pasi M.E., në raste të caktuara vijoi t'i mohonte kërkuesit takimet me fëmijën, në Gusht të vitit 2006 kërkuesi u ankua, duke kërkuar pagimin e gjobave ndëshkuese të dhëna ndaj M.E. Për këtë u caktua një seancë, por më pas seanca u shty dhe kërkuesi kërkoi një apel rishikues. Gjatë seancës dëgjimore në Shtator të 2007, proceset u bashkuan në një kërkesë të vetme lidhur me të drejtën e takimeve që kërkuesi kishte parashtruar në një proces të veçantë në vitin 2004. Gjatë një seance dëgjimore, më 10 Janar 2008, palët ranë dakord përfundimisht për marrëveshjet e reja të takimeve dhe z. Eberhard e tërhoqi kërkesën e tij mbi kujdestarinë.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkuesit u ankuan lidhur me dështimin e shtetit në mosekzekutimin e të drejtës për kontakte të dhënë në proceset administrative si dhe vonesat e hasura në proceset lidhur me kujdestarinë e fëmijës dhe të drejtën për takime me fëmijën, duke shkelur kështu nenet 6 dhe 8.

Pranueshmëria

Fillimisht, Gjykata adresoi kundërshtimet e Qeverisë së z. Eberhard nuk kishte tagër për të vepruar në emër të vajzës së tij, pasi ishte nëna që kishte kujdestarinë e plotë të fëmijës.

Për këtë qëllim, Gjykata risolli në vëmendje shqyrtimet e kaluara lidhur me rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet prindërve, ku prindit që kishte të drejtën e kujdestarisë i ishte besuar mbrojtja e interesave të fëmijës. Në situata të tilla, pozita si një prind i njohur ligjërish (pa kujdestari) nuk mund të konsiderohej si një kriter bazë për të sjellë një kërkesë edhe në emër të fëmijës. Në këtë rast, pozita e kërkuesit të parë si baba ishte e pamjaftueshme, dhe rrjedhimisht, kërkuesi i parë nuk kishte asnjë tagër për të vepruar në emër të kërkuesit të dytë.

Për rrjedhojë, Gjykata e kufizoi shqyrtimin e rastit duke e konsideruar si kërkues të vetëm z. Eberhard.

Neni 8

Fillimisht, Gjykata vuri në dukje se lidhja midis kërkuesit dhe të bijës binte në fushëveprimin e "jetës familjare" brenda kuptimit të nenit 8. Gjykata theksoi se sipas nenit 8, shtetet kanë detyrime pozitive për të lehtësuar kontaktin midis prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe se proceset joefektive dhe me vonesa mund të përbëjnë shkelje të këtij neni. Në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve mbi të drejtën familjare, Gjykata theksoi më tej se si kalimi i kohës mund të ketë një ndikim negativ të fuqishëm në marrëdhënien prind - fëmijë, kështu që zbatimi i menjëhershëm i masës është i domosdoshëm.

Pra, roli i Gjykatës ishte të përcaktonte nëse autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë hapa të domosdoshëm, të përshtatshëm dhe efektivë për të lehtësuar ekzekutimin e vendimit lidhur me të drejtën për kontakt duke marrë parasysh refuzimin për përmbushjen e tij nga ana e nënës. Gjykata vuri në dukje se vendimi për të drejtën për kontakt nuk ishte ekzekutuar që nga Tetori i vitit 2002, momenti kur u bë përfundimtar dhe vendimi i gjykatës vendase për rregullimet e reja në maj të 2006, dhe se asnjë masë nuk u ndërmor nga autoritetet në

përgjigje të refuzimit të vazhdueshëm nga M.E. për të lejuar takimet me fëmijën. Gjykata arriti në përfundimin se në lidhje me ekzekutimin e vendimit të së drejtës për kontakt dhe takim, shteti nuk kishte krijuar kushtet e nevojshme për ta ekzekutuar atë dhe për të siguruar kontaktin ndërmjet kërkuesit dhe vajzës së tij.

Proceset në lidhje me të drejtën për takime dhe kujdestari zgjatën më tepër se katër vite, gjatë së cilës kërkuesi kishte pasur jashtëzakonisht shumë pak kontakte me vajzën e tij. Gjykata pranoi se gjykatat vendase kishin mundësinë të inicionin masa të ndërmjetme, por nuk arritën ta bënin këtë. Përveç kësaj, marrëveshja e të drejtës për takime duhet të ishte trajtuar me urgjencë nga autoritetet, por ata nuk kishin bërë përpjekje efektive për ekzekutimin e kësaj mase.

Prandaj, Gjykata pranoi se autoritetet sllovene nuk arritën të siguronin ekzekutimin e marrëveshjeve të të drejtës për takim, duke rezultuar në mungesë të kontaktit midis kërkuesit dhe vajzës së tij për më shumë se katër vite dhe për më tepër nuk arritën të kryejnë në mënyrë efektive dhe të menjëhershme proceset, duke shkelur nenin 8.

Neni 6

Kërkesa e kërkuesit lidhur me nenin 6 për tejzgjatjen e procesit, u hodh poshtë për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore.

Neni 41

Gjykata konkludoi se Sllovenia duhej t'i paguante kërkuesit 7,500 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 3,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

RASTI B***Urdhëri për kujdestari urgjente për fëmijën e sapo lindur përbënte shkelje të së drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës familjare sipas nenit 8*****VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN K. DHE T. K.****FINLANDËS****(Kërkesa nr. 25702/94)****12 Korrik 2001****1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, një mama dhe bashkëjetuesi i saj T., janë shtetas finlandez. K. ishte nëna e katër fëmijëve dhe T. është babai i dy prej tyre.

Kërkuesja K. ishte shtruar në spital në disa raste, pasi u diagnostikua me skizofreni. Në Maj të vitit 1993, kur ajo ishte duke pritur fëmijën e saj të tretë J., Bordi i Mirëqenies Sociale, duke pasur parasysh se K. nuk ishte në gjendje për t'u kujdesur për fëmijën e saj të dytë M., e vendosi këtë të fundit në një shtëpi për fëmijë, si një masë mbrojtjeje afatshkurtër me pëlqimin e kërkuesve. Sapo fëmija i tretë lindi në Qershor të vitit 1993, J. ishte vendosur në përkujdesje në repartin e fëmijëve të spitalit, në bazë të një urdhëri urgjent, duke pasur parasysh gjendjen e paqëndrueshme mendore të K. dhe vështirësitë e familjes. Në një urdhër tjetër urgjent, i lëshuar disa ditë më vonë, edhe fëmija i dytë M. ishte vendosur në përkujdesje.

Kërkueses K. iu ndalua takimi me fëmijët pa mbikëqyrje. Ajo u shtrua përsëri në spital për shkak të psikozës. Urdhrat për kujdestari urgjente u zëvendësuan me urdhër të kujdestarisë në Korrik të vitit 1993. Këto urdhëra u konfirmuan nga Gjykata Administrative e Qarkut. Gjykata e Lartë Administrative e refuzoi ankimin e kërkuesve.

Në Shtator të vitit 1993 kufizimi i kontaktit u zgjat dhe në 1994, fëmijët u vendosën në një familje strehuese rreth 120 kilometra larg kërkuesve. Punonjësit e mirëqenies sociale thuhet se u kanë thënë kërkuesve dhe familjes strehuese se vendosja e fëmijëve aty do të zgjaste me vite. Kërkuesit propozuan, që marrëveshjet mes tyre dhe familjes strehuese të bëheshin në shtëpinë e të afërmeve dhe se në çdo rast duhet të synonin ribashkimin e familjes. Në Maj të vitit 1994 kontakti i kërkuesve me fëmijët e tyre ishte i kufizuar në një vizitë në muaj, e cila duhet të kryhej nën mbikëqyrje në familjen strehuese. Në Dhjetor të vitit 1994, drejtori i qendrës sociale informoi kërkuesit se nuk kishte më arsye për t'ju kufizuar kontaktin me fëmijët. Megjithatë, Bordi i Mirëqenies Sociale autorizoi vetëm takime të mbikëqyrura me fëmijët një herë në muaj. Bordi e konfirmoi këtë vendim në Janar të vitit 1995 dhe ankimi i kërkuesve u rrëzua.

Ndërkohë, në Maj 1994, kërkuesit kishin kërkuar revokimin e urdhrave të kujdestarisë. Kjo kërkesë u refuzua nga Bordi i Mirëqenies Sociale në Mars të vitit 1995. Në Prill të vitit 1995, K. lindi fëmijën e katërt, i cili nuk u vendos në kujdes alternativ. Pak kohë më pas K. u dërgua përsëri në kujdes të detyrueshëm psikiatrik për gjashtë javë, për shkak të problemeve me skizofreninë.

Plani i kujdesit social u rishikua përsëri në Maj 1996 dhe në Prill 1997, por kufizimi i kontaktit së kërkuesve me fëmijët e tyre vazhdoi. Në Dhjetor 1998, autoritetet sociale konsideronin se ribashkimi i familjes nuk ishte një mundësi. Në Nëntor të vitit 2000 kërkuesit dhe fëmijët u lejuan të takoheshin një herë në muaj pa mbikëqyrje. Këto kufizime mbetën në fuqi deri në fund të vitit 2001.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Në vendimin e datës 27 Prill 2000 dhënë nga Dhoma, Gjykata vendosi që në çështjen e cila ishte objekt gjykimi, nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me vendosjen e fëmijëve në kujdes alternativ dhe refuzimin për ta ndryshuar këtë vendim. Gjithashtu, Dhoma vlerësoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 13. Çështja u referua me kërkesë të qeverisë pranë Dhomës së Madhe në kuadër të nenit 43 të Konventës.

Kërkuesit u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për një jetë të qetë familjare garantuar nga neni 8, në lidhje me faktin se fëmijët e tyre J. dhe M. ishin vendosur në kujdes alternativ. Ata u ankuan gjithashtu se nuk kishin pasur në dispozicion një mjet ligjor efektiv, e drejtë kjo e garantuar me nenin 13.

Neni 8

Së pari, Gjykata konstatoi se ngjarjet përbënin një ndërhyrje në jetën familjare që ekzistonte mes kërkuesve dhe fëmijëve të tyre brenda kuptimit të nenit 8 dhe 1 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar sipas nenit 8 dhe 2.

Urdhërat për kujdestari urgjente

Gjykata pranoi se kur nxirret një urdhër për kujdestari urgjente nuk ishte gjithmonë e mundur që, për shkak të karakterit urgjent të situatës, të merrnin pjesë në procesin vendimmarrës edhe personat që kishin kujdestarinë e fëmijës. Për më tepër, kjo nuk ishte e mundur sepse këta persona shiheshin si burim kërcënimi ndaj fëmijës. Gjykata u bind gjithsesi me faktin që autoritetet finlandeze kishin të drejtë të vlerësonin që në lidhje me J. dhe me M. ekzistonin rrethana që justifikonin heqjen e kujdestarisë së kërkuesve pa një këshillim paraprak. Në mënyrë të veçantë, i takonte autoriteteve finlandeze të vendosnin që, përpara fillimit të zbatimit të çdo mase kujdestarie, ishte ndërmarrë një vlerësim i kujdesshëm i ndikimit të masës së kujdestarisë së propozuar ndaj kërkuesve dhe fëmijëve.

Gjykata e gjeti të arsyeshëm faktin se autoritetet kishin besuar, që paralajmërimi i K. për marrjen e fëmijëve nën kujdes urgjent mund të kishte pasojë të rrezikshme në dëm të vetë kërkueses por eventualisht dhe të fëmijëve të saj. Gjithashtu ishte i arsyeshëm vlerësimi i bërë nga ana e autoriteteve se T. nuk do të ishte i aftë të kujdesej njëherazi për K. e cila kishte probleme të shëndetit mendor dhe fëmijëve J. dhe M. As përfshirja vetëm e T. në procesin vendimmarrës nuk ishte një mundësi reale për autoritetet, duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë mes kërkuesve dhe gjasat për shkëmbim informacioni.

Megjithatë, marrja e një fëmije të sapo lindur në kujdes institucional në momentin e lindjes së tij ishte një masë tejet e rëndë. Duhej të ekzistonin arsye tepër të forta që një foshnje të mund të merret fizikisht nga kujdesi i nënës në kundërshtim me dëshirën e kësaj, menjëherë pas lindjes, si pasojë e një procedure në të cilën as ajo dhe as personi që bashkëjetonte me të nuk kishin marrë pjesë. Nuk doli që arsye të tilla të ekzistonin. Autoritetet ishin në dijeni për shtatzaninë e K. muaj më përpara si dhe për problemet mendore të saj, kështu që situata nuk ishte urgjente dhe e pa parashikueshme. Qeveria Finlandeze nuk kishte vlerësuar dhe as propozuar mundësi të tjera të mbrojtjes së J. nga rreziku i vuajtjeve fizike nga ana e K.-së. Kur merret një masë e tillë drastike e cila menjëherë e privon një nënë nga fëmija i saj i sapo lindur, autoritetet shtetërore kanë për detyrë që të shqyrtojnë nëse janë të mundshme ndërhyrjet e një shkalle më të lehtë në jetën familjare në një moment kaq kritik të jetës së prindërve me fëmijët e tyre. Arsyet në të cilat u bazuan autoritetet ishin të rëndësishme por jo të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen e rëndë në jetën familjare të kërkuesve. Gjykata arriti në përfundimin se urdhrat për kujdestari urgjente në lidhje me J. dhe masat e marra nuk ishin në përputhje me qëllimin. Pra, megjithëse kishte pasur "nevojë" për të marrë masa paraprake për të mbrojtur J., ndërhyrja në jetën familjare të kërkuesve nuk mund të shihej sikur kishte qenë "e nevojshme" në një shoqëri demokratike.

Vlerësime të ndryshme u bënë në lidhje me M. Autoritetet kishin të drejtë të ishin të shqetësuara në lidhje me aftësinë e K., e ndihmuar nga T., që të vazhdonte të kujdesej për familjen e saj në një mënyrë normale edhe pas lindjes së fëmijës së saj të tretë. M. po tregonte shenja shqetësimi dhe kështu kishte nevojë për një kujdes të veçantë. Urdhërat urgjent të kujdestarisë në lidhje me të nuk mund të kishin të njëjtat pasoja ndaj jetës familjare të kërkuesve si ato të marra në lidhje me J.. M. ishte veçuar fizikisht nga familja e tij si rezultat i vendosjes së tij vullnetare në një shtëpi fëmijësh. Mosmarrja pjesë e T. dhe K. në procesin e vendimmarrjes ishte e kuptueshme përpara ngjarjes stresuese të lindjes së J.. Autoritetet shtetërore kishin të drejtë pra ta konsideronin të nevojshme marrjen e masave të jashtëzakonshme, për një periudhë të kufizuar kohe, në interes të M.

Urdhërat mbi kujdestarinë

Duke pasur parasysh që detyra parësore e autoriteteve ishte mbrojtja e interesave të fëmijës, Gjykata nuk kishte arsye që të dyshonte që autoritetet ishin në gjendje që të mund të vlerësonin se vendosja e fëmijëve në kujdes institucional duke filluar nga 15 Korriku 1993 dhe në një familje strehuese që nga fillimi i vitit 1994 ishte më e preferueshme se sa vazhdimi i masave të kujdestarisë ose të masave të tjera të ngjashme. Nuk mund as të thuhet, nga ana tjetër, se urdhërat mbi kujdestarinë ishin vënë në zbatim me ndonjë nxitim të veçantë ose në një mënyrë jo të zakonshme. Për më tepër, kërkuesit kishin marrë pjesë në mënyrë të plotë në procesin e vendimmarrjes të urdhrave të kujdestarisë dhe në këtë mënyrë interesat e tyre ishin mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

Pretendimi për mos marrjen e masave të duhura për bashkimin e familjes

Gjykata kujtoi parimin themelor se kujdesi institucional i fëmijës duhet të shihet si një masë e përkohshme, që duhet të marrë fund sa më shpejt që këtë ta lejojnë rrethanat. Çdo masë që synon të vërë në zbatim një kujdes të tillë të përkohshëm duhet të jetë në përputhje me qëllimin final të ribashkimit me prindërit biologjik të fëmijës. Detyrimi për të marrë masa për ribashkimin familjar sa më shpejt që ky të jetë i mundur bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm me kohëzgjatjen e periudhës së kujdestarisë, me kusht që ky detyrim duhet të jetë në pajtim me interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata vuri në dukje se nuk ishin bërë vlerësime nëse kërkuesit do të ishin në gjendje të merreshin me J. dhe M.. Ato nuk arritën të bënin përpjekje serioze për të lehtësuar ribashkimin familjar. Pritshmëritë minimale do të ishin që autoritetet të analizonin situatën herë pas here, për të parë nëse ka pasur ndonjë përmirësim në situatën familjare. Mundësitë e ribashkimit zvogëlohen dhe eventualisht zhduken në qoftë se prindërit biologjikë dhe fëmijët e tyre nuk lejohen fare të takojnë njëri tjetrin, ose të takohen aq rrallë sa të mund të krijohet ndërmjet tyre një lidhje e natyrshme. Kufizimet dhe ndalimet e vendosura ndaj kërkuesve në lidhje me mundësinë për të takuar fëmijët, më tepër e penguan sesa e ndihmuan ribashkimin e mundshëm të familjes. Në këtë çështje, ishte vërtetë i çuditshëm qëndrimi jashtëzakonisht negativ nga ana e autoriteteve. Për këto arsye kishte një shkelje të nenit 8.

Kufizimet dhe ndalimet e takimeve

Për aq sa kërkesa në lidhje me kufizimet e takimeve mbulohej nga konstatimi i një shkeljeje të nenit 8 si rezultat i mos marrjes së hapave të mjaftueshëm për ribashkimin e familjes së kërkuesve, nuk ishte e nevojshme për Gjykatën që të shqyrtonte masat e kundërshtuara si një burim i një shkeljeje më vete. Duke pasur parasysh situatën konkrete, përfshirë edhe periudhën pas dhënies së vendimit fillestar të Gjykatës (nga Dhoma), Dhoma e Madhe arriti në të njëjtin përfundim si edhe Dhoma. Duke vlerësuar gjendjen e fëmijëve gjatë periudhës së fundit vlerësimi i autoriteteve në lidhje me nevojën e kufizimit të takimeve nuk përbënte shkelje të nenit 8 dhe 2.

Neni 13

Dhoma e Madhe nuk gjeti arsye të ndryshonte qëndrimin e Dhomës në lidhje me pretendimet për nenin 13.

Neni 41

Dhoma e Madhe mbajti të njëjtin qëndrim si Dhoma në lidhje me caktimin e dëmshpërblimit për dëmin jo material në vlerën 40,000156 FIM për secilin kërkues. Gjithashtu, Gjykata i caktoi atyre përpos vlerës për shpenzime gjyqësore nga Dhoma, shumën prej 5,190 FIM edhe 60,000 FIM për procesin përpara Dhomës së Madhe.

B) Agjenda

AGJENDA

Dita e tretë Moduli III	
09:00 – 09:15	Objektivat kryesore dhe rezultatet e pritura
09:30 – 10:30	Sistemi për mbrojtjen e fëmijës
10:30 – 11:30	Parakushtet dhe parimet për ndërtimin dhe integrimin e sistemit për mbrojtjen e fëmijës
11:00 – 12:00	Masat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijës
12:00 - 13:00	Dreka
13:00 – 13:45	Parandalimi, detyrimi ligjor për raportim dhe mbrojtja ligjore
13:45 – 14:15	Mbrojtja e fëmijës pa kujdes prindëror Format alternative për mbrojtjen e fëmijës pa kujdes prindëror
14:30 – 15:00	Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës
15:00 – 15:30	Raste studimi, punë në grupe
15:30 – 16:00	Reflektim dhe përmbyllja e ditës së tretë

MODULI IV:

MBROJTJA E FËMIJËS

PËRMBAJTJA

I. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTATET E PRITURA	92
KAPITULLI 1. MBROJTJA NË FAMILJE DHE KOMUNITET.....	93
1.1. E drejta për emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe identitet	93
1.2. Përgjegjësitë familjare, institucionale dhe individuale	95
1.3. Edukimi dhe arsimimi	99
1.4. Ndalimi i ndëshkimit trupor	101
1.5. E drejta për privatësi, kohë të lirë dhe lojë	103
1.6. Praktikat e dëmshme	105
1.7. Shëndeti	106
1.8. Mbrojtja nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara	109
1.9. Ndalimi i pjesëmarrjes në klube të natës dhe lojëra të fatit.....	111
1.10. Mbrojtja e fëmijës në masmedia	112
1.11. Mbrojtja e fëmijës me aftësi të kufizuara	114
1.12. Ndalimi i rrëmbimit, shitjes dhe trafikimit.....	117
1.13. Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës	118
KAPITULLI 2. MBROJTJA NGA SHFRYTËZIMI EKONOMIK	120
2.1. Parimet e punës	120
2.2. Moshë minimale për punësim	121
2.3. Puna e ndaluar	122
KAPITULLI 3. FORMAT SPECIFIKE TË MBROJTJES	125
3.1. Mbrojtja nga pornografia	125
3.2. Masat kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës	126
3.3. Kapaciteti i fëmijës për të ndërmarrë veprime ligjore	128
3.4. Drejtësia mike ndaj fëmijës	129
3.5. Ndihma juridike dhe qasja në organet e drejtësisë.....	131
3.6. Ndihma mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe reintegrimi	133
3.7. Personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës	134
3.8. Konfliktet e armatosura	135
3.9. Mbrojtja e fëmijës së zhvendosur brenda shtetit	136
IV. ANEKS.....	137
A) Rast studimi	137
B) Agjenda	140

I. OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivë kryesore e Modullit të Katërt (IV) është njohja e formave kryesore të mbrojtjes në familje dhe komunitet dhe format specifike të mbrojtjes.

Në fund të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë mbrojtjen e fëmijës në familje dhe komunitet;
- Të njohohen me përgjegjësinë familjare, komunitare dhe institucionale;
- T'i kuptojnë cilat janë format specifike të mbrojtjes;
- Zgjerojnë njohuritë për të drejtat dhe mbrojtjen e tyre;
- Identifikojnë dhe krahasojnë mbrojtjen edhe nga perspektiva e ligjeve tjera;
- Ngritja e aftësive analitike përmes studimit të rasteve praktike, etj.

KAPITULLI 1.

MBROJTJA NË FAMILJE DHE KOMUNITET

1.1. E drejta për emër, shtetësi, njohur prindërit dhe identitet

Lindja është momenti i parë kur fëmija fiton zotësinë juridike, respektivisht i fillojnë së njohuri të drejtat e caktuara me ligj. Njëra prej të drejtave kryesore është edhe e drejta për të pasur një emër dhe për tu regjistruar në regjistrin civil në Republikën e Kosovës. Regjistrimi i lindjes është një shënim i përhershëm dhe zyrtar i ekzistimit të një fëmije dhe ka rëndësi themelore për realizimin e të drejtave dhe nevojave praktike të fëmijës. Sigurimi i të drejtës së fëmijës për të pasur një emër dhe të regjistrohet nënkupton që fëmijës i sigurohet qasje në shërbime bazike, përfshirë këtu imunizimin (vaksinimin), kujdesin shëndetësor dhe regjistrimin në shkollë në moshën e duhur si dhe shërbime të tjera bazike. Pa emër dhe nënshtetësi të njohur fëmija nuk mund të dëshmojë moshën apo ekzistencën e tij.

Sikurse KDF edhe LMF garanton të drejtën e fëmijës për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre, si dhe të drejtën e regjistrimit për fëmijën pa marrë parasysh a ka lindur në Kosovë apo jo.

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.
2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetet pa shtetësi.

Neni 7, KDF

Përveç realizimit të të drejtave të tjera, regjistrimi i lindjes po ashtu është esencial për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë: parandalimin e punës së rëndë, sigurimin që fëmijët në konflikt me ligjin nuk trajtohen (juridikisht dhe praktikisht) si të rritur; parandalimin e shfrytëzimit për qëllime të trafikimit, ndihmën e fëmijëve të cilët janë riatdhesuar dhe ribashkuar me anëtarët e familjes, etj.

LMF, ka përcaktuar edhe ruajtjen e identitetit, përfshirë edhe përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare. Në rast se një fëmijë është privuar nga këto të drejta në mënyrë të paligjshme, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për të rikthyer identitetin, përfshirë garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësi që të praktikojë gjuhën dhe kulturën. Kjo ndihmë mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik:

- gjetjen e prindërve;
- gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
- regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:
 - 1.1. të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. të ketë një emër;
 - 1.3. të fitojë shtetësinë;
 - 1.4. të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesjen e plotë të prindërve.
2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.
3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:
 - 3.1. gjetjen e prindërve;
 - 3.2. gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
 - 3.3. regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.
4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, caktohet menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Kur fëmija braktiset nga prindi/ërit biologjik, apo deklarohet se do ta braktisin fëmijën, personeli social dhe mjekësor në maternitet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, brenda njëzet e katër (24) orëve, njofton me telefon dhe me shkrim Qendrën për Punë Sociale në komunën përkatëse.
7. Në rastet e braktisjes së fëmijëve nga prindër e panjohur në ambiente jashtë institucioneve shëndetësore, ku rrezikohet jeta dhe shëndeti i fëmijës, Qendra për Punë Sociale, në bashkëpunim me Policinë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.
8. Qendra për Punë Sociale, në cilësinë e organit të kujdestarisë i ndërmarr masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në vlerësimin e nevojave të fëmijës.
9. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, Qendra për Punë Sociale në komunën përkatëse, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes, këshillon prindin për rëndësinë e marrjes së fëmijës biologjik në përkujdesje prindërore, si dhe efektet ligjore në rast të braktisjes së

fëmijës Nëse pas hetimit të policisë nuk identifikohet nëna e fëmijës, zyrtari për mbrojtjen e fëmijës në komunën ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas paragrafit 6. të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

- 10.** *Të gjithë personat juridikë e fizikë, veçanërisht institucionet e kujdesit shëndetësor, shërbimit social, shërbimit rezidencialë, që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, të njoftojnë Qendrën për Punë Sociale në komunën ku veprojnë. Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me institucionet e tjera në komunë, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi.*

Neni 33 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Rëndësia e njohjes së prindërve nga fëmijët, është parashikuar gjithashtu në LMF, sepse jo çdo fëmijë mund të ketë rastin të njoh prindërit e tij në momentin e lindjes. Në praktikë ka raste të fëmijëve të braktisur ose prindërit e të cilëve nuk mund të identifikohen.

LMF duke njohur rëndësinë dhe rreziqet që i kanosen fëmijës pa identitet dhe kujdes prindëror, ka përcaktuar detyra dhe obligime për institucionet shëndetësore, atyre të shërbimeve sociale dhe policinë për t'i ofruar mbrojtje dhe kujdesin e nevojshëm fëmijës (shih paragrafet 5 - 10). Të gjitha këto institucione gjatë zbatimit të mandatit dhe obligimeve që dalin nga ky nen duhet të ndërmarrin masa për:

- Respektimin e interesit më të mirë të fëmijës;
- Veprimin me urgjencë;
- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve;
- Ofrimin e shërbimeve të bazuara në nevojat e fëmijës, etj.

REFERENCË:

Për të kuptuar në lidhje me kushtet dhe procedurat e regjistrimit të lindjes dhe fitimit të shtetësisë në Republikën e Kosovës ju lutem lexoni ligjet më poshtë:

1. Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile (kliko në këtë faqe interneti)
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2743>
2. Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës (kliko në këtë faqe interneti)
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8873>²⁴

1.2. Përgjegjësitë familjare, institucionale dhe individuale

Përgjegjësia primare e kujdesit, rritjes, mirëqenies, edukimit dhe mbrojtjes së fëmijës bie mbi prindin apo prindërit. Familja duhet të krijojë kushte dhe mundësi që fëmija të zhvillohet dhe rritet në një ambient të lumtur, ku dashuria dhe mirëkuptimi janë vlera mbizotëruese. Për më tepër fëmijës i duhet mbrojtur dhe respektuar dinjiteti, vlera dhe personaliteti në atë masë dhe mënyrë që nxitë arritjen e potencialit të plotë. Siç është cekur në modulën e parë, pikëpamjet dhe dëshirat duhet të merren në pajtim me moshën, pjekurinë dhe zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës.

²⁴ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

Nëpërmjet plotësimit të kushteve dhe respektimit të të drejtave të fëmijës, prindërit dhe kujdestarët sigurojnë që fëmija mos t'i ekspozohet rrethanave dhe situatave që e vënë fëmijën në rrezik. Ata, poashtu janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimit, abuzimit, keqtrajtimit dhe shfrytëzimit.

Përgjegjësia e kujdesit dhe mbështetjes së zhvillimit të fëmijës përveç e prindërve është edhe e anëtarëve të tjerë të familjes dhe kujdestarëve të caktuar. Të gjithë këta veç e veç apo së bashku janë të detyruar që fëmijës t'i:

- Ofrojnë këshilla, udhëzime dhe ndihmë me qëllim që të përgatitin atë për jetë të pavarur dhe të përgjegjshme në shoqëri;
- Marrin parasysh qëndrimet dhe dëshirat;
- Promovojnë të drejtat për shëndet, arsim, edukim, mirëqenie dhe pjesëmarrje;
- Mbrojnë të drejtat dhe interesat;
- Sigurojnë që fëmija mos të mbetet në asnjë rrethanë pa kujdesin prindëror apo kujdesin e kujdestarit.

1. *Familja, duke qenë njësi themelore e shoqërisë dhe mjedisit natyror, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës. Familja duhet të sigurojë që fëmija të rritet në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi e cila nxit zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.*
2. *Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestari duhet të mbrojnë jetën dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe të respektojnë dinjitetin, vlerat dhe personalitetin e fëmijës. Metodot e edukimit duhet të vlerësojnë dhe mbrojnë individualitetin e fëmijës, seksin, gjendjen shëndetësore, aftësitë e kufizuara dhe identitetin etnik, racial, fetar dhe kulturor të fëmijës. Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të merren parasysh në pajtim me moshën, pjekurinë dhe zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës për të formuar vendime që ndikojnë në jetën e tij.*
3. *Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestarët janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha aktet dhe situatat që e vënë fëmijën në rrezik, nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimit, abuzimit, keqtrajtimit, dhe shfrytëzimit.*
4. *Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestarët kanë për detyrë të:*
 - 4.1. *ofrojnë këshilla dhe udhëzime të mira, si dhe ndihmën për fëmijën në përputhje me zhvillimin e tij dhe ta përgatitin atë për një jetë të pavarur dhe të përgjegjshme në shoqëri;*
 - 4.2. *marrin parasysh qëndrimin e fëmijës dhe dëshirat e tij në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij;*
 - 4.3. *respektojnë dhe promovojnë të drejtën e fëmijës për shëndet, arsim dhe edukim, mirëqenie dhe pjesëmarrje;*
 - 4.4. *mbrojnë të drejtat dhe interesat e fëmijës të mbrojtur me ligj dhe Konventë, dhe;*
 - 4.5. *sigurojnë që në mungesë të përkohshme të prindit apo kujdestarit, fëmija duhet të ketë kujdesin adekuat nga personi i caktuar, nga prindi, kujdestari apo organi kompetent.*

Neni 34 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Duke parë rëndësinë primare dhe rolin jetik që ka familja (prindi, prindërit apo kujdestari) në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, KDF në disa nene (3, 5, 7, 9, 10, 18, 19, 20) ka paraparë rolin dhe përgjegjësinë e familjes (prindit dhe prindërve) kundrejt fëmijës, si dhe ka udhëzuar shtetet për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve legjislative, administrative dhe gjyqësore për sigurimin e mbrojtjes së fëmijës nga familja.

Prindërit ose kujdestari kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin ndihmë dhe mbështetje nga institucionet për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga LMF. Institucionet ndihmojnë familjen me këtë detyrim dhe ndërhyjnë vetëm kur familja nuk është në gjendje apo nuk është e aftë, ose ka nevojë për ndihmë për të mbrojtur fëmijën. Fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit apo kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç në rastet, kur ndarja është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe ndarja është e pashmangshme, dhe nëse ndarja kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë.

ME RËNDËSI:

Ndihma dhe mbështetja që i ofrohet prindërve ose kujdestarit nga ana e institucioneve nuk duhet të nënkuptojë zëvendësimin apo zbehjen e autoritetit që kanë prindërit apo kujdestari ndaj fëmijës. Sipas ligjit, institucionet duhet të kuptojnë dhe respektojnë përgjegjësinë primare dhe të pazëvendësueshme që kanë prindërit ndaj fëmijës.

Këtë parim e vërteton edhe paragrafi 4 i nenit 35 të LMF:

Vetëm kur masat mbështetëse të disponueshme për familjet sipas paragrafit (1) tregojnë se janë të pamjaftueshme për të parandaluar dhunën, shpërfilljen, neglizhimin, abuzimin, keqpërdorimin, shfrytëzimin ose kur fëmija është në rrezik të lartë, të pashmangshëm, institucionet janë përgjegjës për të ndërhyrë me masat e parashikuara nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës.

Ndihma dhe mbështetja duhet të ofrohen vetëm në ato situata dhe rrethana kur prindërit apo kujdestari nuk kanë mundësi të zbatojnë përgjegjësitë që i kanë sipas ligjit.

Paragrafi 3 i nenit 35, i paraprin paragrafit 4 të po këtij neni, ku përcaktohet përjashtimi nga parimet e cekura më lartë që fëmija duhet të rritet dhe zhvillohet pranë ambientit familjar. Sipas pjesës së parë të paragrafit 3 familja dështon të mbrojë osë e vë fëmijën në situata të rrezikut ...'**familja dështon të mbrojë ose e vë fëmijën në rrezik nga çdo formë e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimi, abuzimi, braktisja, shfrytëzimi ekonomik dhe të gjitha format e tjera të shfrytëzimit**', dhe pjesa e dytë e paragrafit parasheh situatën kur vetë ...'**prindi, kujdestari apo anëtarët e familjes**' janë vetë kryesit e veprës. Mjafton të plotësohet njëra pjesë e përgjegjësisë sipas paragrafit 3 që pastaj institucionet të ndërhyjnë në familje duke larguar fëmijën nga kujdesi i prindërve apo kujdestarit dhe duke e mbrojtur atë nëpërmjet kujdesit dhe mbrojtjes alternative.

- 1.** Prindërit ose kujdestari kanë të drejtë të marrin mbështetje nga institucionet për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen. Institucionet duhet të respektojnë përgjegjësinë kryesore të prindërve ose kujdestarëve për edukimin e fëmijës dhe marrëdhëniet midis fëmijës dhe prindërve ose kujdestarit të tij ligjor, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar dhe duke marrë parasysh zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës.
- 2.** Institucionet ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që prindërit ose kujdestari, që nuk kanë mundësi të kryerjes së përgjegjësisë të tyre, të marrin ndihmën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë dhe sigurojnë infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme në këtë drejtim.
- 3.** Kur familja dështon të mbrojë ose e vë fëmijën në rrezik nga çdo formë e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimi, abuzimi, abuzimi seksual, keqtrajtimi, braktisja, shfrytëzimi ekonomik dhe të gjitha format e tjera të shfrytëzimit, nga prindërit, anëtarët e tjerë të

familjes dhe kujdestari, institucioni kompetent komunal është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës dhe sigurimin e kujdesit të duhur alternativ ose përkujdesje të përhershme ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Vetëm kur masat mbështetëse të disponueshme për familjet sipas paragrafit (1) tregojnë se janë të pamjaftueshme për të parandaluar dhunën, shpërfilljen, neglizhimin, abuzimin, keqpërdorimin, shfrytëzimin ose kur fëmija është në rrezik të lartë, të pashmangshëm, institucionet janë përgjegjës për të ndërhyrë me masat e parashikuara nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës.

Neni 35 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Pjesa e fundit e këtij nënkapitulli ndërlidhet me nenet 35 dhe 36 dhe parasheh përgjegjësinë e çdo personi qoftë **fizik apo juridik**, kur me **veprimet apo mosveprimet e tij**, ka bërë shkeljen. Është me rëndësi të kuptohet që përgjegjësia përcaktohet jo vetëm me dispozitat e LMF, por edhe me legjislacionin relevant.

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit relevant, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen.

Neni 36 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF, në kuadër të përkufizimeve ka definuar situatat dhe rrethanat kur një shkelje kryhet me veprim ose mosveprim. Në vijim janë paraqitur disa nga përkufizimet e LMF:

SHEMBUJ:

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo **veprim** ose **mosveprim** me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Dhunë fizike - nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytit dhe çdo **veprim** tjetër që shkakton dhimbje fizike.

Neglizhimi i fëmijës - nënkupton **mosveprimin** me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

Abuzim - nënkupton çdo **veprim** apo **mosveprim**, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoritetit që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës.

Të gjitha shkeljet që bëhen në kuptim dhe kundrejt të drejtave të fëmijës bëhen ose me veprim ose me mosveprim.

1.3. Edukimi dhe arsimimi

LMF në fillim të nenit për edukimin dhe arsimimin, vë theksin mbi rëndësinë e fëmijës për edukim dhe arsim, andaj edhe ka ndaluar që fëmija të privohet nga kjo e drejtë. Pas ndalesës së privimit, vjen dispozita tjetër e cila e detyron Ministrinë përkatëse për Arsim dhe autoritetet në nivel lokal për sigurimin e arsimit dhe edukimit gjithëpërfshirës, falas dhe cilësorë. Kështu, vetëm zbatohet dhe konfirmohet një e drejtë që e ka paraparë Kushtetuta në nenin 47 (e drejta për arsimin), si dhe KDF në nenet 28 (e drejta për arsim) dhe 29 (edukimi).

Institucionet arsimore kanë një detyrim që t'i bëjnë shkollat dhe institucionet e tjera edukative "atraktive dhe të sigurta" për fëmijët, nxënësit dhe mësimdhënësit, edukatorët, me qëllim që të gjithë këta të jenë të mbrojtur nga të gjitha *'format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, neglizhenca, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin'*. Mbrojtja e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, vlen për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, dhe krijon detyrime si për personelin arsimor, e poashtu edhe për bashkëmohatarët dhe çdo person brenda sistemit arsimor.

Përveç ministrisë dhe autoriteteve në nivel lokal, edhe prindërit ose kujdestarët kanë obligim që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit. Për më tepër ata duhet të jenë edhe garantues që fëmija vijon shkollën në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa.

1. Ndalohet privimi i fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim.
2. Ministria përkatëse për arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar në gjitha nivelet e arsimit para universitar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.
3. Në të gjitha nivelet e arsimit para universitar, fëmija mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, neglizhenca, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Fëmija mbrohet nga dhuna e shfaqur qoftë nga personeli arsimor, bashkëmohatarët dhe nga secili person tjetër, brenda sistemit edukativ arsimor. Në procesin edukativ dhe arsimor, është e ndaluar të promovohet gjuha e urrejtjes, dhuna, jo toleranca, diskriminimi dhe format e tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore.
4. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.
5. Ministria përkatëse për arsim, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore nga pushteti lokal marrin masa konkrete, me qëllim që:
 - 5.1. të inkurajojë mësim-nxënien gjatë gjithë jetës, të zhvillojë respektin e fëmijës për identitetin kulturor, për gjuhën dhe vlerat kombëtare, respektin për kulturat e ndryshme si dhe respektin për ruajtjen e mjedisit;
 - 5.2. të mundësojnë qasjen e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por që kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

- 5.3. në bashkëpunim me institucionet relevante të zhvillojnë programe edukimi për prindër, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;
 - 5.4. të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrijnë nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim të parandalimit të barrierave për shkollimin e mëtejshëm të fëmijës;
 - 5.5. të identifikojnë dhe trajtojnë rastet e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën si dhe të ndërmarrin veprime konkrete sipas politikave nacionale për trajtimin e rasteve në nivel të shkollës dhe komunës;
 - 5.6. të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijë që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë shkollën apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;
 - 5.7. të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;
 - 5.8. të adresojnë parandalimin e përfshirjes të fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme, duke e trajtuar këtë tematikë me qasje kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare;
 - 5.9. sigurimi i mekanizmave efikas për parandalim, trajtim brenda shkollës dhe raportim tek autoritetet përgjegjëse të rasteve të dhunës dhe dukurive të tjera negative;
 - 5.10. të zbatojnë sanksione përkatëse ligjore për personelin e institucioneve edukativo- arsimore, në rast kur ushtron, lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme në institucionet edukativo-arsimore, sipas këtij ligji;
 - 5.11. të sigurojnë mbrojtjen e fëmijës në internet, duke promovuar përdorimin e teknologjisë informative të komunikimit, në mënyrë të dobishme dhe përgjegjshme;
 - 5.12. me anë të vetëdijesimit të adresohet parandalimi i trafikimit të fëmijëve, me qasje proaktive të trajtohet fëmija në rrezik për tu trafikuar;
 - 5.13. në plan-programet mësimore të përfshijë module për mbrojtje nga rreziku i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në institucionet e arsimit para universitar dhe arsimit të lartë;
 - 5.14. ministria përkatëse për arsim shkencë dhe teknologji të garantojë vijueshmërinë në institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm për fëmijët e familjeve që gjenden në hasmëri.
- 6.** Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk vijojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mos regjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës në kuadër të drejtorisë përkatëse në komunë ndërmerr masa të menjëhershme për regjistrimin e fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.
 - 7.** Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji.

Në paragrafin 5, nëpërmjet 14 pikave janë përcaktuar detyrat shtesë për Ministrinë përkatëse për Arsim dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit, të cilat ngarkohen për të ndërmarrë masa konkrete me qëllim të sigurimit të cilësisë, vijueshmërisë por mbi të gjitha të zbatimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës të cilat janë të parapara në LMF por edhe ligjet e tjera, e me theks të veçantë për:

- Inkurajimin e mësim nxënies dhe zhvillimit të fëmijës;
- Qasjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim dhe procese edukative të gjithë fëmijëve;
- Përfshirjen e prindërve në programet për vetëdijesim për parandalimin e dhunës në familje;
- Eliminimin e barrierave për arritjet e fëmijës;
- Parandalimin dhe luftimin e fenomenit të braktisjes së shkollës, si dhe integrimin e atyre që kanë braktisur shkollën;
- Pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete çlodhëse, kulturore dhe artistike;
- Parandalimin e pjesëmarrjes së fëmijës në punë të rënda;
- Parandalimin e dhunës në shkolla;
- Sanksionimin e personelit arsimor;
- Mbrojtjen e fëmijës në internet;
- Vetëdijesimin dhe parandalimin e trafikimit me fëmijë;
- Përfshirjen e moduleve në plan programe mësimore për mbrojtjen e fëmijës nga rreziku i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual;
- Sigurimin e vijueshmërisë në shkolla të fëmijëve, familjet e të cilëve janë në hasmëri.

Në këtë nen mbrohet dhe i sigurohet arsimimi edhe fëmijës i cili për shkak të mos regjistrimit në regjistrat civil nuk ka mundur të realizojë këtë të drejtë.

Mësimdhënësit dhe personeli arsimor duhet t'i informojnë fëmijët për të drejtat e tyre, mjetet apo mekanizmat për ushtrimin e të drejtave të tyre sipas LMF.

REFERENCË:

Për të kuptuar më tepër rreth të drejtave të fëmijës për arsim dhe edukim, ju lutem klikoni dhe lexoni ligjet më relevante në fushën e arsimit:

Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2401>

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Ndërsa rreth institucioneve dhe mekanizmave për ushtrimin e të drejtave nga ana e fëmijës apo prindërve/kujdestareve të tyre, kthehuni dhe lexoni Modulin e Dytë (II).

1.4. Ndalimi i ndëshkimit trupor

Ndëshkimi trupor apo siç njihet në nivel global si **'corporal punishment'** është një ndëshkim i cili shkakton dhimbje dhe shqetësim për fëmijën.

Ky dënim është përdorur historikisht në shkolla, në shtëpi dhe në komunitet, dhe fatkeqësisht ai akoma është prezent. Sipas studimeve të fundit ai është duke u përdorur në nivele mjaft shqetësuese. Sipas të dhënave të MICS 2020 'Përderisa 24 për qind e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç në Kosovë kanë përjetuar vetëm metoda të disiplin-

imit jo të dhunshëm, një pjesë e madhe e fëmijëve (72 për qind) kanë përjetuar çfarëdo lloj të disiplinimit të dhunshëm²⁵.

Nisur nga fakti që ndëshkimi trupor përdoret akoma si formë disiplinimi dhe ndëshkimi për fëmijën, LMF në kuadër të përkufizimeve ka përcaktuar elementet të cilat në detaje e përshkruajnë ndëshkimin trupor.

Ndëshkim trupor²⁶ – nënkupton çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim te fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma, të tilla, si: rrahje, tortura, shkundje, shtytje, djegie, goditje, pickim, çjerrje, kafshim, qortim i rreptë.

Për më tepër neni 38, taksativisht ndalon ndëshkimin trupor dhe masat e disiplinimit të fëmijës. Fillimisht në paragrafin 1, e ndalon atë në të gjitha ambientet, në shtëpi dhe familje, institucione edukativo arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitet. Ndërsa në paragrafin 2, ndalon ndëshkimin trupor të kryer nga çdo person.

Duke njohur faktin që ndëshkimi trupor si mjet disiplinimi përdoret në masë të madhe edhe në institucionet arsimore dhe nga personeli arsimor, në paragrafet 3, 4 dhe 5 janë përcaktuar ndalesat në sistemin arsimor për të përdorur ndëshkimin trupor si mjet disiplinimi, si dhe janë përcaktuar detyrimet dhe masat që duhet ndër-marrë ndaj personelit arsimor dhe jo arsimor në rast të shkeljes së ligjit në këtë aspekt.

- 1.** *Ndëshkimi trupor dhe masat disiplinore, të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjellje që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, janë të ndaluara në secilin ambient në shtëpi dhe familje, institucione edukativo arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitet.*
- 2.** *Është e ndaluar që një fëmijë të kthehet në subjekt të torturës dhe trajtimit jo njerëzor, jo dinjitoz, ndëshkimit trupor dhe trajtimit degradues nga secili person.*
- 3.** *Personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën nuk duhet të përdorin ndëshkimin trupor si mjet discipline dhe rregulli duhet të bazohet dhe ndërtohet mbi bazën e respektit dhe drejtësisë.*
- 4.** *Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Inspektorati i Arsimit merr masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi.*
- 5.** *Ministritë përkatëse sigurojnë nxjerrjen dhe krijimin e programeve të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe të hartojnë dhe krijojnë:*
 - 5.1.** *edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor.*
 - 5.2.** *Programe prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në institucione të kujdesit.*

Neni 38 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

²⁵ Anketa e treguesve të shumëfishtë MICS, 2019 - 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës https://ask.rks-gov.net/media/5740/3-alb-mics6kos-statistical-snapshot-child-discipline-20201015_20201119.pdf (Klikuar me datë 30.08.2022).

²⁶ Neni 3, par.1 pika 1.26, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084).

KDF në komentarin e përgjithshëm numër 8 në lidhje me ndëshkimin trupor²⁷ thekson *'KDF dhe instrumentet e tjera të të drejtave të njeriut e njohin të drejtën e fëmijës për të drejtën e tij njerëzore dhe integritetin fizik dhe mbrojtjen e barabartë para ligjit. Komiteti ka lëshuar këtë komentar të përgjithshëm për të theksuar obligimet e shteteve anëtare për të lëvizur shpejt drejt eliminimit të ndëshkimit trupor dhe të gjitha formave tjera të ndëshkimit mizor dhe degradues të fëmijës, si dhe për të hartuar legjislacionin dhe forma të tjera të ngritjes së vetëdijes dhe masave edukuese që shtetet duhet ti ndërmarrin'*.

Komiteti, duke u nisur nga fakti që ndëshkimi trupor është një fenomen i përhapur në shumicën e shteteve anëtare, në vazhdim të këtij komentari në pikën 3, u bën thirrje shteteve anëtare që të *'adresojnë eliminimin e ndëshkimit trupor ndaj fëmijës, i cili është i pranuar, gjerësisht i përhapur dhe i toleruar në familje, shkollë dhe ambiente tjera, dhe kjo nuk është vetëm një obligim i shteteve anëtare sipas konventës, mirëpo kjo është edhe një strategji kyçe për të parandaluar të gjitha format e dhunës në shoqëri'*.

Pra sipas KDF, me eliminimin e ndëshkimit trupor nuk përfitojnë vetëm fëmija dhe familja, por përfitojnë edhe shoqëria dhe shteti. Kjo për faktin se sa më pak raste të ndëshkimit trupor të fëmijëve që kemi, aq më pak raste të dhunës në familje dhe shoqëri do të ndodhin.

1.5. E drejta për privatësi, kohë të lirë dhe lojë

E drejta për privatësi, përkundër që në teori promovohet jashtëzakonisht shumë, ajo në praktikë lë për të dëshiruar. Privatësia si term edhe pse përdoret në komunikimin e përditshëm qoftë nga madhorët apo fëmijët, në esencë nuk kuptohet si duhet apo edhe keqpërdoret për interesa dhe qëllime të caktuara. LMF, përveç që ka garantuar të drejtën e fëmijës për privatësi, ka sqaruar më tej mbrojtjen e privatësisë, duke përcaktuar si pjesë të privatësisë:

- Jetën e fëmijës
- Familjen e fëmijës
- Banesën apo vendin ku jeton
- Korrespondencën (komunikimin qoftë elektronik apo edhe fizik).

Privatësia e fëmijës duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare dhe të kundërligjshme që prekin moralin dhe dinjitetin e fëmijës.

E drejta për privatësi është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila në nenin 36 ka garantuar këtë të drejtë për çdo person në Republikën e Kosovës: *'Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera'*.

MBROJTJA NËPËRMJET SANKSIONIT PENAL:

Mbrojtja e privatësisë së fëmijës nga ndërhyrjet të cilat prekin moralin dhe dinjitetin e tij, bëhet edhe nëpërmjet Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku në nenin 202 (Fotografimi dhe incizimet e tjera të pautorizuara), parasheh si vepër penale cenimin e privatësisë:

'Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka prirje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet'.

²⁷ Shih pika 2, Komentari i përgjithshëm nr.8 (2006). Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Sesioni i dyzet e dytë, Gjenevë, 15 Maj - 2 Qershor 2006.

Për më tepër, LMF si pjesë të privatësisë ka paraparë edhe të drejtën e fëmijës për të pasur opinion, e cila lidhet me parimin kryesor për të shprehur pikëpamjet e tij (shih modulën e parë). Kjo e drejtë mbrohet dhe ndërlidhet me shprehjen e pikëpamjeve të fëmijës si brenda familjes ashtu edhe brenda institucioneve arsimore, shëndetësore, sociale, atyre të drejtësisë, etj. Ligji ka përcaktuar këto institucione, sepse në shumë raste, marrja dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale ndërlidhet edhe me informatat apo rrethanat që prekin edhe privatësinë e fëmijës.

1. *Fëmijës i garantohet e drejta për privatësi, respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin dhe dinjitetin e fëmijës.*
2. *Privatësia e fëmijës përfshin të drejtën e fëmijës për të pasur opinion dhe mbrohet në të gjitha situatat, brenda familjes dhe institucioneve shëndetësore, sociale dhe të shërbimeve.*
3. *Asnjë fëmijë nuk duhet të jetë subjekt i ndërhyrjeve të paligjshme ose arbitrare në jetën e tij private, në familje, në shtëpinë ose korrespondencën e tij, e as i cenimeve të nderit dhe reputacionit të tij.*
4. *Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.*
5. *Veprimet e tilla dënohen sipas legjislacionit në fuqi.*

Neni 39 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Fëmijës i mbrohet privatësia dhe jeta private edhe në proceset gjyqësore dhe administrative. Kjo mbrojtje përfshin të gjitha fazat e procedurës që zhvillohen pa prezencën e publikut dhe gjithashtu edhe mbrojtjen nga publikimi në media.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur në nenin 111 ka përcaktuar mbrojtjen e jetës private dhe standardeve ku fëmija është viktimë dhe dëshmitarë *'Ndërhyrja në jetën private të fëmijës kufizohet në minimumin e nevojshëm, siç përcaktohet në ligj, me qëllim sigurimin e standardeve të larta të dhënies së dëshmisë dhe një rezultat objektiv dhe të paanshëm të procedurave'*. Duke përcaktuar më tej në nenin 115 edhe përgjegjësinë e personave që punojnë me fëmijët viktimë dhe dëshmitarë për të mbajtur të fshehtë të gjithë informacionin për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë: *'Përveç mbrojtjes ekzistuese ligjore për jetën private të fëmijëve viktimë apo dëshmitar, me përjashtim të nenit 12 paragrafin 3. të këtij kapitulli të gjithë personat që punojnë me fëmijën viktimë apo dëshmitar, mbajnë të fshehtë të gjithë informacionin për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, që mund ta kenë marrë gjatë kryerjes së detyrës së tyre'*.

Neni 40 i LMF, përfshin brenda tij disa të drejta të ndryshme *'të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën zhvillimin fizik dhe mendor'*, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e plotë të fëmijës.

Pjesa e dytë e paragrafit përfshin përkrahjen e pjesëmarrjes së lirë të fëmijës në aktivitete kulturore, sportive dhe artistike. E drejta për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore, sportive dhe artistike përfshin të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë si në aktivitetet kulturore, sportive dhe artistike të të rriturve, ashtu edhe në aktivitetet e tyre fëmijërore. Me qëllim përkrahjen dhe inkurajimin e mundësive të tilla për fëmijën, institucionet brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e hapësirave të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për realizimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Masat e ndërmarra

me theks të veçantë duhet të mundësojnë dhe përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e cenueshëm dhe fëmijët që jetojnë në varfëri.

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe fëmijëve të cilëve i'u është kufizuar liria duke u vendosur në institucione të ndryshme, të tilla si institucionet korrektuese ose ambientet spitalore.

Ndërsa në pjesën e fundit të paragrafit 2, ka krijuar detyrimin për institucionet qendrore dhe lokale që të ndër marrin masa të cilat përfshijnë:

- Miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes lokale për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe qasje të sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;
- Vendosjen e standardeve të sigurisë dhe qasje për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;
- Krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare;
- Hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

1.6. Praktikrat e dëmshme

Edhe pse në kontekstin kulturor dhe të traditave në Kosovë, nuk janë shumë aktuale dhe të shprehura praktikrat e dëmshme, LMF nëpërmjet nenit 41 ka përcaktuar në mënyrë shumë të përgjithshme se nga cilat praktika dhe rituale duhet të mbrohet fëmija. Praktika të dëmshme janë praktikrat sociale, kulturore, zakonore, ritualet dhe praktikrat që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, zhvillimin ose mirëqenien e fëmijës.

Edhe pse ligji nuk ka përkufizuar në detaje se cilat janë praktikrat e dëmshme apo siç njihen globalisht si **'harmful practices'**, profesionistët duhet të udhëhiqen nga parimi i interesit më të mirë të fëmijës, për të caktuar se në cilat situata apo rrethana një praktikë, zakon apo 'adet' siç njihet në popull mund të konsiderohet si e dëmshme për fëmijën.

Ky nen i LMF, derivon nga e drejta e cila i garantohet fëmijës sipas KDF ku përcaktohet që: *'Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikrat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve'*.²⁸

²⁸ Neni 24 par.3 i KDF.

1. Fëmija mbrohet nga çdo praktikë sociale, kulturore, zakonore, rritet dhe praktikat të cilat dëmtojnë sigurinë, shëndetin, zhvillimin ose mirëqenien e fëmijës.
2. Në veçanti, ndalohen praktikat dhe zakonet diskriminuese ndaj fëmijës për shkak të gjinisë ose ndonjë statusi tjetër në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji.
3. Fëmija që ka përjetuar dhe kaluar nëpërmjet një praktike të dëmshme, do të ketë qasje të plotë dhe falas në shërbimet sociale, ligjore, shëndetësore dhe në të tjera shërbime të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
4. Njësia përkatëse për qeverisje të mirë, në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe organizatat e shoqërisë civile, në nivel lokal dhe qendror, për mbrojtjen e fëmijës realizon vlerësime, studime dhe programe ndërgjegjësimi për të ndikuar në reduktimin dhe zhdukjen e traditave dhe praktikave dëmtuese për fëmijët, si dhe promovimin e modeleve të shëndetshme dhe alternativave pozitive.

Neni 41 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

1.7. Shëndeti

Shëndeti dhe kujdesi shëndetësor paraqet një rëndësi prej të drejtave e cila mund të konsiderohet si një prej të drejtave që i garantohet fëmijës edhe para se të fitojë zotësinë e tij juridike, pra edhe para lindjes së tij. Kjo, për faktin që të gjitha veprimet që ndërmerren para dhe gjatë shtatzënisë (vetëdijesimi, kujdesi shëndetësor i nënës shtatzënë, ushqyeshmëria, etj.), konsiderohen që janë pjesë e ofrimit të kujdesit dhe mbrojtjes së shëndetit që një fëmijë të lindë i gjallë dhe me shëndet të plotë. Pra, shëndeti dhe kujdesi shëndetësor është i dyfishtë, para dhe pas lindjes së fëmijës. Mbrojtja gjatë këtyre dy fazave, kontribuon në arritjen e mbijetesës, zhvillimit dhe arritjen e potencialit të plotë të fëmijës.

Shëndeti i fëmijës duhet mbrojtur nëpërmjet parimeve kryesore të përcaktuara në KDF dhe LMF, si dhe perspektivës të bazuar mbi të drejtat e tjera të fëmijës që janë të ndërlidhura, veçanërisht të drejtës themelore për të jetuar, rritur dhe zhvilluar.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës në nenin 6 përcakton “se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar” dhe se “shtetet duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës”. Duke komentuar dhe ofruar sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë nen, KDF, thekson që “Neni 6 përcakton të drejtën e fëmijës për jetë dhe obligimin e shtetit për të siguruar në maksimumim e mundshëm mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës”. Shtetet palë duhet nxituar për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të **përmirësuar kujdesin para lindjes për nënat dhe bebet, ulur vdekshmërinë e foshnjave dhe fëmijëve, si dhe krijimin e kushteve që promovojnë mirëqenien e fëmijëve** përgjatë kësaj faze kritike të jetës së tyre. **Kequshqyerja dhe sëmundjet e parandalueshme** vazhdojnë të jenë pengesat më të mëdha për realizimin e të drejtave të fëmijës gjatë fëmijërisë së hershme. **Sigurimi i mbijetesës dhe shëndetit fizik janë prioritetet**, mirëpo shteteve palë iu bëhet me dije që neni 6 përfshin të gjitha aspektet e zhvillimit, sepse shëndeti dhe mirëqenia psikosociale e fëmijës të porsalindur në shumë aspekte janë të ndërlidhura. Të dyja këto mund të vihen në rrezik nga kushtet jo të favorshme të jetës, neglizhimi, trajtimi shpërfillës dhe abuziv dhe kufizimet për realizimin e potencialit njerëzor. Fëmijët e vegjël që rriten në kushte specifike kërkojnë një vëmendje të veçantë. Komiteti i kujton shteteve palë që e drejta për mbijetesë dhe zhvillim mund të zbatohet vetëm në mënyrë gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zbatimit të të gjitha dispozitave tjera të Konventës, e që përfshin të drejtën për jetë, ushqyeshmëri, siguri sociale, standard të jetesës,

ambient të sigurt dhe të shëndetshëm, edukim dhe lojë (neneve 24, 27, 28, 29 dhe 31), si dhe nëpërmjet respektimit të përgjegjësive të prindërve dhe ofrimit të asistencës për shërbime cilësore (nenet 5 dhe 18). Nga mosha e re, fëmija duhet vetë të përfshihet në aktivitete që promovojnë stilin e jetës së shëndetshëm dhe parandalimin e sëmundjeve. Dukë marrë për bazë rëndësinë e jashtëzakonshme që ka shëndeti në jetën dhe zhvillimin e fëmijës, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, në mënyrë shumë të detajuar ka rregulluar këtë të drejtë duke përcaktuar standarde dhe parime, në bazë të të cilave shtetet duhet t'i sigurojnë fëmijëve shëndetin dhe të drejtat që ndërlidhen me të 'Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor'.

Ligji nr. 04/I-125 për Shëndetësi

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

Ligji nr. 02/I-78 për Shëndetësi Publike

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2573>

Ligji nr. 02/I-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2587>

Ligji Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2454>

Në Republikën e Kosovës janë një mori ligjesh nëpërmjet të cilave garantohet e drejta për shëndet dhe kujdes shëndetësor:

Mbrojtjen e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor, LMF e fillon duke garantuar kujdesin shëndetësor falas, që është i bazuar në qasjen gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, si dhe më tutje përcakton që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet për asnjë arsye. Duke vazhduar më pastaj me paragrafin 2 të këtij nenit 42 ku i përcaktohen detyrimet Ministrisë së Shëndetësisë për të ndërmarrë një mori të masave të cilat janë të listuara nga pika 2.1 deri në pikën 2.10.

Ndërsa në paragrafin 3 përcaktohet detyrimi i prindërve që të kërkojnë kujdesin shëndetësor me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor dhe të parandalojë situatat të cilat rrezikojnë jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas, përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit me standard të lartë. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile, apo për çfarëdo arsye tjetër.
2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa:
 - 2.1. për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;
 - 2.2. për t'i siguruar fëmijës kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
 - 2.3. për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, duke marrë masa për sigurinë e produkteve ushqimore, ujë të pastër dhe duke marrë parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
 - 2.4. për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
 - 2.5. për të mundësuar, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsim, që të gjitha grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit, si dhe parandalimin e aksidenteve;
 - 2.6. për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues që siguron zhvillim optimal të fëmijës, këshillimin e prindërve dhe fëmijës, edukimin dhe shërbimet në fushën e shëndetit riprodhues për prindërit dhe fëmijët, në varësi të moshës dhe aftësisë së tyre për të kuptuar;
 - 2.7. për verifikimin periodik të trajtimit që i bëhet fëmijës së vendosur në institucione të kujdesit shëndetësor ose në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, me vendim të gjykatës;
 - 2.8. për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë dhe pas ekzaminimit mjekësor të fëmijës, ndaj palës së tretë, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet shëndeti ose jeta e fëmijës, sipas nenit 23 të këtij ligji;
 - 2.9. për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim riaftësimin, integrimin e barabartë në shoqëri;
 - 2.10. për identifikimin e hershëm të problemeve shëndetësore të fëmijëve përmes vizitave në shtëpi dhe referimin e tyre në sektorët e tjerë përkatës për trajtim ndër sektorial.
3. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.
4. Vizitat e rregullta në shtëpi për gruan shtatzënë dhe fëmijë deri në moshën 3 (tre) vjeç janë të detyrueshme. Ato kryhen sipas standardeve të këtyre vizitave dhe realizohen në kuadër të pakos bazike të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor. Vizitat në shtëpi kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke përfshirë këshillimin për mirërritjen e fëmijës, parandalimin dhe shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës.

Në paragrafin e fundit të nenit 42, parashihet programi i ashtuquajtur **'vizitat në shtëpi'** për gruan shtatzënë dhe fëmijën deri në 3 vjet. Ky program zbaton në praktikë mbrojtjen, sepse me veprimet të cilat ndërmerren në kuadër të këtij programi synohet mbrojtja e shëndetit të nënës dhe fëmijës nëpërmjet këshillimit për mirërritjen e fëmijës, pastaj parandalohet dhe shmanget braktisja, abuzimi, shfrytëzimi, neglizhimi dhe çdo lloj tjetër i dhunës, dhe mbi të gjitha bëhet identifikimi dhe raportimi i rasteve të dhunës apo formave tjera të ndërlidhura.

1.8. Mbrojtja nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara

Neni 43 ka përcaktuar mbrojtjen e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara siç janë:

- Narkotikët;
- Alkooli;
- Duhani;
- Produktet toksike;
- Substancat psikotrope; dhe
- Substancat e tjera që janë të deklaruara si të dëmshme nga autoritetet përkatëse.

Ndalesa është obligim për çdo person apo operator ekonomik, dhe përfshin **shitjen** dhe **shërbimin** e fëmijës me të gjitha produktet e listuara më lart. Në të kundërtën, mund të bini në ndesh me Kodin Penal:

MBROJTJA NËPËRMJET SANKSIONIT PENAL:

1. Kushdo që në lokalin hotelier, në bar apo në ndonjë dyqan tjetër ku shiten pije alkoolike, i shërben, i shet apo i vë në dispozicion pije alkoolike personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.

Neni 266, Shërbimi me pije alkoolike i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet
Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Përveç shitjes dhe shërbimit, ndalohet edhe përdorimi apo angazhimi i fëmijës në prodhim, shpërndarje apo trafikim me substancat e ndaluara. Për mos zbatimin e kësaj ndalese, mund të shqiptohen sanksionet penale sipas Kodit Penal:

MBROJTJA NËPËRMJET SANKSIONIT PENAL:

- Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge (shih paragrafet 1 deri 5)
- Neni 268 Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (shih paragrafet 1 deri 5)
- Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge (shih paragrafet 1 deri 3)
- Neni 270 Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope
- Neni 271 Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge (shih paragrafet 1 dhe 2)
- Neni 275 Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull (shih par.1 pikat 1.4 dhe 1.7)
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës

1. Fëmija duhet të mbrohet nga përdorimi i substancave narkotike, alkoolit, produkteve të duhanit, produkteve toksike, substancave psikotrope dhe substancave të tjera që janë të deklaruara të dëmshme nga autoritetet përkatëse.
2. Çdo personi dhe operatori ekonomik i ndalohet t'i shesë dhe t'i shërbej fëmijës deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, alkool, produkte të duhanit, produkte toksike, substanca psikotrope dhe substanca të tjera që janë të deklaruara të dëmshme nga autoritetet përkatëse, në të kundërtën do të dënohet sipas legjislacionit në fuqi.
3. Përdorimi ose angazhimi i fëmijës në prodhimin, shpërndarjen apo trafikimin e substancave të tilla, është i ndaluar dhe sanksionohet me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Masat e duhura mbrojtëse dhe parandaluese, përfshirë edhe avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim nga ministritë përkatëse për shëndetësinë.
5. Trajtimi i fëmijës që është i varur nga drogat dhe abuzimi me substanca të tjera narkotike duhet të ofrohet në një mjedis të mbyllur, vetëm si mjet i fundit dhe vetëm me pëlqimin e të përfaqësuesit ligjor apo përmes një urdhërese të gjykatës.

Neni 43 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF përmes këtij neni përveç masave dhe sanksioneve ka përcaktuar detyrimet për institucionet, familjen dhe komunitetin për të ndërmarrë masa parandaluese, qëllimi i të cilave është:

- Mbrojtja e fëmijës, nga shkaqet dhe rrethanat që mundësojnë përdorimin e narkotikëve, alkoolit dhe substancave të tjera të dëmshme;
- Ngritja e nivelit të njohurive dhe vetëdijesimit të fëmijës, familjes dhe komunitit për rrezikun e përdorimit të narkotikëve dhe alkoolit, dhe pasojat që sjell abuzimi me alkool dhe narkotikë për shoqërinë;
- Sigurimi i komunikimit efektiv për pasojat e dëmshme shëndetësore, natyrën e varësisë, kërcënimet vdekjeprurëse që paraqet konsumimi i substancave të dëmshme;

- Ofrimi i këshillave kundër përdorimit të substancave të dëmshme;
- Inkurajimi i ndërprerjes së përdorimit të substancave të dëmshme nga përdoruesit;
- Promovimi i një mënyre të shëndetshme të jetesës, etj.

Detajet rreth masave parandaluese si dhe mbrojtjen e fëmijës përfshirë edhe avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.

1.9. Ndalimi i pjesëmarrjes në klube të natës dhe lojëra të fatit

Mbrojtja e fëmijës në kontekst të kësaj tematike bëhet duke ndaluar hyrjen e fëmijës në të gjitha ambientet e klubeve të natës, qofshin ato brenda apo jashtë. Ndalesa zbatohet duke detyruar klubet e natës të ndërmarin masa të kontrollimit të moshës së pjesëmarrësve me qëllim ndalimin e hyrjes së fëmijës në ambientet e klubeve të natës.

Ndërsa sa i përket ndalesës së lojërave të fatit, këto në Republikën e Kosovës janë të ndaluara sipas Ligjit Nr. 06/L -155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, nëpërmjet të cilit është shfuqizuar Ligji Nr.04/L-080 për Lojërat e Fatit. Ndalesa vlen si për lojëra klasike ashtu edhe për lojërat e fatit të organizuara online.

Zbatimin e ndalesës, nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve e bëjnë institucionet në nivel qendror dhe lokal siç janë:

- Ministria përkatëse e Punëve të Brendshme dhe Policia;
- Ministria përkatëse e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Qendrat për Punë Sociale;
- Inspektoriatet përkatëse;
- Drejtoratet përkatëse komunale për Arsim;
- Mediat elektronike dhe të shkruara;
- Shkollat;
- Organizatat Jo Qeveritare.

1. *Ndalohet hyrja e fëmijës në klube të natës, lokalet e lojërave të fatit, qasja në lojërat e fatit online si dhe në qendrat argëtuese për të rritur dhe të ngjashme. Fëmijët nuk lejohen të shesin dhe të blejnë produkte të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre.*
2. *Organi përkatës komunal duhet t'ia imponojë kërkesën operatorit të ndonjë ngjarjeje publike për të kufizuar qasjen për fëmijën në përgjithësi, ose për fëmijën nën moshën e caktuar, nëse ngjarja ka mundësi të ndikojë negativisht në mirëqenien fizike ose psikologjike të fëmijëve.*
3. *Nëse fëmija është i pranishëm në një vend, siç është përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni, ofruesi i shërbimit për mbrojtjen e fëmijës duhet t'i kërkojë fëmijës që të largohet nga ai vend dhe ta trajtojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
4. *Masat e duhura parandaluese dhe mbrojtëse për ndalimin e fëmijës, sipas paragrafit 1. të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim nga Ministria përkatëse për Punë të Brendshme.*

Detajet rreth masave parandaluese si dhe mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet ndalimit të pjesëmarrjes së tij në klubet e natës, lojërat e fatit, qendrat argëtuese për madhorë dhe të ngjashme, rregullohen me Udhëzim Administrativ²⁹. Ky Udhëzim Administrativ përfshinë përcaktimin e ndalesave dhe veprimeve që kërkohen nga autoritetet në nivel qendror dhe lokal si dhe përgjegjësinë e bizneseve, prindërve, kujdestarëve për mbrojtjen e fëmijës nga format të cilat rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

1.10. Mbrojtja e fëmijës në masmedia

Masmedia në të gjitha shoqëritë luan një rol të rëndësishëm në informimin e publikut si dhe në krijimin dhe respektimin e një imazhi pozitiv për secilin qytetar, përfshirë edhe fëmijët. Media me produktet e saj duhet t'i shërbejë mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijës si akterë të përgjegjshëm. Në botimin dhe transmetimin e çdo materiali, media përkatëse duhet të ketë parasysh nëse materiali mundet dhe duhet të jetë i qasshëm nga fëmija dhe çfarë pasoja mund të ketë ky material në zhvillim e fëmijës.

Në paragrafin 1 të nenit 45 është paraparë mbrojtja e fëmijës nga transmetimet ose publikimet të dëmshme për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e tij siç janë:

- Publikimet;
- Filmata;
- Video lojërat;
- Muzika;
- Transmetimet ose llojet e tjera të mediave elektronike ose të shkruara.

Paragrafi 2 ka përcaktuar detaje që ndërlidhen me ndalimin e shitjes, ofrimit me qira ose shpërndarjes *përmes ndonjë mjeti tjetër* sikurse librave, gazetave ose llojeve tjera të publikimeve, duke përfshirë: 'filmata dhe inçizimet e përmbajtjeve pornografike, erotike, të dhunshme, që nxisin mizori, diskriminim, duke përfshirë edhe diskriminimin racor, fetar, seksual, kombëtar dhe etnik, apo ndonjë diskriminim tjetër'. Kjo ndalesë është për çdo individ ose organizatë.

LMF përveç ndalesave të lartcekura ka përcaktuar edhe obligimin për të kontribuar në promovimin e mbrojtjes së fëmijës nëpërmjet veprimtarive vetëdijësuese, si dhe duke këshilluar publikun mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj mediave mund të ketë mbi fëmijën. Për më tepër institucionet duhet të inkurajojnë prodhimin dhe shpërndarjen e librave dhe informacioneve nga mediat me qëllim ndikimin pozitiv dhe ngritjen e vetëdijes kulturore dhe përqaftimin e vlerave të mirëfillta. Theks të veçantë duhet t'i kushtohet edhe nevojave të fëmijëve të komuniteteve me qëllim të ofrimit të programeve dhe informacionit në gjuhën që e flasin këta fëmijë.

Obligimi për ofrimin e këtyre programeve, informatave dhe veprimtarive vetëdijësuese ju takon:

- Mediave të shkruara dhe elektronike;
- Televizioneve;
- Radiove;
- Shtëpive botuese;
- Kompanive reklamuese;
- Kinemave;
- Kompanive që ofrojnë dhe shpërndajnë internet;
- Portaleve, etj.

²⁹ Udhëzimi Administrativ për masat e duhura parandaluese dhe mbrojtëse për ndalimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klubet e natës dhe lojërat e fatit.

1. Fëmija mbrohet nga publikimet, filmat, video lojërat, muzika, transmetimet ose llojet e tjera të mediave elektronike ose të shkruara, të cilat janë të dëmshme për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.
2. Asnjë individ ose organizatë nuk lejohet që fëmijës t'i tregojë, shesë, jep me qira, ose shpërndajë përmes ndonjë mjeti tjetër libra, gazeta, revista dhe lloje të tjera të publikimeve, duke përfshirë filmat dhe incizimet e përmbajtjeve pornografike, erotike, të dhunshme, që nxisin mizori, diskriminim, duke përfshirë edhe diskriminimin racor, fetar, seksual, kombëtar dhe etnik, apo ndonjë diskriminim tjetër, si dhe ato që për arsye të ndryshe janë të dëmshme për fëmijën. Ndalohet që fëmija të marrë pjesë në çfarëdo paraqitje të materialeve të tilla.
3. Mjetet e komunikimit masiv, përfshirë mediat e shkruara dhe elektronike, botimet, televizionin, radion, reklamat, kinemanë, internetin dhe mediat online, portalet, janë të obliguara që të kontribuojnë në mënyrë aktive për të afirmuar mbrojtjen e fëmijës me realizimin e veprimtarive vetëdijesuese dhe duke këshilluar publikun mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj mediave mund të ketë mbi fëmijën.
4. Qeveria duhet të inkurajojë prodhimin dhe shpërndarjen e librave për fëmijë, shpërndarjen e informacionit nga mediat dhe materialet me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijë, të cilat promovojnë vlerat e përmendura.
5. Qeveria, përmes masave stimuluese, inkurajon masmediat që të kenë skema programore të dobishme për fëmijën, duke marrë parasysh edhe nevojat gjuhësore të fëmijës që ju takojnë minoriteteve.
6. Mediat obligohen të raportojnë në mënyrë etike, duke mbrojtur dinjitetin e fëmijës dhe duke pas parasysh interesin më të mirë të fëmijës.
7. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bazë të Ligjit përkatës për Komisionin e Pavarur të Mediave ka mandat ligjor sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore të transmetuara nga të licencuarit e KPM-së, si ofruesit e shërbimeve mediave audio dhe audio vizuale dhe operatorët e shpërndarjes.
8. KPM në bashkëpunim me institucionet e tjera me akt nënligjor përcakton mënyrat e mbrojtjes së Fëmijëve në masmedia me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesje institucionale.

Neni 45 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

KPM, nëpërmjet aktit nënligjor përcakton mënyrat e mbrojtjes së fëmijës në masmedia me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesin institucional.

Për të kuptuar më tepër për mandatin dhe punët që kryen KPM kliko në këtë faqe interneti³⁰:

<https://www.kpm-ks.org/ballina>

Për të kuptuar më tepër rreth rregullores së KPM për mbrojtjen e fëmijës që është në fuqi kliko këtu:

<https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1370439037.589.pdf>

³⁰ Faqja e internetit është klikuar dhe kopjuar në muajin Gusht 2022.

1.11. Mbrojtja e fëmijës me aftësi të kufizuara

Në Kosovë akoma nuk ka një ligj gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar. Aftësia e kufizuar rregullohet akoma përmes ligjeve tematike dhe që kanë një fushëveprim të ngushtë të rregullimit të aftësisë së kufizuar. Për më tepër ligjet ekzistuese që synojnë të ofrojnë mbrojtje nuk përfshijnë qartë fëmijët dhe nuk janë gjithë përfshirëse në aspektin e aftësisë së kufizuar.

Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (Ligji Nr.05/L-067)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>

Ligji për Personat e Verbër (Ligji Nr.04/L-092)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2837>

Ligji për Shëndetin Mendor (Ligji Nr.05/L-025)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>

Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (Ligji Nr.04/L-141)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme (Ligji Nr.03/L-022)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2582>

Para se të ofrojmë mbrojtjen, është me rëndësi të kuptojmë se çka është ‘aftësia e kufizuar’. Në ligjet që rregullojnë fushën e aftësisë së kufizuar në Kosovë, gjen përkufizime të ndryshme të cilat i dedikohen më tepër fushëveprimit që mbulojnë (p.sh. përkufizim i aftësisë së kufizuar nga perspektiva e dëgjimit, shikimit, lëvizjes së trupit, gjymtyrëve të trupit, etj.). Ndërsa Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar jep këtë përkufizim të përgjithshëm ku përfshinë të gjithë individët.

Personat me aftësi të kufizuar³¹ përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Megjithatë, përshkrimi i personave me aftësi të kufizuara i propozuar nga KDPAK rezultojnë nga progresioni kohor i mënyrës se si është kuptuar aftësia e kufizuar. Të menduarit për aftësinë e kufizuar ka evoluar në mënyrë thelbësore.

Modeli i fundit, ‘modeli shoqëror’ ka evoluar përmes të kuptuarit më të madh të barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Modeli shoqëror konstaton se aftësia e kufizuar rezultojnë nga ndërveprimet ndërmjet individit me dëmtimeve specifike fizike, intelektuale, shqisore ose të shëndetit mendor dhe mjedisit shoqëror dhe kulturor. Aftësia e kufizuar kuptohet si konstrukt socio - politik, ku barrierat në qëndrimet mjedisore dhe institucionale në shoqëri përjashtojnë dhe diskriminojnë në mënyrë sistematike personat me aftësi të kufizuara.

Modeli Shoqëror (i njohur edhe si modeli bio-psiko-social) është në përputhje me qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, ose modelin e të drejtave të njeriut të konceptualizimit të aftësisë së kufizuar dhe është në përputhje

³¹ Neni 1 pika 2, Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i njohur si KNF³².

Ndërsa LMF, ka përzgjedhur një përkufizim që është i bazuar në përkufizimin e KDPAK, por edhe përkufizimin që është në KDF (neni 23).

Fëmijë me aftësi të kufizuar³³ - nënkupton fëmijën me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Neni 46, mbrojtjen e fëmijës më aftësi të kufizuara e fillon duke garantuar barazinë dhe zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, ku të gjithë fëmijët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të gëzojnë të drejtat në mënyrë të plotë pa marrë parasysh statusin e tyre që ndërlidhet me aftësinë e kufizuar fizike apo psikologjike.

Në paragrafin 2 të këtij neni, mbrojtja përfshin sigurimin e jetës normale dhe në kushte që garantojnë dinjitetin, vetëbesimin, rehabilitimin dhe reintegrimin, si dhe lehtësimin e pjesëmarrjes aktive dhe qasjen fizike të fëmijës në komunitet.

Shërbimet shëndetësore, sociale dhe edukative sa herë të jetë e mundur duhet të ofrohen falas dhe sa më pranë fëmijës.

Sipas paragrafit 4, parashihet ofrimi i shërbimeve shëndetësore, rehabilituese dhe edukative në komunën tjetër nga ku fëmija e ka vendbanimin. Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të mbrojtjes së fëmijës, dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi për ofrim të shërbimeve, në rast se komuna përkatëse nuk mund të ofrojë një shërbim të tillë.

Nëse shërbimet e nevojshme për fëmijën nuk ofrohen në komunën prej nga vjen fëmija, ose për ndonjë arsye tjetër fëmija duhet të marrë shërbimet në një komunë tjetër, atëherë shërbimet edukative, shëndetësore dhe rehabilituese, mund të ofrohen nga komuna tjetër.

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.
2. Fëmijës me aftësi të kufizuara duhet t'i sigurohet jetë normale, në kushte që garantojnë dinjitetin, që nxisin vetëbesimin, rehabilitimin dhe ri integrimin, si dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive dhe qasjen fizike të fëmijës në komunitet.
3. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfituar nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Institucionet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.

³² Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF), <https://www.who.int/standards/classifications/international-classification-of-functioning-disability-and-health>.

³³ Neni 3 par.1. pika 1.2 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (LIGJI Nr.06/L-084).

4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një komunë tjetër nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësisve të vetëqeverisjes lokale. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozimin e ministrisë përkatëse për çështje sociale, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për shëndetësi dhe ministrisë përkatëse për Arsimin.
5. Fëmija me aftësi të kufizuara duhet të mbrohet nga diskriminimi, të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimi, abuzimi, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe stigmatizimi. Kjo kërkon ndër të tjera:
 - 5.1. promovimi i respektit ndaj dallimeve dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe njerëzimit, si dhe zhvillimi i aftësive të fëmijës me aftësi të kufizuara;
 - 5.2. sigurimi i asistencës dhe trajtimit mjekësor të kualifikuar, duke përfshirë metodat dhe pajisjet përkatëse korrigjuese dhe rehabilituese;
 - 5.3. sigurimi i programeve të identifikimit të hershme dhe ndërhyrjes, si dhe shërbimeve të dizajnuara për të minimizuar dhe parandaluar aftësitë e kufizuara të mëtejme;
 - 5.4. sigurimi i trajtimeve, pajisjeve dhe programeve që i mundësojnë fëmijës me aftësi të kufizuara të ruajë lëvizshmërinë dhe pavarësinë maksimale personale;
 - 5.5. sigurimi i mjeteve alternative të komunikimit për fëmijë me aftësi të kufizuara;
 - 5.6. sigurimi i ndihmës dhe kujdesit të veçantë në përputhje me nevojat specifike të fëmijës, ndaj vetë fëmijës dhe prindërve ose kujdestarëve të tyre;
 - 5.7. Institucionet kompetente obligohen që në mënyrë periodike të rishikojnë trajtimin e të gjithë fëmijëve të vendosur në institucione për qëllime të trajtimit ose të rehabilitimit.
6. Njëri nga prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuara ose fëmijës që ka nevojë për përkujdesje të veçantë, ka të drejtë të punojë me gjysmë orari derisa fëmija t'i mbushë 2 (dy) vjet. Po ashtu, në koordinim dhe me leje nga institucioni, organizata apo kompania ku punon, mund të shfrytëzojë format fleksibile të punësimit siç janë të përshkruara në legjislacionin përkatës.
7. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.
8. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijës me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikë bërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijës për të kuptuar
9. Njësia përkatëse për qeverisje të mirë dhe institucionet e tjera për mbrojtjen e fëmijës, promovojnë eliminimin e diskriminimit dhe paragjyqimeve ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara.
10. Parimet e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, zbatohen nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

Në paragrafin 5 përcaktohet mbrojtja e fëmijës nga diskriminimi dhe çfarëdo lloj i dhunës, dhe për tu realizuar kjo duhet:

- Promovimi i respektit ndaj dallimeve dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara;
- Sigurimi i asistencës dhe trajtimit mjekësor të kualifikuar;
- Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme;
- Trajtimi për të ruajt lëvizshmërinë dhe pavarësinë maksimale personale;
- Sigurimi i mjeteve alternative të komunikimit për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Sigurimi i ndihmës dhe kujdesit të veçantë ndaj vetë fëmijës dhe prindërve/kujdestarëve të tyre;
- Rishikimi periodik i rasteve të fëmijëve të vendosura në institucione.

Si pjesë e mundësive dhe trajtimit të veçantë, LMF ka paraparë që njëri nga prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuara ose fëmijës që ka nevojë për përkujdesje të veçantë, të punojë me gjysmë orari derisa fëmija t'i mbushë 2 (dy) vjet, si dhe të shfrytëzojë mundësitë e formave fleksibile të punës.

Ndërsa në fund të këtij neni obligohen autoritetet përgjegjëse, që të eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive. Për më tepër, autoritetet duhet të garantojnë pjesëmarrjen e fëmijës me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijës për të kuptuar.

1.12. Ndalimi i rrëmbimit, shitjes dhe trafikimit

Neni 47 i LMF nëpërmjet paragrafit 1 dhe 2 me qëllim të mbrojtjes së fëmijës ka përcaktuar si referencë veprat penale për kryerësit e këtyre veprave. Është me rëndësi të theksohet që për kryesit e veprave penale, ndëshkimet e parashikuara për këto vepra penale duhet të jenë të rrepta dhe në përpjesëtim me ato të parashikuara për vepra të krahasueshme të rënda.

1. *Rrëmbimi, shitja dhe trafikimi i fëmijës për çdo qëllim ose në çfarëdo forme ndalohet dhe janë vepra penale. Ndëshkimet e parashikuara duhet të jenë të rrepta dhe në përpjesëtim me ato të parashikuara për vepra të krahasueshme të rënda.*
2. *Fëmija mbrohet nga rrëmbimi, trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi.*

Neni 47 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Veprat penale në Kodin Penal të Republikës së Kosovës:

Neni 165 Trafikimi me njerëz

Neni 199 Rrëmbimi

Veprat penale kundër integritetit seksual: neni 225 deri tek neni 236

Neni 247 Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve

Kodi Penal i Republikës së Kosovës

1.13. Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

LMF në kuptim të përkufizimit të dhunës, ka përcaktuar dy lloj përkufizimesh, një që është i përgjithshëm dhe që përmban të gjitha elementet e dhunës, dhe një përkufizim që ka në fokus fëmijën dhe format kryesore të dhunës ndaj fëmijës. Përkufizimet duhen interpretuar në favor dhe interes të fëmijës, pa marrë parasysh se cili element apo formë e dhunës i shkaktohet fëmijës.

Dhunë³⁴ – nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës. Dhunë, përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Duke u bazuar në përkufizimin e ngushtë dhe përkufizimin e përcaktuar në KDF (shih nenin 19), LMF në nenin 48 paragrafi 1 ka përcaktuar këto forma të dhunës nga të cilat duhet mbrojtur fëmijën:

- Dhuna fizike dhe mendore;
- Abuzimi;
- Neglizhimi;
- Keqtrajtimi;
- Shfrytëzimi;
- Trafikimi;
- Pengmarrja;
- Pornografia;

³⁴Neni 3 par.1. pika 1.22 dhe 1.23 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084).

- Abuzimi seksual;
- Ai dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhen.

Përderisa paragrafi 1 përcakton format e dhunës nga të cilat duhet mbrojtur, paragrafi 2 përcakton obligimin institucional dhe familjar për të ndihmuar fëmijën viktimë të dhunës, të cilit duhen ofruar programe rehabilitimi fizik, psikologjik e emocional si dhe integrimin në familje dhe komunitet.

1. Fëmija mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi, shfrytëzimi, trafikimi, pengmarrja, pornografia, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, keqtrajtimin, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Subjektet e përmendura në paragrafin 2. të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin dhe pikëpamjet e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.
4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Neni 48 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Për të realizuar një mbrojtje efikase dhe të bazuar në nevojat dhe interesin e fëmijës të gjithë profesionistët por jo vetëm, duhet të marrin parasysh këta hapa kryesorë:

- Identifikimi
- Raportimi
- Referimi
- Hetimi
- Trajtimi dhe ndjekja
- Rehabilitimi dhe
- Reintegrimit.

KAPITULLI 2

MBROJTJA NGA SHFRYTËZIMI EKONOMIK

2.1. Parimet e punës

E drejta e fëmijës për punë dhe mbrojtja e tij nga format e ndaluara të punës, është përcaktuar në nenet në kuadër të kapitullit nga shfrytëzimi ekonomik. KDF dhe Konventat e ILO punësimin e konsiderojnë si aktivitet të natyrës ekonomike dhe mundësia për keqpërdorim dhe shfrytëzim është jashtëzakonisht e madhe.

Përkundër faktit që puna e fëmijës përdoret dhe kuptohet si sinonim i shfrytëzimit dhe keqpërdorimit të fëmijës, megjithatë fëmija ka të drejtë dhe mund të punësohet në punë e cila është e lejuar dhe konform zhvillimit të fëmijës dhe interesit afatgjatë të tij.

LMF, duke u nisur nga këto parime ka përcaktuar dhe përkufizuar se çka nënkupton puna e lejuar për fëmijën dhe cilat janë standardet minimale të cilat duhen garantuar në mënyrë që fëmija të mund të përfshihet në punë.

Puna e lejuar për fëmijë³⁵ - është pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet.

Sipas nenit 49, e drejta për punë dhe punësimi i fëmijës duhet të realizohet vetëm nën kushtet kur nuk e rrezikon mirëqenien fizike dhe mendore, si dhe të drejtat e tij për arsim, shëndet, kohë të lirë dhe lojë.

Në rastet kur fëmija është i angazhuar në punën e lejuar, ka të drejtën e shpërblimit adekuat konform punës së kryer.

Monitorimin e punësimit dhe kushteve të punës dhe sigurinë në punë e realizon inspektoriati i punës. Lejesat dhe ndalesat nga ky kapitull vlejnë edhe për bizneset private, ku parashihet edhe përgjegjësia për këta të fundit për çdo shkelje të ligjit.

³⁵ Neni 3 par.1. pika 1.12 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084).

1. Fëmija ka të drejtë për punë të denjë. Puna e lejuar e fëmijës nuk duhet të rrezikojë asnjë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, duke përfshirë të drejtën për mirëqenie fizike dhe mendore, të drejtën për arsimim, shëndet dhe të drejtën për kohë të lirë dhe lojë.
2. Fëmija i punësuar në pajtim me legjislacionin në fuqi ka të drejtë të merr shpërblime adekuate për punën e kryer.
3. Inspektorati i Punës është përgjegjës për monitorimin e punësimit të fëmijës për të garantuar mirësjelljen, sigurinë dhe kushtet e punës.
4. Ky kapitull do të zbatohet edhe për agjencitë private të punësimit. Sektori privat i punësimit, siç përcaktohen me nenin 1. të Konventës 181 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, janë përgjegjës si persona juridikë për çdo shkelje të këtij ligji.

Neni 49 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Përveç eliminimit të rreziqeve dhe kushteve të cilat e bëjnë një punë të lejuar për fëmijë, puna e lejuar duhet të kontribuojë në këto aspekte:

- **Ekonomik:** fëmija duhet të shpërblehet për punën e tij. Shpërblimi mund të jetë në vlerë monetare apo ndonjë formë tjetër që ndikon në motivimin e fëmijës për të vazhduar me punën e tij dhe avancimin praktik dhe profesional.
- **Psiko social:** duhet të ndikojë në zhvillimin e vetëbesimit sidomos tek rastet e fëmijëve që janë të cenuar dhe marginalizuar. Poashtu duhet të ndikojë në zhvillimin psikologjik dhe ndërtimin e karakterit, rritjen e përgjegjësisë familjare dhe shoqërore.
- **Edukativ:** duhet të mësojë fëmijën për aftësitë praktike dhe shkathtësitë e caktuara për jetë, veçanërisht shkathtësitë për të mbijetuar dhe ndërveprimin me të tjerët. Risë aftësitë e tij për kuptimin dhe zbatimin në praktikë të lëndëve të cilat i mëson në teori siç janë: matematika, gjuha, edukata qytetare, edukata fizike, etj.
- **Zhvillimin gradual:** ndikon në pavarësinë dhe pjekurinë e fëmijës krahas moshës së fëmijës, etj.

2.2. Moshë minimale për punësim

Sipas LMF moshë minimale është rregulluar me qëllim të caktimit të moshës minimale dhe kohës që i nevojitet fëmijës për të arritur pjekurinë e nevojshme si dhe të përfundojë vitet e nevojshme të arsimimit dhe edukimit të tij.

1. Moshë minimale për punësim përcaktohet me ligj duke marrë parasysh kohën e nevojshme që i nevojitet fëmijës për të arritur pjekurinë e duhur fizike dhe mendore dhe për të përfunduar arsimin bazë. Ndalohet angazhimi i fëmijës nën moshën minimale për punësim në ndonjë marrëdhënie pune, të paguar ose jo.
2. Asnjë punëdhënës nuk mund të punësojë dhe lidhë kontratë pune me ndonjë fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.
3. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me fëmijën nga pesëmbëdhjetë (15) vjeç deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
4. Fëmija mund të punësohet vetëm në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë, si dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me legjislacionin në fuqi. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën

mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet.

5. Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve të tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që fëmijën e punësuar ta lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe të tjera.
6. Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, rregullohet me udhëzim administrativ të nxjerrë nga Qeveria, me propozim të ministrisë përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale.

Neni 50 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Edhe **Konventa e ILO-s Nr. 138**³⁶, për moshën minimale të pranimit në punë, në nenin 1 parasheh detyrimin e shteteve që kanë ratifikuar këtë konventë që: *'duhet të marrin një sërë masash për të siguruar ndalimin e punës së fëmijëve dhe të rrisin progresivisht moshën minimale për punësimin e fëmijëve në përshtatje me zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës'*.

Të njëjtin kriter të moshës dhe kushteve të punësimit e rregullon edhe Ligji i Punës në Republikën e Kosovës:

Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës pesëm-bëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.

Neni 7, par.2 Ligji i Punës Nr. 03/L-212

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

2.3. Puna e ndaluar

Puna e ndaluar e fëmijës është puna që dëmton mirëqenien, pengon arsimin dhe zhvillimin e fëmijës dhe standardin e ardhshëm jetësor. Puna e ndaluar e fëmijës është punë e cila për nga natyra dhe/ose mënyra si kryhet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon të drejtën e fëmijës për arsimim. Për më tepër, puna e fëmijës u referohet edhe rrethanave kur fëmija i moshës së shkollimit të detyrueshëm, është i angazhuar në aktivitete të paguara ose të papaguara, brenda ose jashtë familjes, dhe me ç' rast i mohohen të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe standarde ndërkombëtare për ta arritur potencialin e plotë fizik dhe psikologjik të zhvillimit.

Puna e ndaluar për fëmijë³⁷ - është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.

Format e rrezikshme të punës së fëmijës - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë permanente) apo sëmundje (shpeshherë permanente) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës.

³⁶ https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ilo_code:C138 (Klikuar Gusht 2022).

³⁷ Neni 3 par.1. pika 1.13 dhe 1.14. i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084).

Konventa e ILO-s Nr. 182³⁸ për format më të rënda të punës së fëmijës përkufizon dhe përcakton format më të rënda të punës së fëmijës dhe përcakton disa masa për zbatimin efektiv për mbrojtjen ndaj punës së rëndë të fëmijëve që duhet të ndërmerren nga shtetet. Konventa në nenin 3 përcakton format më të rënda të punës së fëmijëve si vijon:

- a) *Të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, puna e detyruar ose e detyrueshme;*
- b) *Përdorimi ose ofrimi i një fëmije për prostitucion, pornografi ose për shfaqje pornografike;*
- c) *Përdorimi ose ofrimi i një fëmije për aktivitete të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e drogës;*
- d) *Punë e cila, nga natyra ose nga rrethanat në të cilat kryhet, ka të ngjarë të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijës.*

LMF duke u bazuar në frymën e KDF dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, përmes ndalimit të punësimit të fëmijës në punë të rënda, synon parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga aktivitetet që do të dëmtonin:

- Sigurinë;
- Shëndetin;
- Moralin;
- Zhvillimin psikofizik të fëmijës, etj.

Si punë të rrezikshme paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar:

- Të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria, puna e detyruar, duke përfshirë rekrutimin e detyruar të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikte të armatosura;
- Përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për prostitucion, për prodhimin e materialeve pornografike ose për shfaqje pornografike;
- Përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, sipas përcaktimit në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
- Puna e cila, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

1. *Ndalohet punësimi i fëmijës në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.*

2. *Fëmija nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë në punë të rrezikshme, si në vijim:*

2.1. *të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria dhe bujkrobëria për shkak të borxheve dhe puna e detyruar apo e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar apo të detyrueshëm të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikt të armatosur;*

2.2. *përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për prostitucion, për prodhimin e materialeve pornografike ose për shfaqje pornografike;*

2.3. *përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, sipas përcaktimit në traktatet përkatëse ndërkombëtare;*

³⁸ https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C182 (klikuar Gusht 2022).

- 2.4. *puna e cila, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.*
3. *Ndalohen format e rrezikshme të punës së fëmijës, veçanërisht të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në punën e detyruar ose të detyrueshme, robërinë e borxheve, robërinë, shitjen dhe trafikimin e fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit ekonomik dhe për qëllime të shfrytëzimit seksual.*
4. *Fëmijët viktime të cilat i janë nënshtruar punës së lejuar së fëmijëve ose punës së fëmijëve që nuk janë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi i ofrohet ndihmë mjekësore dhe psikologjike, masa rehabilituese dhe riintegruese, ndihmë juridike dhe të drejtën për kompensim në pajtim me ligjin për kompensimin e viktimave të krim.*

Neni 51 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Neni 51 në paragrafin e fundit ka përcaktuar obligimet për ofrimin e ndihmës mjekësore dhe psikologjike, masat rehabilituese dhe riintegruese, ndihmën juridike dhe të drejtën për kompensim në pajtim me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Udhëzimit Administrativ ka përcaktuar format e rrezikshme të punës së fëmijëve si dhe mekanizmat përgjegjës që janë të obliguar për mbikëqyrje dhe intervenim efektiv për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës për të gjithë fëmijët.

Udhëzimi Administrativ QRK Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7650>

KAPITULLI 3

FORMAT SPECIFIKE TË MBROJTJES

3.1. Mbrojtja nga pornografia

Fëmija duhet të mbrohet nga të gjitha elementet të cilat janë të përshkruara në përkufizimin e pornografisë nga ana e LMF, sepse ato janë elemente të veprës penale të përkufizuar në mënyrë identike edhe nga KP (shih nenin 225 par.8, të Kodit Penal).

Pornografi me fëmijë³⁹ - nënkupton çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh, ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete të tjera, që paraqet ose pasqyron: gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale; një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose pamje realiste të një fëmije jo ekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.

Autoritetet dhe institucionet mbrojnë fëmijën duke mbyllur hapësirat fizike dhe digjitale të përdorura për prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijës ose për performancat pornografike që përfshijnë fëmijën. Ky obligim vlen edhe për ndalimin e çfarëdo paraqitjeje, në çfarëdo mënyre, të një fëmije të përfshirë në aktivitete eksplicite seksuale reale ose të simuluar apo çfarëdo paraqitjeje e pjesëve intime të trupit të një fëmije.

- 1. Ndalohet çfarëdo paraqitje, në çfarëdo mënyre, e një fëmije të përfshirë në aktivitete eksplicite seksuale reale ose të simuluar apo çfarëdo paraqitjeje e pjesëve intime të trupit të një fëmije.*
- 2. Autoritetet përkatëse janë të autorizuar të mbyllin hapësirat e përdorura për prodhimin e pornografisë së fëmijës ose për performancat pornografike që përfshijnë fëmijën, edhe në mungesë të një dënimi penal.*

Neni 52 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Kodi Penal ka paraparë dy vepra penale ku fëmijët mund të jenë viktima të keqpërdorimit në pornografi.

³⁹ Neni 3 par.1. pika 1.31 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084).

Veprat penale në Kodin Penal të Republikës së Kosovës:

Neni 231 Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet

Neni 232 Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi

3.2. Masat kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës

LMF ka krijuar detyrime për autoritetet dhe institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin masa për të ofruar internet të sigurtë në hapësirat publike veçanërisht në hapësirat ku frekuentohen nga fëmijët, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqet që kanë përmbajtje joadekuate për fëmijët. Këto masa përfshinë mbrojtjen e fëmijës, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- Shfaqje të pornografisë;
- Mundësisë së ngarkimit apo shkarkimit të fotove, videove apo formave tjera që kanë përmbajtje pornografike;
- Ngacmimi në internet;
- Abuzimi emocional;
- Seksting⁴⁰;
- Grooming⁴¹.
- Përmbajtje të dhunës dhe/apo frikës;
- Përmbajtje/faqe që shfaqin abuzime të fëmijëve;
- Reklama (pop-up) me përmbajtje të dëmshme / të papërshtatshme;
- Bullizmi dhe formave që ndërlidhen me të;
- Faqe të internetit me përmbajtje raciste;
- Faqe që shfaqin abuzime dhe dhunë;
- Spam email apo email të padëshiruara;
- Përmbajtje të faqeve të internetit që tregojnë si kryhet vetëvrasja;
- Përmbajtje të faqeve të internetit që shfaqin abuzime të njerëzve dhe kafshëve;
- Përmbajtje të faqeve të internetit që këshillojnë si të kryhen sulme terroriste;
- Viruse të kompjuterit;
- Mashtrime përmes internetit/Phishing email – të krijuar për të mashtruar një viktimë fëmijë në zbulimin e ndjeshëm të të dhënave, apo për të vëzhguar/përcjell navigimin e viktimës në internet.

⁴⁰ Seksting (sexting) – nënkupton dërgimin dhe pranimin e fjalëve, pikturave, fotografive dhe videove seksuale duke përdorur teknologjinë, me theks të veçantë telefonin, tabletët apo kompjuterët.

⁴¹ Gruming (Grooming) - Nënkupton dhe i referohet përgatitjes së abuzimit seksual të fëmijës, i motivuar nga dëshira për të përdorur fëmijën për kënaqësi seksuale. Kjo përfshin poashtu edhe afrimin me fëmijën për qëllime kinse të miqësisë, nga ana e madhorëve të cilët shtiren kinse janë fëmijë apo të rinjë, të cilët pastaj përfundojnë në tërheqjen e fëmijës për të diskutuar çështje intime, dhe gradualisht ekspozimin e fëmijës tek materialet eksplicite me qëllim të zvogëlimit të rezistencës apo edhe pengimit të seksit.

Ndërsa në lidhje me mbrojtjen nga ndikimi i internetit dhe video lojërave, institucionet përgjegjëse bashkëpunojnë për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikshmërinë e lojërave të cilat luhen online apo offline, dhe të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin dhe jetën e fëmijës. Ky bashkëpunim duhet të rezultojë me hartimin dhe përditësimin e listës së lojërave që janë me rrezik të lartë të ndikimit në shëndetin dhe jetën e fëmijës. Lista duhet të jetë e qasshme në portalin shtetëror të Republikës së Kosovës.

1. *Institucionet përgjegjëse të ofrojnë internet të sigurt në hapësirat publike, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqet që kanë përmbajtje joadekuate për fëmijët.*
2. *Ofruesit e shërbimeve të internet-kafesë dhe video lojërave duhet të sigurojnë që:*
 - 2.1. *përmbajtja e këtyre shërbimeve të jetë e përshtatshme për moshën e fëmijës dhe të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare;*
 - 2.2. *hapësirat në të cilat ofrohen këto shërbime të jenë në përputhje me standardet dhe të mos dëmtojnë shëndetin e fëmijës;*
 - 2.3. *koha që u jepet në dispozicion për lojë të jetë e kufizuar, në përputhje me moshën e fëmijës.*
3. *Qeveria, me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme, nxjerr akt nënligjor, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga internet-kafetë dhe video lojërat, duke përfshirë masat specifike ndaj përmbajtjeve pornografike, ndëshkimit e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimi i ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit.*

Neni 53 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Mbrojtja e fëmijës mund të bëhet duke ndërmarrë disa nga masat si në vijim:

- Blllokimi i faqeve të internetit, dhe formave të tjera të komunikimit në internet;
- Instalimi i filterëve;
- Programet e kontrollit nga prindërit;
- Hulumtimi dhe klikimi i sigurtë;
- Verifikimi i moshës.

Detajet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga interneti dhe video lojërat, duke përfshirë masat specifike ndaj përmbajtjeve pornografike, ndëshkimit e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimin e ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për të kuptuar më tepër për Udhëzimin Administrativ për Masat për Mbrojtjen e Fëmijës Kundër Faqeve të Internetit me Përmbajtje Pornografike dhe të Atyre që Dëmtojnë Shëndetin dhe Jetën e Fëmijës:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60529>

Ministria e Punëve të Brendshme

<https://mpb.rks-gov.net/>

Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë

<https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,79>

Policia e Kosovës

<https://www.kosovopolic.com/>

Autotrieti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)

<http://www.arkep-rks.org/>

3.3. Kapaciteti i fëmijës për të ndërmarrë veprime ligjore

LMF në parim ka përcaktuar që e drejta për të shprehur pikëpamjet i takon fëmijës, si dhe në momentin kur arrin zotësinë e veprimit përmes emancipimit, mund të ndërmerr edhe veprime ligjore. Mirëpo në rastet kur fëmija nuk mund të shpreh pikëpamjet apo edhe nuk mund të ndërmerr veprime ligjore, fëmijës duhet ti mundësohet të ndërmerr veprime ligjore përmes prindërve, kujdestarëve apo edhe profesionistëve të mbrojtjes së fëmijës.

1. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë të përfaqësojnë fëmijën e tyre.
2. Në rast të mungesës apo pamundësisë së prindit/ërve, të ushtrojnë detyrat prindërore, caktohet kujdestari për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijës gjatë procedurave ligjore.
3. Obligohen përfaqësuesit ligjorë të fëmijës të marrin parasysh mendimet dhe interesat më të mira të tij, kur vendosin se si do t'i përfaqësojnë interesat e tij.
4. Obligohen gjykatat dhe autoritetet e tjera për t'u dhënë rëndësinë e duhur mendimeve të fëmijës dhe obligohen që t'i sigurojnë fëmijës ndihmën profesionale që të kuptojnë natyrën dhe pasojat e mundshme të procedurave, si dhe rolin e tyre në to.

Neni 54 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

LMF në rend të parë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe përfaqësimin e tij për të marr veprime ligjore ia ka bartur prindit apo prindërve. Pastaj në mungesë apo pamundësi të këtyre të fundit obligimi bie mbi kujdestarin.

Edhe Ligji i Familjes ka përcaktuar dhe rregulluar në mënyrë identike aspektet e përfaqësimit ligjor të fëmijës.

OBLIGIMI PËR PËRFAQËSIM TË FËMIJËS:

Neni 128 *'Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë'.*

Neni 133 *'Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë ligjore t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur'.*

Neni 248 *'(1)Kujdestari sipas ligjit e përfaqëson personin nën kujdestari (përfaqësuesi ligjor). (2) Nëse detyrimet e kujdestarit ushtrohen drejtpërdrejtë nga Organi i Kujdestarisë apo nëse kujdestari ka autorizim të kufizuar, Organi i Kujdestarisë përfaqëson personin nën kujdestari përmes njërit nga përfaqësuesit apo ndonjë personi profesional të autorizuar'.*

Ligji i Familjes (Ligji Nr.2004/32)

Në lidhje me paragrafet e fundit të nenit 54 të LMF, që kanë të bëjnë me interesin më të mirë dhe respektimin e pikëpamjes së fëmijës shih Modulin e Parë (I).

3.4. Drejtësia mike ndaj fëmijës

Fëmijët përveç që mund të jenë viktime të veprave penale, ata mund të jenë edhe kryes të veprave penale, apo në një formë apo tjetër mund të marrin pjesë në procedura gjyqësore civile apo administrative ku preket apo cenohet interesi i tyre.

Pa marrë parasysh në çfarë cilësie fëmijët kanë rënë në kontakt me drejtësinë, ata këtë fakt e kanë të vështirë ta kuptojnë dhe për më tepër ky është një moment i sikletshëm, e në momente dhe rrethana të caktuara mund të jetë edhe tronditës dhe me elemente të torturës emocionale.

Duke i marrë parasysh këto arsye, LMF ka përcaktuar rregullat nëpërmjet të cilave fëmija duhet të mbrohet kur të jetë në konflikt apo në kontakt me drejtësinë.

Në këtë aspekt, LMF në kuadër të përkufizimeve ka përkthyer se çka nënkupton drejtësia mike ndaj fëmijës:

Drejtësia mike ndaj fëmijës⁴² - nënkupton sistemin e drejtësisë që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, konsideratë mbizotëruese është interesi më i mirë i fëmijës, mos diskriminimi, mbrojtja e dinjiteti dhe pjesëmarrja e fëmijës duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit.

Pra drejtësia mike, përfshin të gjithë sistemin e drejtësisë dhe vlen për të gjitha procedurat penale, civile dhe administrative. Sipas këtij përcaktimi, të drejtat e fëmijës në procedura të drejtësisë duhet të respektohen në plotni dhe përfshijnë fëmijët në situatat si më poshtë:

- Viktima të veprave penale;
- Dëshmitarë të veprave penale;
- Kryes të veprave penale;
- Shkurorëzimit të prindërve;
- Besimit dhe kujdesit;
- Adoptimit;
- Strehimit familjar apo strehimit rezidencial;
- Trashëgimisë;
- Atësisë dhe amësisë, etj.

Drejtësia mike duhet të jetë:

- E përshtatshme dhe konform moshës së fëmijës;
- Urgjente dhe sipas parimit të gjyqimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme;
- E kujdesshme ndaj fëmijës dhe palëve të tjera që janë pjesëmarrës në procedurë;
- Në ambiente miqësore dhe që shmangin traumën dhe stigmatizimin e fëmijës;
- E fokusuar në nevojat e fëmijës.

⁴² Neni 3 par.1. pika 1.9 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084).

1. Drejtësia mike ndaj fëmijës vlen për procedurat penale, civile ose administrative dhe siguron që të gjitha të drejtat e fëmijës në procedurat e tilla të respektohen plotësisht, duke ruajtur ekuilibrin e duhur me të drejtat e palëve të tjera të përfshira.
2. Drejtësia mike ndaj fëmijës në veçanti, është e:
 - 2.1. përshtatshme për moshën;
 - 2.2. shpejtë;
 - 2.3. kujdesshme;
 - 2.4. përshtatur, dhe;
 - 2.5. fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijë
3. Drejtësia mike ndaj fëmijës është ajo që respekton të drejtat e fëmijës, duke përfshirë të drejtën në një proces të rregullt, për të marrë pjesë dhe për të kuptuar procedurat për respektimin e jetës private dhe familjare të integritetit dhe të dinjitetit.
4. Qeveria me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë përkatëse të Punës dhe Mirëqenies Sociale, miraton akt nënligjor me të cilin do të rregullohen të drejtat e fëmijës në procedurë administrative dhe gjyqësore. Si dhe për ndihmën ligjore dhe qasjen në organet e drejtësisë, për realizimin e ndihmës juridike gjegjësisht për drejtësinë mike ndaj fëmijëve, bazuar në udhëzimin e Këshillit të Europës për Drejtësinë Mike ndaj Fëmijëve.
5. Çdo fëmijë, moshë dhe pjekuria e të cilit i mundësojnë fëmijës që të jep dëshmi të kuptueshme dhe të besueshme, me ose pa forma të përshtatshme të ndihmës, duhet të konsiderohet si dëshmitar ose palë e aftë.
6. Intervistat, marrja në pyetje dhe aktet e tjera hetimore duhet të bëhen në mënyrë të ndjeshme dhe me respekt nga profesionistët të trajnuar.
7. Ndërhyrjet duhet të bëhen në një mjedis që përmbush nevojat e veçanta të fëmijës.
8. Profesionistët, që punojnë me fëmijë, duhet të koordinojnë veprimet e tyre për të siguruar vazhdimësinë dhe për të shmangur që fëmija t'u nënshtrohet ndërhyrjeve të panevojshme.
9. Fëmija viktimë dhe dëshmitar duhet të ketë qasje në shërbime të ndihmës dhe mbështetjes, shërbimet duhet të ofrojnë një dhomë të identifikuar miqësore për fëmijët për intervistimin e fëmijës, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, këshillimore, shëndetësore, sociale dhe psikologjike.
10. Personave mbështetës duhet t'u lejohet të shoqërojnë dhe kur është e përshtatshme, të ndihmojnë fëmijën gjatë intervistave paraprake dhe gjatë dhënies së dëshmisë.
11. Fëmijës viktimë dhe dëshmitarë duhet t'i lejohet të dëshmoj dhe të merret në pyetje larg nga sytë e kryerësit të supozuar.
12. Hetimeve, procedurave dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, që përfshijnë fëmijët viktimë, duhet t'i jepet prioritet.

Neni 55 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Për të kuptuar më tepër rreth drejtësisë mike si dhe rregullave dhe procedurave si zbatohet koncepti i drejtësisë mike mund t'i referoheni këtyre dy dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare:

Kliko në këto faqe interneti⁴³:

⁴³ Faqet e interneti janë klikuar dhe kopjuar në muajin Shtator 2022.

Këshilli i Europës:

<https://www.coe.int/en/web/children/child-friendly-justice#:~:text=Children%20come%20into%20contact%20with,witnesses%20or%20perpetrators%20of%20crimes.>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36550>

3.5. Ndhimja juridike dhe qasja në organet e drejtësisë

Edhe pse LMF në nenin 56 ka përcaktuar që ndihma juridike pa pagesë i sigurohet fëmijës që është viktimizuar nga shkelja e legjislacionit në fuqi, në fakt ndihma juridike si shërbim juridik falas i garantohet dhe i sigurohet çdo fëmije i cili është në nevojë për një ndihmë të tillë.

Në Republikën e Kosovës ndihmën juridike falas e ofron Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (Agjencia) e cila është themeluar sipas ligjit dhe financohet nga buxheti i shtetit.

Ligji për Ndhimë Juridike Falas (Ligji Nr.04/L-017) ka përcaktuar këtë përkufizim:

Ndhimja Juridike Falas⁴⁴ e drejtë në shërbime profesionale juridike falas për qytetarët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Sipas Ligjit për Ndhimë Juridike Falas, Agjencia është e obliguar t'i ofrojë ndihmë juridike falas fëmijës i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare. Agjencia nëpërmjet Zyrave për Ndhimë Juridike Falas në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës bën të mundur qasjen në drejtësi të fëmijës, prindërve apo kujdestarëve, pavarësisht statusit të tyre ligjor (fëmijë në konflikt me ligjin si dhe fëmijë viktimë/dëshmitarë) dhe /ose statusit të tyre ekonomik.

Ndhimja juridike falas ofrohet për këto lloje të shërbimeve⁴⁵.

- Informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
- Përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; dhe
- Përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Ndhimë juridike falas për fëmijën është i obliguar të ofrojë edhe avokati i licencuar dhe regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, *'Ndhimja juridike pa pagesë - Oda është e detyruar të rregullojë ndihmën pa pagesë personave në gjendje sociale të vështirë në çështjet juridike, në të cilat, personat e tillë realizojnë të drejtat që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me pozitën e tyre, si dhe me rastet e tjera të parapara me aktet nënligjore të Odës'*⁴⁶.

⁴⁴ Neni 3 par.1. pika 1.1 i Ligjit për Ndhimë Juridike Falas (Ligji Nr.004/L-017).

⁴⁵ Po aty, neni 4 paragrafi 3.

⁴⁶ Neni 15 i Ligjit për Avokatinë (Ligji Nr.04/L-193).

1. Fëmijës, që është viktimizuar nga shkelja e legjislacionit në fuqi, i sigurohet ndihma juridike pa pagesë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij.
2. Ndhmë juridike përfshinë përfaqësimin ligjor dhe këshillimin mbi të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijës, në procedurat ligjore.
3. Fëmija viktimë, kryes i veprës së kundërligjshme apo dëshmitar, dhe prindërit ose kujdestarët, duhet të informohen menjëherë për të drejtat e fëmijës gjatë procedurave, për disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse, rolin e fëmijës, mënyrat në të cilat fëmija do të merret në pyetje para dhe gjatë gjykimit, vendin dhe kohën e seancave, dhe për ngjarje të tjera të rëndësishme, për progresin e çështjes, për të gjitha vendimet e rëndësishme që merren dhe për mekanizmat ose procedurat në dispozicion për të kërkuar një rishikim të vendimeve.
4. Fëmijës duhet mundësuar të shpreh lirshëm mendimet dhe shqetësimet e tij në lidhje me përfshirjen e tyre në procesin e drejtësisë, duke përfshirë edhe shqetësimet rreth sigurisë në lidhje me të akuzuarin, mënyrën në të cilën ata preferojnë të japin dëshminë dhe mendimet e tyre për rezultatin e procesit, vëmendje duhet t'u kushtohet mendimeve dhe shqetësimeve të fëmijës, dhe për masën në të cilën nuk është e mundur që të merren parasysh ato, arsyet duhet t'i shpjegohen fëmijës.

Neni 56 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Fëmija nëpërmjet ndihmës juridike falas përveç që mbrohet duke i ofruar ndihmë dhe shërbime juridike falas, atij i mundësohet në të njëjtën kohë edhe qasja në drejtësi, si një prej të drejtave kryesore të fëmijës. Sipas paragrafit 3, qasja në drejtësi bëhet e mundur nëpërmjet këtyre masave dhe veprimeve, por jo vetëm:

- Informohimin e menjëhershëm për të drejtat e fëmijës gjatë procedurave;
- Disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse;
- Rolin e fëmijës;
- Mënyrat në të cilat fëmija do të merret në pyetje para dhe gjatë gjykimit;
- Vendin dhe kohën e seancave;
- Progresin e çështjes;
- Të gjitha vendimet e rëndësishme që merren; dhe
- Mekanizmat ose procedurat në dispozicion për të kërkuar një rishikim të vendimeve.

Për të kuptuar më tepër rreth Agjencisë dhe ofrimit të ndihmës juridike falas, kliko në këto faqe interneti⁴⁷:

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas:

<https://anjf.rks-gov.net/>

Oda e Avokatëve të Kosovës:

<https://www.oak-ks.org/>

⁴⁷ Faqet e internetit janë klikuar dhe kopjuar në muajin Shtator 2022.

3.6. Ndhimja mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe reintegrimi

LMF, në vazhdimësi të dispozitave nëpërmjet të cilave i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje fëmijës, ka përcaktuar dhe rregulluar edhe ndihmën mjekësore dhe psikologjike si dhe masat që kërkohen për rehabilitimin e një fëmije viktimë dhe rehabilitimin e tij.

Edhe këtu sikurse tek shërbimi juridik, ndihma është falas dhe ka synim mbështetjen e fëmijës për të rifituar shëndetin fizik dhe mendor, si dhe rehabilitimin nga trauma që ka mundur të përjetojë.

Ndhimja përfshinë trajtimin e fëmijës:

- Me shpejtësi dhe pa vonesa sipas konceptit të ndihmës 'urgjente';
- Nëpërmjet këshillimit psikologjik;
- Nëpërmjet masave afatgjate rehabilituese.

Fëmija përgjatë kohës që merr trajtimin mjekësor dhe psikologjik nuk duhet të lihet vetëm, përveç rasteve kur vlerësohet se kjo është në interes të fëmijës, si dhe në asnjë mënyrë dhe situatë fëmija nuk guxon të përballet apo takohet me abuzuesin apo dhunuesin.

Poashtu fëmija mbrohet nga çdo presion, apo formave të tjera shtrënguese nëpërmjet të cilave synohet nxjerja e informacionit apo çfarëdo të dhëne tjetër.

1. Fëmija i viktimizuar mbështetet me ndihmë mjekësore falas, në mënyrë që të rifitojë shëndetin fizik dhe mendor, si dhe të rehabilitohet nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar.
2. Ndhimja mjekësore përfshinë trajtimin e duhur emergjent për shëndetin fizik dhe këshillimin psikologjik, si dhe për masat afatgjate rehabilituese.
3. Fëmija viktimë e abuzimit dhe veprimeve të tjera kundërligjore abuzive, merr trajtim të specializuar mjekësor falas të mbuluar nga shteti.
4. Është e ndaluar që fëmija viktimë e abuzimit të lihet vetëm, përveç rastit kur fëmija e kërkon këtë gjë me vullnetin e vet dhe psikologu i fëmijës i specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijës e konsiderohen si të përshtatshme.
5. Fëmija viktimë e abuzimit nuk duhet të lihet pa ndihmë psikologjike ose forma të tjera asistence.
6. Fëmija viktimë e abuzimit nuk duhet të lihet të përballet, të ketë kontakte me abuzuesin për aq kohë sa nuk është mjaftueshëm i përgatitur psikologjikisht për t'u përballur.
7. Fëmija viktimë e abuzimit nuk duhet të jetë subjekt i presionit apo formave të tjera manipulative për të marrë informacionin e nevojshëm.
8. Fëmija merr asistencë të vazhdueshme për tu riintegruar në shoqëri. Këto masa riintegruuese duhet të hartohen bazuar në nevojat specifike të fëmijës si dhe formave të veçanta të dëmtimit të fëmijës. Qëllimi final i rehabilitimit duhet të jetë ribashkimi me familjen, në ato raste kur është e mundur dhe në interesin më të mirë të fëmijës, riintegrimi në komunitet dhe në jetën sociale. Këto masa dhe veprime përfshijnë kujdesin mjekësor dhe psikologjik, si dhe mbështetjen arsimore, formimin profesional dhe këshillimin e vazhdueshëm deri në rehabilitimin e plotë të fëmijës. Fëmijës i ofrohet

mbështetje dhe këshillim i vazhdueshëm për të shmangur riviktimizimin dhe përjashtimin social.

- 9.** *Masat e përshkruara në mbështetje të fëmijës në këtë kapitull duhet të merren në një mjedis të favorshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe duhet të sigurojnë trajtimin e kujdesshëm të privatësisë së fëmijës. Masat duhet të përfshijnë mbrojtjen e fëmijës nga konfrontimi me dhunuesit, akomodimin në një vend të sigurt, si dhe përgatitjen psikologjike për të ardhmen.*
- 10.** *Njësia përkatëse për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të komunës, obligohet që të sigurojë buxhet për një fond të veçantë për të trajtuar emergjencat e rasteve të fëmijës në nevojë, për mbrojtjen dhe ngritjen e shërbimeve të emergjencës sipas standarteve të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria dhe të propozuar nga ministria përkatëse për shëndetësi.*

Neni 57 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Trajtimi i vazhdueshëm dhe afatgjatë nëpërmjet të cilit synohet mbrojtja e fëmijës nga riviktimizimi dhe përjashtimi social, përfshijnë këto masa dhe veprime:

- Rehabilitimin e plotë kundrejt dëmtimit të pësuar fizik apo mendor;
- Ribashkimin me familjen;
- Rikthimin në procesin arsimor dhe edukativ;
- Përfshirjen në aktivitete me qëllim formimin profesional;
- Aftësimin për shkathtësitë e jetës;
- Riintegrimin në komunitet dhe në jetën sociale.

Të gjitha masat dhe veprimet që ndërmerren ndaj fëmijës, i ofrohen fëmijës në një mjedis të favorshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës, gjithnjë duke siguruar që privatësia e fëmijës është e pa cenuar. Për të siguruar që masat dhe veprimet që kërkohen për mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet trajtimit mjekësor dhe psikologjik janë prezente, LMF në fund të nenit 57, respektivisht në par.10 ka përcaktuar si obligim për njësinë përkatëse për shëndetësi, punë dhe mirëqenie në kuadër të komunës të sigurojë buxhet për një fond të veçantë për të trajtuar emergjencat e rasteve të fëmijës në nevojë. Ndërsa aspektet e tjera që ndërlidhen me funksionalizimin e këtij shërbimi rregullohen me akt nënligjor.

3.7. Personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës

Përfshirja e këtij neni në kuadër të LMF, është bërë me qëllim parandalimin e riviktimizimit të fëmijës apo mundësisë për të rikryer ndonjë vepër penale ndaj fëmijës nga kategoria e veprave penale për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës.

Me theks të veçantë ndalesa përfshinë ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës nga ana e personave të cilët janë të dënuar për vepra penale të trafikimit me fëmijë dhe në tërësi për veprat penale kundër integritetit seksual të parapara në kapitullin XX të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në këtë aspekt, Kodi Penal në kuadër të dënimeve plotësuese që i shqiptohen kryesit të veprës penale ka paraparë shqiptimin e dënimit plotësues nëpërmjet të cilit i ndalohet ushtrimi i profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

DËNIMI PLOTËSUES: NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, VEPRIMTARISË OSE DETYRËS

'Gjykata ia shqipton kryesit të veprës penale nga neni 165 apo Kapitulli XX i këtij Kodi të kryer ndaj fëmijës, ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës që përfshin kontaktin e rregullt me fëmijë. Gjykata mund ta shqiptoj këtë dënim në kohëzgjatje të përjetshme, i cili i nënshtrohet shqyrtimit periodik gjyqësor nga gjykata pas skadimit të dhjetë (10) vjetëve nga fillimi i ekzekutimit të masës së shqiptuar. Gjykata mund ta ndalojë ekzekutimin e saj me propozim të personit të dënuar nëse ka vërtetuar se arsyet për ndalimin nuk ekzistojnë më. Personi i dënuar mund të paraqes përsëri propozimin e tij apo të saj, por jo më herët se një (1) vit pas shqyrtimit të mëparshëm'.

Neni 63 par.5 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Është me rëndësi të theksohet që ndalimi i ushtrimit të profesionit, në krahasim me dënimet tjera plotësuese, mund të shqiptohet në kohëzgjatje të përjetshme, me mundësi të shqyrtimit periodik gjyqësor nga Gjykata pas skadimit të dhjetë vjetëve nga fillimi i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar.

1. *Personat e dënuar për abuzim seksual, shfrytëzim të fëmijës, mundësim në prostitucion dhe pornografi të fëmijës ndalohet të ushtrorjnë profesione në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, që përfshijnë çdo formë kontakti me fëmijët.*
2. *Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për veprat penale kundër integritetit seksual. Në këtë bazë të të dhënave me ADN-të duhet të përfshihen edhe personat e dënuar për këto vepra penale, pa marrë parasysh nëse viktimat e tyre janë fëmijë ose të rritur.*
3. *Ministria përkatëse për arsim dhe drejtoritë përkatëse për arsim të komunave duhet të sigurojnë që të mos përfshihen përmes punësimit në sistemin arsimor, personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës.*

Neni 58 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i obliguar të mbajë bazën e të dhënave me ADN-në e personave të dënuar për veprat penale kundër integritet seksual. Poashtu Ministria përkatëse e Arsimit dhe Drejtoria përkatëse e Arsimit në komuna duhet të sigurojnë që personat e dënuar të mos përfshihen dhe punësohen në sistemin arsimor.

3.8. Konfliktet e armatosura

Ndalesat e parapara në nenin 59 dhe 60 derivojnë nga Protokolli Fakultativ i KDF ku fëmijët janë të përfshirë në konflikte të armatosura.

Përveç ndalesës, neni 60 ka përcaktuar edhe format dhe masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e fëmijës nëse ai është prekur apo ka marrë pjesë në konflikt të armatosur. Pa marrë parasysh a ka marrë pjesë apo jo drejtpërdrejtë në luftime, fëmijës i sigurohen:

- Ushqim dhe veshmbathje;
- Largimi nga zona ku janë duke u zhvilluar luftimet;

- Dërgimi në një zonë ku është i sigurtë;
- Shoqërimi nga personat përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tij;
- Qasje e vazhdueshme në procesin edukativ dhe arsimor;
- Ribashkimin e fëmijës me familjen e tij.

Ndalohet pjesëmarrja e fëmijës në konfliktet e armatosura si dhe në çfarëdo lloj forme të grupit të armatosur të rregullt apo jo të rregullt, siç parashihet në Protokollin Fakultativ të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës në përfshirjen e Fëmijës në Konflikte të Armatosura.

Neni 59 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

1. *Fëmija i prekur nga konfliktet e armatosura gëzon mbrojtje të posaçme për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tij. Fëmijës duhet t'i sigurohen të gjitha masat e posaçme të mbrojtjes dhe pavarësisht nëse ai ka marrë pjesë apo jo drejtpërdrejt në luftime.*
2. *Asnjë krim luftime ose krime kundër njerëzimit nuk duhet të bëhen kundër fëmijës, dhe veçanërisht fëmija nuk duhet të bëhet viktimë e abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual, punës së detyruar, shfrytëzimit ekonomik, rrëmbimit, trafikimit të qenieve njerëzore, ose zhvendosjes së brendshme.*
3. *Fëmija duhet të marrë ushqim thelbësor dhe veshje.*
4. *Fëmija duhet të largohet nga zona ku është duke u zhvilluar luftë dhe të dërgohet në një zonë të sigurt, të shoqëruar nga personat përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tij dhe, kur kjo është e mundur, me pëlqimin e prindit/ërve ose kujdestarit të tij.*
5. *Fëmija duhet të ketë qasje të vazhdueshme në institucione dhe programe arsimore dhe profesionale.*
6. *Autoritet kompetente duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet për të lehtësuar ribashkimin e familjeve të ndara përkohësisht.*

Neni 60 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

3.9. Mbrojtja e fëmijës së zhvendosur brenda shtetit

Forma e fundit e mbrojtjes të cilën LMF ja garanton fëmijës, është mbrojtja e tij kur ai zhvendoset brenda shtetit. Kjo dispozitë edhe pse është e përgjithshme, ajo nënkupton por nuk kufizohet në mbrojtjen e fëmijës në rrethanat kur ai zhvendoset si pasojë e:

- Konflikeve apo dhunës;
- Tërmeteve;
- Vërshimeve;
- Projekteve zhvillimore me interes ekonomik;
- Hakmarrjes apo gjakmarrjes dhe formave tjera tradicionale;
- Ndonjë rrethanë apo situatë e shkaktuar nga 'vis major'.

Fëmijës i cili është zhvendosur brenda shtetit, i jepet mbrojtje e veçantë për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tij dhe gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara me këtë Ligj dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 61 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr.06/L-084)

ANEKS

C) RAST STUDIMI

Rast studimi

RASTI A

Hetimi i autoriteteve kroate për sa i përket ankimit të kërkueses se ajo ishte detyruar të prostituonte nuk ishte i përshtatshëm dhe shkelte aspektin e detyrimeve procedurale të shtetit sipas nenit 4

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN S.M. k. KROACISË 163
(Kërkesa nr. 60561/14)
19 Korrik 2018

1. Faktet kryesore

Kërkuesja znj. S. M., ka lindur në vitin 1990 dhe gjatë periudhës 2000 - 2004 ka jetuar në një familje strehuese. Më pas, ajo u zhvendos në një shtëpi shtetërore për fëmijët dhe të rinjtë ku qëndroi deri sa mbaroi trajnimin profesional si kamariere.

Më 27 Shtator 2012, kërkuesja paraqiti një padi në polici kundër T.M., një ish polic, duke pretenduar se ndërmjet verës 2011 dhe Shtatorit të të njëjtit vit ai e kishte detyruar të ushtronte prostitucion duke përdorur presion fizik dhe psikologjik. Kërkuesja deklaroi se kishte takuar T.M. në vitin 2011 përmes një rrjeti social dhe se ai i ishte ofruar për t' i gjetur asaj një punë si kamariere. Më pas T.M., kishte filluar të kërkonte që S.M. të kryente shërbime seksuale për meshkuj të tjerë duke e kërcënuar se do ta rrihte nëse ajo nuk bindej. Ai i dha kërkueses një telefon celular, me qëllim që klientët të mund ta kontaktonin. Kërkuesja deklaroi se ajo kishte qenë shumë e frikësuar nga T.M. dhe nuk mundi t' i bënte rezistencë. Më pas T.M. mori me qira një banesë të jetonte së bashku me kërkuesen, vend të cilin e shfrytëzoi si vend ku S.M. të ofronte shërbimet seksuale. Kur kërkuesja refuzoi, ai kërcënoi se do ta dhunonte, gjë të cilën e bëri çdo dy ditë. Meqenëse ata jetonin në të njëjtën banesë T.M. kontrollonte çdo veprim të kërkueses.

Më tej kërkuesja deklaroi se kur kishte qenë një herë e vetme në banesë kishte kërkuar ndihmë tek mikja e saj M.I. tek e cila kishte qëndruar më pas për një periudhë rreth 10 ditore.

M.I. deklaroi në polici se në fund të verës 2011 kërkuesja u rikthye papritur në banesën e saj ku ajo jetonte me të ëmën. Vetëm pasi ajo erdhi dhe vendosi të jetonte në apartamentin e M.I., kjo e fundit mësoi se kërkuesja kishte qenë e përfshirë në prostitucion.

Më 6 Nëntor 2012, Zyra e Prokurorit të Qarkut e paditi T.M. me akuzën për shfrytëzim prostitucioni në mënyrë të organizuar. Më 21 Dhjetor 2012, kërkueses iu dha zyrtarisht statusi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore

nga Zyra Kroate për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicat. Policia kroate kontaktoi Kryqin e Kuq, i cili organizoi këshillim individual për kërkuesen. Gjithashtu, S.M. iu dha ndihmë juridike nga një organizatë joqeveritare brenda skemës së ndihmës ligjore të mbështetur nga shteti.

Gjatë dëshmisë së kërkueses në gjykatë, ajo elaboroi më tej deklaratën e saj të parë të bërë në polici. Megjithatë, T.M. mohoi versionin e ngjarjeve dhe deklaroi se kërkuesja me dëshirë ushtroi prostitucion me qëllim që të shlyente borxhet dhe të fitonte para. Ai deklaroi se kishte jetuar në të njëjtin apartament me kërkuesen, vend në të cilin ajo ushtronte prostitucionin por ai nuk e kishte kuptuar këtë fakt. Më 15 Shkurt 2013 gjykata vendase liroi T.M. me arsyetimin se edhe pse ishte vërtetuar se ai kishte organizuar një rrjet prostitucioni, nuk ishte vërtetuar se kërkuesja ishte detyruar të ushtronte prostitucion. Meqë ai ishte akuzuar për vepër të rëndë, ai nuk mund të dënohej për akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit. Dëshmisë së kërkueses iu dha më pak peshë në argumentin e gjykatës, pasi sipas kësaj të fundit deklarata e kërkueses kishte qenë jo koherente, e pasigurt dhe kërkuesja kishte ndaluar rrëfimin dhe hezitur ta vazhdonte.

Prokurori i çështjes apeloj kundër vendimit, duke argumentuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në vendimmarrjen e saj duke mos pranuar si provë dëshminë e kërkueses. Gjykata e Apelit e rrëzoi ankimin, duke mbajtur të njëjtin qëndrim në arsyetimin e vendimit sikurse gjykata e shkallës së parë. Më 31 Mars 2014, kërkuesja paraqiti një ankim në Gjykatën Kushtetuese. Më 10 Qershor 2014, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin si të papranueshëm, pasi që kërkuesja nuk kishte të drejtë të paraqiste ankim kushtetues lidhur me akuzat penale.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Duke u mbështetur në nenet 3, 4 dhe 8 të Konventës kërkuesja u ankua se kuadri ligjor kombëtar i papërshtatshëm, veprimet procedurale dhe përgjigja e autoriteteve vendase mbi ankimet e saj kundër T.M., kishin shkelur të drejtat e saj. Veçanërisht ajo pretendoi se autoritetet kroate kishin dështuar të zbardhnin të gjitha rrethanat e ngjarjes, nuk i kishin siguruar asaj një pjesëmarrje të duhur gjatë procesit dhe nuk kishin ndërtuar në mënyrë të drejtë aktakuzën.

Neni 4

Gjykata vlerësoi se ankimi duhet të analizohej në kuadër të nenit 4 të Konventës (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar). Ajo deklaroi se trafikimi, si dhe shfrytëzimi për prostitucion ishin brenda objektit të kësaj dispozite.

Gjykata vërejti se nuk kishte rëndësi fakti se çështja nuk përfshinte elementë ndërkombëtarë pasi neni 2 i Konventës së Këshillit të Europës kundër Trafikimit përfshin “të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, goftë kombëtare apo ndërkombëtare” dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve i referohet shfrytëzimit të prostitucionit në përgjithësi.

Neni 4 i Konventës vendos një detyrim ndaj shteteve anëtare për të ndëshkuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive çdo veprim, që synon mbajtjen e një personi në një pozitë skllavërie, shfrytëzimi ose pune të detyruar. Prandaj, shtetet kanë detyrimin për të krijuar një kornizë ligjore dhe administrative për të ndaluar dhe ndëshkuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Gjykata ishte e bindur se në kohën e ngjarjeve kishte një kornizë ligjore të përshtatshme në Kroaci për shqyrtimin e saj në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore, prostitucionit të detyruar dhe shfrytëzimit të prostitucionit. Gjykata gjithashtu vërejti se kërkueses iu siguroa ndihmë nga ana e Qeverisë. Kjo përfshinte njohjen e statusit të saj si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore

dhe dhënien e ndihmës juridike falas, përmes programeve të financuara nga shteti dhe të mbështetura nga OJQ-të. Rrjedhimisht, kishte një kuadër ligjor të përshtatshëm për të mbështetur kërkuesen.

Megjithatë, ndërkohë që hetimi fillestar ishte i shpejtë, Gjykata deklaroi se më shumë individë duhej të ishin marrë në pyetje nga policia, sidomos nëna dhe i dashuri i M.I. Ky element ndikoi që Gjykata të vërente se autoritetet kroate nuk e hetuan rastin në thellësi dhe nuk u përpoqën të mbledhin të gjitha provat e disponueshme.

Për më tepër, autoritetet kurrë nuk kishin bërë një përpjekje serioze për të hetuar presionin psikologjik të ushtruar nga T.M. ndaj kërkueses, si një faktor relevant në vlerësimin nëse T.M. e detyroi kërkuesen të ushtronte prostitucion. Gjithashtu, autoritetet nuk morën në konsideratë praninë e një arme në banesën e T.M. dhe varësinë ekonomike të kërkueses nga T.M.

Gjykata vazhdoi më tej duke evidentuar se sipas ligjit kroat, Konventës për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve dhe Konventës Kundër Trafikimit, pëlqimi i viktimës është i parëndësishëm.

Autoritetet kombëtare nuk e konsideruan ndikimin e mundshëm të traumës psikologjike në aftësinë e kërkueses për të lidhur në mënyrë koherente ngjarjet mbi shfrytëzimin e saj. Gjithashtu, Gjykata nënvizoi se prania e T.M. në sallën e gjyqit mund të ketë pasur efekt të dëmshëm ndaj kërkueses edhe pse ai më pas u largua.

Gjykata vlerësoi se në këtë rast autoritetet kroate nuk përmbushën detyrimet e tyre procedurale sipas nenit 4 dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të këtij neni.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 5,000 euro në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material.

RASTI B***Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve – dështimi i autoriteteve për të shqyrtuar ankimin mbi “rrezikun” ndaj një fëmije*****VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN X K. LETONISË****(Kërkesa nr. 27853/09)****26 Nëntor 2013****1. Faktet kryesore**

Kërkuesja znj. X, ishte shtetase letoneze e lindur në 1974. Në një datë të papërcaktuar, ajo u shpërngul në Australi ku u martua me z. R.L. Në vitin 2004, ndërsa ishte ende e martuar me R.L., kërkuesja u takua me z. T. me të cilin më pas vendosi të bashkëjetonte. Në Shkurt të vitit 2005, kërkuesja lindi një vajzë, E., dhe në Nëntor 2005, ajo u divorcua zyrtarisht nga R.L. Atësia e fëmijës nuk ishte përcaktuar në këtë fazë. Kërkuesja vazhdoi të jetonte me T. në banesën të cilën ky i fundit e kishte marrë me qira, si edhe përfitonte asistencë si prind i vetëm. Kërkuesja mori shtetësinë australiane në vitin 2007. Marrëdhëniet mes kërkueses dhe T. u përkeqësuan dhe në vitin 2008 ajo u largua nga Australia për në Letoni duke marrë me vete vajzën e saj e cila ishte tre vjeç e pesë muaj.

Menjëherë, T. paraqiti një padi në Gjykatën Australiane të Familjes për të vendosur të drejtat prindërore në lidhje me E., duke kërkuar kthimin e fëmijës në Australi sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Gjykata australiane vendosi për atësinë e tij, si edhe për faktin që kërkuesja dhe T. kishin pasur përgjegjësi të përbashkët prindërore për fëmijën e tyre, që nga lindja. Kërkuesja ishte ftuar të merrte pjesë në seancë gjyqësore personalisht, ose ta ndiqte atë përmes telefonit por nuk e kishte bërë këtë. Kërkuesja nuk e apeloj vendimin.

Në Shtator 2008, Autoriteti Qendror i Letonisë mori një kërkesë nga institucioni homolog australian me objekt kthimin e fëmijës. Kërkuesja u dëgjua në Letoni nga dy gjykata vendase dhe T. ishte i pranishëm në këto procese. Gjatë këtyre proceseve, kërkuesja argumentoi se T. nuk kishte arsye për t'u njohur si babai i E., pasi në kohën e lindjes së saj, ajo kishte qenë e martuar me një burrë tjetër. Për më tepër, T. nuk kishte shprehur kurrë një dëshirë për të njohur atësinë e tij përpara kohës se ajo të kthehej në Letoni. Gjithashtu, kërkuesja argumentoi se T. kishte abuzuar ndaj saj dhe se fëmija kishte zhvilluar një lidhje me Letoninë. Gjatë procesit në apel kërkuesja gjithashtu paraqiti një raport nga një psikolog, që deklaronte se fëmija do të vuante trauma nëse do të ndahej nga nëna. Gjykatat e Letonisë urdhëruan kthimin e fëmijës në Australi duke theksuar se largimi ishte i paligjshëm dhe u krye pa pëlqimin e T. Gjykata e Apelit vendosi se nuk mund të merrte në konsideratë raportin e psikologut për vajzën pasi themeli i çështjes së kujdestarisë duhet të vlerësohej nga gjykatat australiane.

Kërkuesja refuzoi të zbatonte vendimin e gjykatës vendase për ta kthyer fëmijën pranë T. dhe kërkoi një pezullim të ekzekutimit të urdhërit. Gjykata vendase urdhëroi zhvillimin e një seance tjetër në Prill të vitit 2009. Në Mars të vitit 2009 T. takoi papritmas kërkuesen dhe vajzën ndërsa ishte në Letoni dhe arriti ta merrte me vete fëmijën në Australi. Sapo arriti në Australi, gjykatat vendase vendosën që T. kishte përgjegjësinë e vetme prindërore mbi fëmijën dhe se kërkueses i lejohej vetëm të vizitonte vajzën e saj në prani të një punonjësi social. Ajo gjithashtu ishte ndaluar të fliste me vajzën e saj në letonisht.

2. Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkuesja u ankua se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të vendimit të gjykatave letoneze për të urdhëruar kthimin e vajzës së saj në Australi. Dhoma në vendimin e saj të datës 15 Nëntor 2011, konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 8. Rasti iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të qeverisë.

Neni 8

Gjykata vërejt se vendimi për kthimin e fëmijës në Australi kishte përbërë një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private dhe familjare. Kjo ndërhyrje ishte në përputhje me legjislacionin vendor, dhe kishte për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të babait të saj.

Sa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata vuri në dukje se ekzistonte një konsensus i gjerë në mbështetje të idesë se në të gjitha vendimet lidhur me fëmijën, interesi më i mirë i fëmijës, duhet të ketë prioritet. Në këtë rast roli i Gjykatës Europiane ka të bëjë me verifikimin nëse procesi i vendimmarrjes në gjykatat vendore, që çoi në vendimin për ta kthyer fëmijën në Australi, kishte qenë i drejtë dhe se ishte mbrojtur interesi më i lartë i fëmijës.

Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vuri në dukje se kërkuesja kishte paraqitur në Gjykatën Rajonale të Rigës një raport të hartuar nga një psikolog pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke argumentuar, *inter alia*, se një ndarje e menjëhershme mes fëmijës dhe nënës duhej të përjashtohej për shkak të traumave psikologjike, që fëmija mund të pësonte. Gjykata nënvizoi se ishte e papranueshme, që gjykatat nuk e kishin marrë në konsideratë këtë raport të hartuar nga një ekspert i fushës, me argumentin se çështja e trajtuar në raport, kishte të bënte me çështjen e kujdestarisë. Në fakt, raporti i psikologut tërhoqi vëmendjen për ekzistencën e një rreziku për dëmin psikologjik, duke paraqitur dyshim të një "rreziku të lartë", i cili duhet të ishte ekzaminuar në kuadër të nenit 13 (b) të Konventës së Hagës, sikurse duhet të ishte shqyrtuar, nëse ishte e mundur që nëna të shkonte me vajzën e saj në Australi dhe të mbante kontakt me të. Nevoja për të respektuar afatet ligjore të parashikuara edhe nga Konventa e Hagës, nuk mund t'i lirojë autoritetet letoneze nga përgjegjësia për të shqyrtuar një pretendim të tillë.

Në përfundim, Gjykata u shpreh se refuzimi për të shqyrtuar një raport të përgatitur nga një ekspert, i cili nënvizonte ekzistencën e mundësisë së një "rreziku të lartë" për fëmijën në kuptim të nenit 13 (b) të Konventës së Hagës, e detyronte të arrinte në përfundimin se autoritetet letoneze kishin dështuar për të përmbushur detyrimet e tyre procedurale në kuadër të nenit 8 të Konventës, duke shkelur kështu të drejtën e garantuar nga ky nen.

Neni 41

Gjykata vendosi se Letonia duhet t'i paguante kërkueses 2,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

D) AGJENDA

AGJENDA

Dita e katërt Moduli IV	
09:00 – 09:15	Objektivat kryesore dhe rezultatet e pritura
09:30 – 10:30	Mbrojtja e fëmijëve në familje dhe komunitet
10:30 – 12:00	Përgjegjësitë familjare, institucionale dhe individuale
12:00 – 13:00	Dreka
13:00 – 14:00	Edukimi, arsimimi, shëndeti dhe mirëqenia
14:00 – 14:45	Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës Ndalimi i rrëmbimit, shitjes dhe trafikimit Mbrojtja nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara
14:45 – 15:15	Mbrojtja e fëmijës me aftësi të kufizuara
15:15 – 16:00	Raste studimi, punë në grupe
16:00	Përmbyllja e ditës së katërt

Dita e pestë Moduli IV	
09:00 - 09:15	Objektivat kryesore dhe rezultatet e pritura
09:15 - 10:00	Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik
10:00 - 11:15	Format specifike të mbrojtjes
11:15 - 12:00	Format specifike të mbrojtjes (vazhdim)
12:00 - 13:00	Dreka
13:00 - 14:30	Raste studimi, punë në grupe
14:30 - 15:00	Drejtësia mike
15:00 - 16:00	Ndihma juridike, ndihma mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe reintegrimi
16:00	Përmbyllja e ditës së pestë Vlerësimi i trajnimit

Terma dhe përkufizime nga ligji

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë program duhet të interpretohen dhe lexohen konform kuptimit të dhënë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe kanë këtë kuptim:

Fëmijë – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur moshë e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa moshë e tij të jetë përcaktuar plotësisht;

Fëmijë me aftësi të kufizuar - nënkupton fëmijën me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë;

I mitur - nënkupton fëmijën mes moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeç;

Prind - nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë;

Përgjegjësi prindërore – nënkupton obligimin e prindit për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për t'i siguruar fëmijës mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës;

Kujdestari - nënkupton personin siç është e përcaktuar me Ligjin për familjen;

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtetësisë;

Mbrojtësi i viktimës - nënkupton personin zyrtar publik, i cili përfaqëson palën e dëmtuar në procedura gjyqësore dhe administrative, përfshirë edhe fëmijën. Mbrojtësi i viktimës u ofron mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit, përfaqëson viktimën në procedura para gjykatës, njofton viktimën për të drejtat e tij, përfaqëson interesat e viktimës para gjykatës dhe prokurorisë, si dhe vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme në përputhje me ligjet në fuqi;

Fëmijë në nevojë për mbrojtje - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin;

Drejtësia mike ndaj fëmijës - nënkupton sistemin e drejtësisë që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, konsideratë mbizotëruese është interesi më i mirë i fëmijës, mos diskriminimi, mbrojtja e dinjitetit dhe pjesëmarrja e fëmijës duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit;

Fëmijë në nevojë për mbrojtje - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin;

Fëmijë i zhvendosur brenda territorit të Kosovës - nënkupton fëmijën i cili për arsye të ndryshme migron nga një komunë në tjetrën dhe ka nevojë për ofrim të shërbimit/eve të mbrojtjes;

Puna e lejuar për fëmijë - është pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet;

Puna e ndaluar për fëmijë - është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës;

Format e rrezikshme të punës së fëmijës - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë permanente) apo sëmundje (shpeshherë permanente) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës;

Fëmijë në rrezik - nënkupton çdo fëmijë që përjeton një faktor intensiv dhe / ose të vazhdueshëm të rrezikut, ose një kombinim të faktorëve të rrezikut në rrethanat personale, mjedisore dhe/ose relacionale që i pengojnë të ndjekin dhe përmbushin zhvillimin e potencialit të plotë;

Fëmija pa përkujdesje prindërore - nënkupton fëmijën prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur, prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror;

Familje në nevojë - nënkupton çdo familje, kur njëri ose të dy prindërve, kujdestarit dhe përkujdesësit, u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit/ërve ose kujdestarit të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve, apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë;

Përfaqësues ligjor - nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton të gjitha shërbimet qëllimi i të cilave është që fëmijës t'i ofrohet mbrojtja sipas parimeve të këtij Ligji;

Profesionistët për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton të gjithë personat, të cilët brenda mandatit të punës së tyre dhe në kontekstin e punës së tyre, janë në kontakt me fëmijën që ka nevojë për mbrojtje, ose kanë detyrë të përmbushin nevojat e fëmijës sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, standardi vendor apo ndërkom-bëtar;

Person i besueshëm - nënkupton çdo person tjetër përveç prindit ose kujdestarit ligjor, i cili kujdeset për fëmijën, për shkak të një marrëdhënieje profesionale ose joprofesionale;

Dhunë - nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e

mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës. Dhunë, përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bën një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual;

Dhunë psikologjike – nënkupton aktet të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi i cili ka përgjegjësi, është i besuar ose ka pushtet dhe përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jo fizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues;

Dhunë fizike - nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike;

Ndëshkim trupor – nënkupton çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmijës, nga çdo person ligjërish përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma, të tilla, si: rrahje, tortura, shkundje, shtytje, djegie, goditje, pickim, çjerrje, kafshim, qortim i rreptë;

Neglizhimi i fëmijës - nënkupton mosveprimin me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës;

Abuzim - nënkupton çdo veprim apo mosveprim, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoritetit që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës;

Keqtrajtim - nënkupton të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues, apo shfrytëzimin tregtar, ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëm real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti;

Prostitucion me fëmijë – nënkupton përdorimin e fëmijës për veprimtari seksuale, me ç' rast në këmbim të përfshirjes në veprimtari seksuale të fëmijës ofrohen ose premtohen si pagesë para ose çdo formë tjetër shpërblimi ose kompensimi, pavarësisht nëse ajo pagesë, ai premtim ose shpërblim i bëhet fëmijës ose një pale të tretë;

Pornografi me fëmijë - nënkupton çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh, ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete të tjera, që paraqet ose pasqyron: gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale; një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose pamje realiste të një fëmije jo ekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;

Rrëmbimi i fëmijës - nënkupton largimi i paligjshëm i fëmijës nga vendi i banimit me anë të forcës, kërcënimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose joshjes, në një vend nën kontrollin e kryesit ose të një personi të tretë, apo marrja e paligjshme e fëmijës nga prindi, kujdestari, ose personi i besueshëm, pavarësisht nëse kjo kryhet, lehtësohet apo koordinohet brenda territorit të shtetit ose që përfshinë transitin në ose përmes shtetit;

Trafikimi i fëmijës - nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin, marrjen e fëmijëve për qëllime shfrytëzimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës, apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme, ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit;

Shfrytëzim - përfshin por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave;

Abuzimi seksual i fëmijës - nënkupton shprehjen e abuzimit brenda shtëpisë ose familjes, por nuk përjashton edhe rastet e abuzimit nga persona jashtë familjes duke përdorur përparësitë e pozitës qoftë sociale apo edhe zyrtare për përfitime seksuale nga viktimi e abuzimit. Aktiviteti seksual i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër;

Institucion – nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës në këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi;

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar dhunën, abuzimin, neglizhimin dhe shfrytëzimin e fëmijës. Sipas kuptimit të përgjithshëm, sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet nga këto komponente: resurset njerëzore dhe financiare, ligjet dhe politikat, qeverisja, monitorimi dhe mbledhja e të dhënave, shërbimet mbrojtëse dhe reaguese, si dhe menaxhimi i rastit. Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë: fëmijët, familja, komuniteti, shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përjashtuar edhe ata në nivel ndërkombëtar. Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komponentëve dhe akterëve brenda këtij sistemi;

Komiteti - nënkupton Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës;

Këshilli - nënkupton Këshillin për të Drejtat e Fëmijës;

Ekipi – nënkupton Ekipin për të Drejtat e Fëmijës;

Tryeza Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit -nënkupton grupin multidisiplinar, që përfshinë profesionistët nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterët e tjerë që përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;

Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë - nënkupton Zyrën përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;

Menaxheri i rastit - nënkupton zyrtarin përgjegjës të caktuar nga Organi i Kujdestarisë, për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili në bashkëpunim me akterët relevantë vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes;

Qendra për Punë Sociale (QPS) - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetent edhe për mbrojtjen e fëmijës në nevojë;

Organi i kujdestarisë - nënkupton organin përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës;

Zyrtar i Shërbimeve Sociale - nënkupton profesionistin e shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin e Këshillit të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare.

Burimet dhe materialet për lexim

- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-064). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 14 / 17 Korrik 2019, Prishtinë;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
- Konventa për Kontaktin në Lidhje me Fëmijët;
- Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”;
- Konventa e ILO-s Nr. 138;
- Konventa e ILO-s Nr. 182;
- Ligji i Familjes (Ligji nr.2004/32);
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr.02/L-17) dhe Ligji nr.04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr.02/L-17);
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006);
- Ligji për Avokatin e Popullit (Ligji Nr.05/L-019);
- Ligji për Ndihmë Juridike Falas (Ligji Nr.04/L-017);
- Ligji për Avokatinë (Ligji Nr.04/L-193);
- Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga neni 9 par.3 i LMF (Autoritetet për të drejtat e fëmijës);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga neni 9 par.4 i LMF (Autoritetet për të drejtat e fëmijës);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 18 (Këshilli për të drejtat e fëmijës);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 20 (Ekipi për të drejtat e fëmijës);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 43 (Mbrojtja e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 44 (Ndalimi i pjesëmarrjes në klubet e natës dhe lojërave të fatit);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 53 (Masat kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës);
- Udhëzimi Administrativ që derivon nga Neni 57 (Ndihma mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe masat për riintegrim);
- Udhëzimi Administrativ QRK nr.05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë.

